

Ofertë Referencë
Interkoneksioni
Telekomi i Kosoves

për

**OPERATORËT E RRJETEVE TË
KOMUNIKIMEVE PUBLIKE**

Prishtine 25.11.2014

ORI
Version 01

PËRMBAJTJA

PJESA E PËRGJITHSHME:

- NENI 1 QËLLIMI DHE OBJEKTI I OFERTËS REFERENCË
- NENI 2 FUSHA E VEPRIMIT
- NENI 3 KUFIZIME TË FUSHËS SË VEPRIMIT
- NENI 4 BAZA JURIDIKE
- NENI 5 PËRKUFIZIME
- NENI 6 INTERPRETIMI I MARRËVESHJES
- NENI 7 PARIME TË PËRGJITHSHME
- NENI 8 DETYRIME TË PËRGJITHSHME TË PALËVE
- NENI 9 INTERKONEKSIONI ME RRJETIN TIK
- NENI 10 BASHKËVENDOSJA
- NENI 11 SHËRBIMET E INTERKONEKSIONIT
- NENI 12 TARIFAT E SHËRBIMEVE TË INTERKONEKSIONIT
- NENI 13 NIVELI I INTERKONEKSIONIT DHE NDRYSHIMI I KAPACITETEVE
- NENI 14 NDERFAQËT TEKNIKE, PROTOKOLET DHE SIGURIMI I PËRPUTHSHMËRISË SË SHËRBIMEVE
- NENI 15 PARAQITJA E IDENTIFIKIMIT TË LINJËS THIRRËSE (CLI)
- NENI 16 MATJET, DEKLARIMI DHE DAKORDIMI I TRAFIKUT/PROCEDURAT
- NENI 17 FATURIMI, PAGESAT DHE GARANCIA
- NENI 18 STANDARDET E CILËSISË DHE MARRËVESHJA PËR NIVELIN E SHËRBIMIT (SLA)
- NENI 19 KONFIDENCIALITETI
- NENI 20 SIGURIA DHE MBROJTJA E TË DHËNAVE
- NENI 21 TË DREJTAT E PRONËSISË INTELEKTUALE
- NENI 22 KALIMI I TË DREJTAVE DHE DETYRIMEVE TË PALËVE
- NENI 23 PËRDORIMI ABUZIV I MARRËVESHJES SË INTERKONEKSIONIT
- NENI 24 KUFIZIME TË PËRGJEGJËSISË
- NENI 25 FORCA MADHORE
- NENI 26 NJOFTIMET
- NENI 27 SHKELJA, PEZULLIMI DHE SHKËPUTJA E MARRËVESHJES SË INTERKONEKSIONIT
- NENI 28 LIGJI I ZBATUESHËM, SHKËPUTJA E MOSMARRËVESHJES
- NENI 29 DISPOZITA PERFUNDIMTARE
- NENI 30 AFATI, HYRJA NË FUQI DHE VLEFSHMËRIA
- NENI 31 NDRYSHIMET

LISTA E ANEKSEVE:

- 1. PËRKUFIZIME
- 2. INTERKONEKSIONI ME RRJETIN TIK
- 3. PËRSHKRIMI I SHËRBIMEVE
- 4. TARIFAT E SHËRBIMEVE
- 5. KËRKESA STANDARDE
- 6. ÇËSHTJE TEKNIKE
- 7. BASHKËPUNIMI I PALËVE
- 8. PARASHIKIMI DHE POROSIA PËR KAPACITETET E INTERKONEKSIONIT
- 9. MATJA, DEKLARIMI DHE DAKORDIMI/PROCEDURAT
- 10. FATURIMI, PAGESAT DHE GARANCIA
- 11. FORMULARI I GARANCISË
- 12. MARRËVESHJA E NIVELIT TE SHËRBIMIT-SLA
- 13. DESTINACIONET KOMBËTARE DHE DETYRIMET PËRKATESE
- 14. BLLOKSKEMA E INTERKONEKSIONIT
- 15. PIKAT E INTERKONEKSIONIT
- 16. MUNDËSITE PËR BASHKËVENDOSJE
- 17. ZONAT E INTERKONEKSIONIT DHE NUMERACIONI I TIK
- 18. NUMERACIONI I OPERATORIT PËRFITUES
- 19. NUMERACIONI I OPERATORVE TJERË KOMBËTAR

NENI 1

QËLLIMI DHE OBJEKTI I OFERTES REFERENCE

1. Qëllimi i përgatitjes së këtij dokumenti, Ofertë Referencë Interkoneksioni, është përcaktimi i kriterëve e procedurave për rregullimin e marrëdhënieve ndërmjet TiK dhe Operatorit Përfitues lidhur me shërbimet dhe fasilitetet shoqëruese që përshkruhen në një Marrëveshje Interkoneksioni që lidhet midis TiK dhe Operatorit Përfitues bazuar në këtë Ofertë Referencë të Interkoneksionit.

2. Objekti i kësaj Ofertë Referencë është ofrimi i shërbimeve nga TiK, në pikën e interkoneksionit me qëllim përdorimin e tyre nga Operatori Përfitues sipas Licences/Autorizimit nga ARKEP dhe marrëveshjes së lidhur me TiK, për përdoruesit e tij. TiK lejon qasjen për shërbimet e ofruara nga Operatori Përfitues sipas përcaktimeve në Licencë/Autorizimin përkatës dhe akteve të tjera rregulluese për këto shërbime si dhe ofron qasje në fasilitetet shoqëruese në infrastrukturen e rrjetit të tij me informacionet përkatëse duke u mbështetur në një marrëveshje paraprake konfidencialiteti.

NENI 2

FUSHA E VEPRIMIT

1. Marrëveshja e Interkoneksionit midis TiK dhe Operatorit Përfitues bazohet në parashikimet e kësaj Ofertë Referencë Interkoneksionit, e cila aplikohet për ndërmarrjet të cilët janë të autorizuar sipas regjimit të autorizimit të ARKEP dhe që kanë të drejtë të kërkojnë interkoneksion sipas Rregullores për Sigurimin e Qasjes, Rregullores për Interkoneksion dhe vendimeve tjera të nxjerrura nga ARKEP që rregullojnë këtë çështje, përshirë tarifave të tyre. Marrëveshja e Interkoneksionit nuk do të përmbajë detyrime shtesë për operatorët përfitues, detyrime të cilat nuk janë parashikuar në këtë Ofertë Referencë të Interkoneksionit.

2. TiK si Ofrues i Interkoneksionit dhe Operatori Përfituesi bien dakord që të përdorin standardet teknike dhe të cilësisë të mbështetura në rekomandimet e organizatave ndërkombëtare, ITU, ETSI të pranuar nga ARKEP.

NENI 3

KUFIZIME TE FUSHES SE VEPRIMIT

1. TiK mund të refuzojë dhënien e qasjes për një Operator Përfitues vetëm në bazë të kriterëve objektive, të tilla si pamundshmëria teknike apo nevoja për të ruajtur integritetin e rrjetit. Operatori Ofrues ka detyrimin të provojë pamundësinë e ofrimit të një shërbimi të kërkuar.

2. TiK, në rastet kur refuzon të sigurojë Operatorit Përfitues shërbimet e specifikuar në Ofertën Referencë dhe e motivon këtë refuzim me mungesën e mundësive teknike, ai ka detyrimin të paraqesë Operatorit Përfitues një shpjegim gjithëpërfshirës të arsyeve të refuzimit dhe të specifikojë afatin kohor të saktë në të cilin kërkesa do të përmbushet. Kur TiK refuzon të sigurojë shërbimet e specifikuar në këtë ofertë referencë për operatorin përfitues për shkak të kriterëve të tjera të përmendura në pikën 1 të këtij neni, TiK duhet, gjithashtu, të specifikojë kushtet që duhet të plotësojë Operatori Përfitues me qëllim që TiK të jetë në gjendje të përmbushë kërkesën. Për secilin rast të specifikuar në këtë paragraf, kur TiK paraqet shpjegime për operatorin përfitues, kopje të këtyre shpjegimeve i depozitohen njëkohësisht dhe ARKEP-it.

NENI 4 BAZA JURIDIKE

- 1.** Ligji Nr. 04/L-109 për Komunikimet Elektronike i Republikës së Kosovës
- 2.** Vendimin e ARKEP Nr.180,181,182,183,184,186,187 per përcaktimin e ndërmarrjes PTK sh.a si OFNT(Ofrues me Fuqi te Ndjeshme ne Treg).
- 3.** Rregullore për Sigurimin e Qasjes, Rregullore per Interkoneksion dhe Rregullore për Zgjedhjen dhe Parazgjedhjen e Operatorit miratuar nga ARKEP
- 4.** Regjistri i Ndërmarrjeve te licencuara nga ARKEP per Ofrimin e Rrjetave dhe Sherbimeve Telekomunikuese Publike (Licenca/Autorizimi)
- 5.** Operatori Përfitues, me paraqitjen e Kërkesës Standarde për interkoneksion në TiK, garanton që ka të vlefshme dokumentat e nevojshme ligjore dhe licencat/autorizimet përkatëse për të lidhur një marrëveshje që lind pas pranimit të kësaj Oferte Referencë dhe të ja paraqesë këto dokumenta TiK-ut së bashku me Kërkesën Standarde për interkoneksion. Kërkesa duhet gjithashtu të përmbajë informacionin e nevojshëm për të mundësuar zgjidhjen teknike dhe komerciale të qasjes/interkoneksionit të tilla si:
 - a. Propozim mbi vendodhjen e Interkoneksionit
 - b. Struktura e Rrjetit
 - c. Propozim mbi rrugëzimin e trafikut
 - d. Adresat e nyjeve të komutimit, adresat e nyjes Gateway dhe nyjeve tjera të komutimit
 - e. Karakteristikat e paisjes së transmetimit të përdorur për Interkoneksion
 - f. Karakteristikat e paisjes së komutimit të përdorur për Interkoneksion
 - g. Shërbimet e kërkuara: zanore, të dhëna,faks, etj.
 - h. Seritë numerike që do të përfshihen
 - i. Parashikime për trafikun që do shkëmbehet
 - j. Si dhe çdo informacion tjetër të nevojshëm sipas kësaj Oferte Referencë për të lidhur marrëveshjen e interkoneksionit.
- 6.** Kërkesa do të konsiderohet e pranueshme dhe do te shqyrtohet vetëm pas plotësimit me të gjithë dokumentet dhe informacionet e kërkuara përmes Kërkesës Standarde. Nëse PTK ka nevojë për informacione apo sqarime shtesë do të kontaktoj operatorin.Kërkesat e paplotësuara nuk do të merren parasysh.
- 7.** Kërkesa Standarde me të gjithë dokumentacionin përcjellës të kërkuar sipas kësaj Oferte Referente duhet të dorëzohet në formë të shkruar në adresën:

Posta dhe Telekomuni i Kosovës
Zyra e Interkoneksionit-TiK
Rruga Dardania, p.n
10100 Prishtinë
Kosovë
Telefoni:038/240 240

NENI 5 PERKUFIZIME

- 1.** Për interpretimin e Ofertës Referencë të Interkoneksionit, Anekseve bashkëngjitur apo korespondencës në lidhje me zbatimin e Marrëveshjes së Interkoneksionit ose shtesat e bëra në pjesë të saj janë përdorur terma, kuptimi i të cilave përcaktohet në Aneks 1 "Përkufizime".
- 2.** Përkufizimet në Aneksin 1 të kësaj Oferte Referencë përfshijnë, përveç përkufizimeve të dhëna në ligj, të gjithë termat e përdorur në Ofertën Referencë të Interkoneksionit dhe që do të përdoren edhe në Marrëveshjen e Interkoneksionit midis TiK dhe Operatorit Përfitues.

NENI 6 INTERPRETIMI I MARREVESHJES

- 1.** Çdo kusht apo formulim që mund të sjellë paqartësi do të interpretohet në kontekstin e tërësisë së Ofertës Referencë dhe në këndvështrimin e qëllimit që i shtyu palët të lidhin marrëveshje interkoneksioni.
- 2.** Pa çenuar të drejtat e TiK, në rast të një mosmarrëveshje apo paqartësie mes termave të përcaktuara në ligjet dhe rregulloret e zbatueshme në lidhje me këtë Ofertë Referencë, do të zbatohet rendi i mëposhtëm i përparësisë:

Ligji Nr. 04/L-109 për Komunikimet Elektronike i Republikës së Kosovës, Rregullorja për Interkoneksion, Rregullorja për Sigurimin e Qasjes dhe Rregullorja për Zgjedhjen dhe Parazgjedhjen e Operatorit.

NENI 7 PARIME TË PËRGJITHSHME

- 1.** Kjo Ofertë Referencë Interkoneksioni do të jetë bazë për palët për sigurimin dhe realizimin e shërbimeve të interkoneksionit, dhe përcakton dhe rregullon përdorimin e interkoneksionit dhe shërbimeve të tij mes palëve në një Marrëveshje Interkoneksioni.
- 2.** Oferta Referencë e Interkoneksionit përcakton kushtet dhe termat ligjore, teknike dhe financiare si dhe kriteret e procedurat e realizimit të shërbimeve të interkoneksionit.
- 3.** Oferta Referencë e Interkoneksionit përbëhet nga Pjesa e Përgjithshme, dhe Anekset të cilat janë pjesë integrale dhe e pandarë e saj dhe po këtë strukturë do të përmbajë edhe Marrëveshja e Interkoneksionit.
- 4.** Në asnjë rast anekset nuk mund të përmbajnë dispozita të cilat shkojnë në kundërshtim me dispozitat e Marrëveshjes së Interkoneksionit të vendosura në Pjesën e Përgjithshme të saj, përveçse kur ky ndryshim shoqërohet shprehimisht me shkrim për shfuqizim të dispozitës respektive në Pjesën e Përgjithshme të marrëveshjes.
- 5.** Marrëveshja e Interkoneksionit e lidhur në bazë të kësaj Oferte Referencë zëvendëson çdo marrëveshje interkoneksioni të mëparshme të lidhur mes palëve që ka rregulluar ofrimin e shërbimeve të interkoneksionit. Përpara lidhjes së marrëveshjes në bazë të kësaj oferte referente, operatori përfitues duhet të likuidojë të gjitha detyrimet për marrëveshjen pararendëse.

TË DREJTAT DHE DETYRIMET E PALËVE
NENI 8
DETYRIME TË PËRGJITHSHME TË PALËVE

- 1.** Palët interkonektojnë rrjetet e tyre dhe realizojnë në mënyrë të ndërsjelltë shërbimet e interkoneksionit të përcaktuara në Aneks 3 "Përshkrimi Shërbimeve", si dhe në përputhje me të gjitha të drejtat dhe detyrimet e përcaktuara në marrëveshjen e interkoneksionit konform autorizimeve përkatëse dhe akteve të tjera rregulluese nga ARKEP.
- 2.** Palët sigurojnë vazhdimësinë e ofrimit të shërbimeve të përcaktuar në Aneks 3 "Përshkrimi i Shërbimeve". Në rast ndërprerje të shërbimeve, pala në anën e të cilit ndodh ndërprerja, duhet të mundësojë rivendosjen e menjëhershme të shërbimit. Detajet e procedurave të domosdoshme në lidhje me çështjen e mësipërme jepen në Aneksin 7 dhe 12 "Bashkëpunimi i palëve" dhe "Marrëveshja e SLA".
- 3.** Në marrëdhëniet më të tretët, që mund të lindin për shkak të interkoneksionit, palët mund të bazohen dhe përdorin marrëveshjen e interkoneksionit duke shtuar si aneks vetëm pjesën përkatëse me termat e veçantë, ose mund të lidhin marrëveshje të veçanta mes tyre, por pa shkelur detyrimet dhe parimet e kësaj Oferte Referencë.
- 4.** Secila palë merr përsipër që të mos bëjë ndryshime në sistemet/rrjetet dhe në interkoneksionin e tyre, ose në çdo pajisje që përfshihet në të, ose çdo komandë ose protokol, ndryshim i cili mund të ndikojë ose dëmtojë funksionimin e rrjetit të palës tjetër dhe shërbimet e interkoneksionit.
- 5.** Në rast se ndonjëra nga palët kërkon të bëjë ndryshime, ajo duhet të njoftojë me shkrim palën tjetër sipas procedurave përkatëse në këtë Ofertë Referencë. Për ndryshimet që do të bëhen, palët, diskutojnë dhe procedojnë duke nënshkruar mes tyre një aneks të marrëveshjes.
- 6.** Palët do të regjistrojnë të dhënat mbi shërbimet të shkëmbyera në atë masë të përcaktuar në këtë Ofertë Referencë. Informacioni i ruajtur nga secila palë do ti jepet palës tjetër, së cilës i është dhënë e drejta ta përdorë këtë informacion në atë masë të përcaktuar në këtë Ofertë Referencë.
- 7.** Palët marrin përsipër që, përveç rasteve të parashikuara në këtë Ofertë Referencë, gjatë gjithë periudhës së vlefshmërisë së marrëveshjes, të lidhin dhe të mbajnë të lidhura me njëra tjetrën pajisjet/sistemet. Palët bashkëpunojnë për këtë qëllim.
- 8.** Kapaciteti i disponueshëm në qarkun e interkoneksionit do të jetë në përputhje me Aneksin 2, 6 dhe 14 "Interkoneksioni me Rrjetin TiK", "Çështje Teknike", "Bllokskema e Interkoneksionit" të Ofertës Referencë. Me kërkesën e Operatori Përfitues, TiK do të sigurojë kapacitetet shtesë mbi pikën fillestare për të siguruar rregullisht trafikun, për të cilën do të bihet dakord me mendimin e marrëveshjes sipas përcaktimeve në Aneks 6 "Çështje Teknike" dhe Aneks 8 "Parashikimi dhe Porosia për Kapacitetet e Interkoneksionit".
- 9.** Palët janë të detyruara të respektojnë parimin e mosdiskriminimit duke siguruar/garantuar kushte dhe terma të njëjtë në kushte dhe rrethana të njëjta.
- 10.** Implemenitmi i marrëveshjes së interkoneksionit e lidhur në bazë të kësaj Oferte Referencë për të mundësuar realizimin e shërbimeve të ofruara duhet domosdoshmërisht të bëhet brenda 3 muajve nga data e nënshkrimit të saj. Nëse deri në 15 ditë përpara mbarimit të këtij afati Operatori Përfitues nuk ka shfaqur interesim apo bërjen të mundur

nga ana e tij për implementimin e shërbimeve atëherë TiK ka të drejtë të shkëput marrëveshjen me anë të një njoftimi dërguar Operatorit Përfitues.

NENI 9 INTERKONEKSIONI ME RRJETIN TiK

- 1.** Për lidhjen e marrëveshjes së interkoneksionit Operatori Përfitues i bën një kërkesë TiK-ut duke plotësuar kërkesën sipas aneksit 5 "Kerkesa Standarde" të kësaj Oferte Referente të Interkoneksioni si dhe depoziton kopje të kërkesës në ARKEP. TiK dhe Operatori Përfitues do të zbatojnë parashikimet e Rregullores për Sigurimin e Qasjes dhe Rregullores për Interkoneksion për procedurën e negociatava dhe lidhjen e marrëveshjes së interkoneksionit.
- 2.** Në kërkesën për interkoneksion, Operatori Përfitues duhet të përfshijë të dhëna të detajuara të kushteve të tij teknike për Shërbimet e Interkoneksionit objekt i kësaj Oferte Referencë dhe të gjitha informacionet e kërkuara me Kërkesën Standarde të përshkruar në aneksin 5. TiK në afat prej 30 ditësh do të shqyrtoj kërkesën e kompletuar dhe do ti kthejë përgjigje Operatorit Përfitues në lidhje me kërkesën e bërë.
- 3.** TiK dhe Operatori Përfitues duhet të negociojnë me mirëkuptim me synimin për të arritur një marrëveshje mbi një Planifikim Rrjeti apo të veprimeve të duhura për të ofruar shërbimet e kërkuara brenda një afati jo më larg se 60 ditë pas shqyrtimit të kërkesës. Çdo vonesë në respektimin e këtij afati që mund të vie si pasojë e mos veprimeve apo mos kryerjes së obligimeve që dalin nga kjo Ofertë Referencë Interkoneksioni nga ana e Operatorit Përfitues do të mbeten përgjegjësi e tij.
- 4.** Pasi TiK dhe Operatori Përfitues të kenë rënë dakord për zgjidhjen teknike, kjo zgjidhje duhet të bëhet e ditur si Planifikim i Rrjetit dhe duhet të përfshihet në Marrëveshjen e propozuar të Interkoneksionit mes TiK dhe Operatorit Përfitues, e cila nënshkruhet me dakordësinë e palëve për kushtet dhe termat për realizimin e interkoneksionit mes palëve. Në rastet kur lidhja e marrëveshjes bëhet në zbatim të urdhërit të ARKEP, marrëveshja nënshkruhet sipas kushteve dhe termave të përcaktuara në këtë urdhër.
- 5.** Interkoneksioni me rrjetin TiK do të realizohet në përputhje me dispozitat e përcaktuara në Rregulloren për Sigurimin e Qasjes dhe Rregulloren për Interkoneksion, në Ofertën Referencë dhe në Marrëveshjen e Interkoneksionit. Detaje më të hollësishme në lidhje me realizimin e interkoneksionit (dhe veçanërisht lidhur me; pika e interkoneksionit, llojet e pikave të interkoneksionit, vendodhja e pikave të interkoneksionit, lloji i interkoneksionit) janë të dhëna në Aneks 2 "Interkoneksioni me Rrjetin TiK".
- 6.** Pikë interkoneksioni do të konsiderohet vendi ku rrjeti i TiK lidhet me rrjetin e Operatorit Përfitues dhe do të jetë pika fizike ku lidhja mund të shkëputet me qëllim kryerjen e testeve. Definicioni lidhur me Pikën e Interkoneksionit është dhënë në Aneks1 dhe Aneks2 "Përkufizime" dhe "Interkoneksioni me Rrjetin TiK".
- 7.** Pika e interkoneksionit është një shërbim ku Operatori Përfitues lidhet në interkoneksion me TiK. Operatori Përfitues lidh centralin gateway të tij me centralin përkatës të TiK në interkoneksion nëpërmjet linjave të interkoneksionit prej 2Mbps. Në këtë mënyrë implementohet një lidhje fizike dhe logjike nëpërmjet dy rrjeteve duke caktuar në këtë mënyrë dhe trafikun e interkoneksionit.
- 8.** Rrjeti i TiK për qëllime të interkoneksionit është ndarë në 1 zonë kombëtare. Kjo zonë interkoneksioni së bashku me kodet përkatëse të numeracionit është paraqitur në Aneks 17 "Zonat e Interkoneksionit dhe Numeracioni i TiK".

9. TiK ofron Pikë Interkoneksioni në zonën kombëtare, dhe në ato zona ku TiK ka central dhe sipas mundësive teknike për të ofruar interkoneksion. Pika e interkoneksionit lidhet me centralet e interkoneksionit të TiK dhe Operatorit Përfitues. Vendodhja e pikës së interkoneksionit varet nga forma e interkoneksionit. Për interkoneksionin e bashkëvendosur në TiK pikat e interkoneksionit ndodhen në centralet respektive të TiK. Centralet ku ekziston mundësia për interkoneksion paraqiten në Aneks17 "Zonat e Interkoneksionit dhe Numeracioni i TiK"

10. Operatori Përfitues, ka të drejtë të kërkojë të interkonektohet me TiK në pikat e interkoneksionit të cituara në Aneks 2 "Interkoneksioni me Rrjetin TiK", sipas zgjidhjes së negociuar mes palëve, përveç rasteve të cilat bazohen në kritere objektive, të tilla si pamundshmëria teknike apo nevoja për të ruajtur integritetin e rrjetit të TiK. Shërbimet që përfitohen në secilën pikë interkoneksioni dhe kategoritë e trafikut të cilat pranohen në to janë cituar në Aneks 2 "Interkoneksioni me Rrjetin TiK".

11. Specifikime lidhur me Interkoneksionin me rrjetin e Operatorit Përfitues, jepen në Aneks2 "Interkoneksioni me rrjetin TiK"

NENI 10 BASHKËVENDOSJA

1. TiK në këtë Ofertë Referencë Interkoneksioni dhe specifikisht në Aneks3 "Përshkrimi i Shërbimeve" përshkruan shërbimin e bashkëvendosjes për interkoneksion të pajisjeve, përdorimin e përbashkët të infrastrukturës, me Operatorët Përfitues, për përfitimin nga ana e Operatorit Përfitues të shërbimeve të Ofruara nga TiK.

2. TiK do të zbatojë procedurat dhe kushtet për ofrimin e shërbimeve të bashkëvendosjes në përputhje me përcaktimet e Rregullores për Sigurimin e Qasjes dhe Rregullores për Interkoneksion të ARKEP.

3. TiK kundrejt përballimit të kostove nga Operatori Përfitues do të ofrojë një nivel të arsyeshëm të burimeve teknologjike të infrastrukturës së tij në pikat ku bashkëvendosja ofrohet për qëllime interkoneksioni.

4. Operatori Përfitues në bashkëvendosje angazhohet të kërkojë të vendosë vetëm pajisjet e nevojshme për të siguruar shërbimet e ofruara nga ana e TiK dhe nuk do të përdorë këto pajisje për ndonjë qëllim tjetër që nuk është specifikisht i përcaktuar në këtë ofertë. Shërbimet që do të përfitohen specifikohen në Aneks 3 dhe 4 "Përshkrimi i Shërbimeve" dhe "Tarifat e Shërbimeve".

NENI 11 SHËRBIMET E INTERKONEKSIONIT

1. Interkoneksioni me rrjetin TiK, realizohet bazuar në këtë Ofertë Referencë pasi Operatori Përfitues ka plotësuar të gjitha kushtet dhe kërkesat teknike e ligjore sipas procedurave përkatëse. TiK/Operatori Përfitues implementon dhe realizon kapacitetin e interkoneksionit, numeracionet dhe shërbimet përkatëse sipas kësaj Oferte Referencë dhe përcaktimeve në Marrëveshjen e Interkoneksionit.

2. Interkoneksioni do të përdoret konform Autorizimeve përkatëse të Palëve vetëm për sigurimin e Shërbimeve të përcaktuara në Aneks 3 "Përshkrimi i Shërbimeve", të kategorizuara në Shërbime të Trafikut dhe Shërbime të Tjera.

3. Marrëveshja e Interkoneksionit hartohet bazuar në këtë Ofertë Referencë dhe përmban kushtet dhe termat për ofrimin e një, disa apo të gjitha shërbimeve të përshkruara në këtë Ofertë Referencë. TiK do të implementojë ofrimin e atyre shërbimeve mes palëve të cilat janë specifikuar qartë në kërkesën për interkoneksion nga ana e Operatorit Përfitues dhe për të cilat është rënë dakord në negociata mes palëve. Në çdo rast, Operatori Përfitues mund të kërkojë implementimin e ndonjë shërbimi sipas kësaj Oferte Referencë edhe pas nënshkrimit të Marrëveshjes së Interkoneksionit, sipas procedurave të parashikuara në Aneksin 12 "Marrëveshja e Nivelit të Shërbimit-SLA".

4. Asnjë nga palët në marrëveshjen e interkoneksionit nuk do të dërgojë, dhe nuk është e detyruar të përcjellë apo pranojë thirrje (shërbim trafiku) të ndonjë kategorie të papërcaktuar në Aneks 3 "Përshkrimi i Shërbimeve", pa miratimin paraprak mes palëve dhe në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi.

5. Asnjë nga palët në marrëveshjen e interkoneksionit nuk është e detyruar të japë ose të autorizojë qasje të shërbimeve të tjera pa qenë e përcaktuar dhënia e tyre në Aneks 3 "Përshkrimi i Shërbimeve".

6. TiK ofron Shërbimin e Bashkëvendosjes për Interkoneksion për Operatorin Përfitues me kërkesën e tij për përfitimin e këtij shërbimi, i cili konsiston në ofrimin e infrastrukturës mbështetëse dhe në vendosjen e pajisjeve të Operatorit Përfitues në Ambientet e TiK. Detajet e këtij shërbimi jepen në Aneks 3 "Përshkrimi i Shërbimeve".

7. Qendrat e prezencës fizike të TiK ku mund të ofrohet bashkëvendosja ose mundësia për lidhjen fizike për realizimin e interkoneksionit deri në centralin më të afërt ku ofrohen shërbimet e pikës së interkoneksionit paraqiten në Aneks16 "Mundësitë për Bashkëvendosje".

NENI 12 TARIFAT E SHËRBIMEVE TË INTERKONEKSIONIT

1. Operatori Përfitues do ta paguajë TiK, sipas tarifave përkatëse, për secilin shërbim të Interkoneksionit të ofruar prej tij në bazë të kësaj Oferte Referencë. Përshkrimi i shërbimeve jepet Aneks 3 "Përshkrimi i Shërbimeve" ndërsa tarifat përkatëse jepen në Aneks 4 "Tarifat e Shërbimeve". Tarifat janë dhënë pa TVSH.

2. Tarifat për Shërbimet e Bashkëvendosjes dhe Shërbimet e Lidhjes të ofruara nga TiK jepen në Aneks 4 "Tarifat e Shërbimeve".

3. Koha e tarifueshme për çdo thirrje, tarifimi i numrit të thirrjeve dhe shërbimeve të tjera janë të përcaktuara sipas përkufizimeve, kushteve dhe termave të kësaj Oferte Referencë.

4. Tarifat mund të ndryshohen në përputhje me kuadrin rregullator përkatës dhe përcaktimeve në Marrëveshjen e Interkoneksionit.

5. Tarifat e shërbimeve të interkoneksionit të TiK të cilat janë objekt rregullimi nga ARKEP, do të zbatohen njëherazi në marrëdhënien mes palëve, me hyrjen në fuqi të aktit rregullator përkatës të miratuar nga ARKEP. TiK do të njoftojë Operatorin Përfitues për tarifat e reja dhe datën e hyrjes së tyre në fuqi. Për tarifat e terminimit të trafikut ndërkombëtar të tranzituar drejt TiK-ut nga operatorët vendor, për çdo ndryshim të tarifës do të njoftohet Operatori Përfitues. Në rastin e ngritjes së tarifës së terminimit për këtë shërbim, tarifa e re do të hyjë në fuqi 7 dite nga njoftimi i Operatorit Përfitues përmes postës elektronike (email).

NENI 13
NIVELI I INTERKONEKSIONIT DHE NDRYSHIMI I KAPACITETEVE

- 1.** Interkoneksioni i Rrjetit të Telekomunikacioneve të TiK me rrjetin e Operatorit Përfitues, specifikimet e të cilit paraqiten në Aneks 2 "Interkoneksioni me Rrjetin TiK", do të bëhet në nivelin E1 (2048 kb/s). Kapaciteti i interkoneksionit i Ofruar nga TiK përcaktohet nga numri i E1-shave të nevojshëm për të realizuar treguesit e cilësisë sipas normave të përcaktuara në licencat/autorizimet përkatëse të TiK dhe të Operatorit Përfitues.
- 2.** Palët ofrojnë parashikimet e trafikut për qëllime të planifikimit të rrjetit për të siguruar kapacitetet e duhura të komutimit dhe transmetimit për të mbajtur një përqindje mesatare të përdorimit të interkoneksionit mes 60%-75% në orët e peak-ut në një ditë të zakonshme (përveç rasteve të situatave emergjente dhe festave). Procesi i parashikimit jepet i përshkruar në Aneks 8 "Parashikimi dhe Porosia për Kapacitetet e Interkoneksionit".
- 3.** Ndryshimi i kapacitetit të interkoneksionit do të bëhet referuar e mbështetur në treguesit e cilësisë të realizuar, bazuar edhe në procesin e parashikimit dhe kryerjes së porosisë për kapacite interkoneksioni. Specifikimet për ndryshimin e kapacitetit janë dhënë në Aneks 8 "Parashikimi dhe Porosia për Kapacitetet e Interkoneksionit".

NENI 14
NDËRFAQET TEKNIKE, PROTOKOLET DHE SIGURIMI I PËRPUTHSHMËRISË SË SHËRBIMEVE

- 1.** Implementimi i marrëveshjes së interkoneksionit do të bëhet mbi bazën e kërkesave/kriterëve teknike të përcaktuara në këtë Ofertë Referencë dhe në marrëveshjen e interkoneksionit. Palët do të realizojnë shërbimet e interkoneksionit duke u bazuar në mënyrë rigoroze në kërkesat/kriteret dhe procedurat teknike sipas përcaktimeve të kësaj Oferte Referencë dhe në mënyrë të veçantë:
 - a. Planifikimi i rrjetit
 - b. Pika e interkoneksionit
 - c. Kapaciteti i qarkut të interkoneksionit
 - d. Ndërfaqe Fizike
 - e. Sinkronizimi
 - f. Sinjalizimi
 - g. Rrugëzimi i trafikut
 - h. Numeracioni
 - i. CLI
 - j. Menaxhimi i Pajisjeve
 - k. Ndryshimet në Rrjetë
 - l. Blllokskema
- 2.** Në mënyrë të detajuar kërkesat/kriteret dhe procedurat teknike jepen në Aneks 6 "Çështje teknike", Aneks 7 "Bashkëpunimi i Palevë", Aneks 12 "Marrëveshja e SLA" dhe Aneks 14 "Blllokskema e Interkoneksionit".
- 3.** Lidhur me ndryshimet në Rrjetë, TiK angazhohet që ndryshimet në Rrjetin e tij sipas programeve që ka për zhvillime e përmirësime që kanë të bëjnë me ndryshimet të mundshme të pikës së Interkoneksionit, apo ndryshime të parametrave të rrugëzimit e që ndikojnë në marrëdhëniet ekzistuese të interkoneksionit t'ia bëjë me dije Operatorit Përfitues e do të japë përfituesit njoftime të mjaftueshme. Për rastet kur ndryshimet do të ndikojnë në ndërprerjen e dhënjes së shërbimeve të Interkoneksionet Operatorit Përfitues, ai do të

njoftohet siç parashihet në Rregulloren e Qasjes të miratuar nga ARKEP. Për rastet e ndryshimeve tjera, para datës së parashikuar për ndryshim TiK do të përcaktojë hollësi teknike të ndryshimeve të sistemit dhe datës së parashikuar për ndryshim. TiK do ti japë përfituesit informacione të arsyeshme për ndikimin e plotë në shërbimet e ofruara si dhe rradhën e punëve. Nëse TiK kërkon të bëjë një ndryshim të një specifikimi në të cilën është autori, ai do të japë relacionet e duhura përfituesit, që nuk do të jenë më pak se 60 ditë, para datës së parashikuar si datë të ndryshimit të specifikimit.

NENI 15 PARAQITJA E IDENTIFIKIMIT TË LINJËS THIRRËSE (CLI)

- 1.** Në momentin kur njëra Palë përcjell thirrjet në rrjetin e Palës tjetër, është e detyruar të transmetojë Identitetin e Numrit Thirrës, pa e ndryshuar ose fshehur atë, duke përdorur protokollin e sinjalizimit Nr.7
- 2.** CLI duhet që gjithmonë të paraqesë numrin korrekt të pikës fundore të rrjetit publik në të cilin është origjinuar thirrja. Ky numër është një numër i cili është alokuar nga Autoriteti kompetent.
- 3.** Secila Palë garanton rrugëzimin transparent të Informacionit të Identitetit të Numrit Thirrës, pa e ndryshuar ose fshehur, nga rrjeti i saj dhe dërgimin e Identitetit të Numrit Thirrës në rrjetin e Palës tjetër.
- 4.** Operatori Përfitues detyrohet të garantojë mundësinë e paraqitjes së CLI si dhe mosndryshimin (tjetërsimin) e saj.
- 5.** Çdo ndryshim/modifikim apo fshehje e Identitetit të Numrit Thirrës përbën një shkelje të kushteve të marrëveshjes së interkoneksionit si dhe një shkelje ligjore. Në rastet kur një operator në bazë të provave që disponon faktin se Operatori Përfitues modifikon apo fsheh CLI e thirrjeve të përcjella nga operatori përfitues, operatori ka të drejtë të paralajmërojë me shkrim operatorin në shkelje duke njoftuar njëkohësisht dhe ARKEP, për pezullimin e ofrimit të shërbimeve të interkoneksionit, nëse në mënyrë të menjëhershme dhe në çdo rast jo më vonë se brenda një afati prej 24 orësh nga marrja e njoftimit, nuk ndërpritet shkelja e konstatuar. Në njoftimin e dërguar përfshihen provat që faktojnë shkeljen e pretenduar, seritë numerike të cilat janë keqpërdorur, si dhe masa e pezullimit që do të merret nga operatori ankimes nëse shkelja nuk ndërpritet brenda afatit të caktuar. Brenda këtij afati, operatori në shkelje duhet të ndërpres menjëherë shkeljen e njoftuar ose nëse pretendon se nuk ka kryer asnjë shkelje të paraqes kundërshtimet dhe provat e tij pranë operatorit njoftues dhe ARKEP, duke i njoftuar paraprakisht përmes postës elektronike ose përmes shkresës fizike dhe brenda 5(pesë) ditëve kalendrike të paraqes provat që disponon.
- 6.** Operatori i njoftuar për shkeljen ka detyrimin që të përgjigjet menjëherë kundrejt njoftimit të marrë.
 - a. Në rast se operatori i njoftuar për shkeljen nuk e ndërpret atë brenda afatit të caktuar në njoftim ose nëse pretendon se nuk e ka kryer shkeljen, nuk njofton paraprakisht përmes postës elektronike ose përmes shkresës fizike dhe brenda afatit 5 (pesë) ditor nuk paraqet provat që vërtetojnë pretendimin e tij, atëherë operatori që ka bërë njoftimin për shkelje pezullon ofrimin e shërbimeve të interkoneksionit sipas njoftimit të bërë;
 - b. Nëse operatori i njoftuar për shkeljen nuk ndërpret shkeljen e faktuar brenda 24 orëve nga marrja e njoftimit ose nuk dërgon mesazhin paraprak se nuk është në shkelje dhe për këtë do të dërgojë provat e tij brenda 5 ditëve, atëherë operatori i dëmtuar pezullon në fund të këtij afati ofrimin e shërbimeve të interkoneksionit;

- c. Në rast se operatori i njoftuar për shkeljen dërgon mesazhin paraprak se nuk është në shkelje dhe për këtë do të paraqes brenda afatit provat e tij dhe në përfundim të këtij afati nuk paraqet asnjë provë, atëherë operatori i dëmtuar ndërpret pas (pesë) ditëve nga njoftimi i bërë, ofrimin e shërbimeve të interkoneksionit.

7. Pala pretenduese e shkeljes do të konsiderojë provë te mos modifikimit/tjetërsimit te CLI, dëftesën tatimore qe sipërmarrësi paguan pranë organeve tatimore te Republikës se Kosoves për faturat/faturen e atyre/atij konsumatorve/konsumatori nga numri i te cilëve/cilit figuron te jetë origjinuar thirrjet/thirrja, CLI e te cilave/te cilës pretendohet te jene/jete modifikuar. Njëkohësisht me kërkesën e palës pretenduese te shkeljes, sipërmarrësi duhet ti vë në dispozicion kopje të kontratës me konsumatorin nga numri i te cilit janë gjeneruar thirrjet dhe njëkohësisht faturat e këtij konsumatori. Pala pretenduese do të vijojë pezullimin e shërbimeve deri në momentin e paraqitjes dhe verifikimit te provave te mësipërme.

8. Pala pretenduese e shkeljes do provojë dyshimet e saj për modifikim te CLI apo tjetërsim të trafikut mbi evidenca qe lidhen me volumin normal te trafikut te operatorit. Origjinimi i një numri te konsiderueshëm thirrjesh nga një rang i caktuar numeracioni ne një hark kohor te caktuar, kohëzgjatjes mesatare te bisedës, evidentimin e bisedave te shumëfishta, mungesën e informacioneve te përshkruara ne pikën 7 etj.

9. Përshkrimi më i detajuar mbi paraqitjen e identifikimit të linjës thirrëse jepet në pikën 10 të Aneks 6 "Çështje Teknike".

NENI 16

MATJET, DEKLARIMI DHE DAKORDIMI I TRAFIKUT/PROCEDURAT

- 1.** Palët do të masin trafikun telefonik të zhvilluar në qarkun e interkoneksionit me treguesit vlerësues të tij.
- 2.** Procedurat përkatëse dhe specifikimet për kohën e matur për tarifim, thirrjet e tarifuara dhe matjet e trafikut janë të dhëna në Aneks 9 "Matja, Deklarimi dhe Dakordimi i Trafikut/Procedurat".
- 3.** Procedurat për Deklarimin dhe Dakordimin e Trafikut jepen të specifikuara ne Aneks 9 "Matja, Deklarimi dhe Dakordimi i Trafikut/Procedurat".
- 4.** Mosmarrëveshjet për matjet e trafikut do të zgjidhen sipas procedurave të përcaktuara në Aneks 9 "Matja, Deklarimi dhe Dakordimi i Trafikut/Procedurat".

NENI 17

FATURIMI, PAGESAT DHE GARANCIA

- 1.** Detyrimet në lidhje me Faturimin dhe Pagesat sipas kësaj Oferte Referencë do të zbatohen sipas natyrës dhe specifikimeve të secilit shërbim të ofruar nga TiK/Operatori Përfitues e te përshkruar në Aneks 3 "Përshkrimi i Shërbimeve" që nga dita në të cilën ka hyrë në fuqi marrëveshja e interkoneksionit.
- 2.** TiK/Operatori Përfitues do të faturojë Operatorin Përfitues/TiK për shërbimet e ofruara pas shkëmbimit të të dhënave të matjeve të trafikut, por jo më vonë se data 5 (pesë) e muajit që pason periudhën e faturimit.

3. Faturimi i trafikut, faturimi për Shërbimet e Interkoneksionit të ndryshme nga shërbimi i trafikut si dhe faturimi për shërbimet e tranzitimit do të bëhet në përputhje me procedurat e përcaktuara në Aneks 10 "Faturimi, Pagesat dhe Garancia".

4. Operatori Përfitues/TiK ka detyrimin të paguajë të gjitha detyrimet përkatëse, brenda pesëmbëdhjetë (15) ditëve nga data e faturës. Të gjitha taksat dhe detyrimet ligjore duhet të paguhen nga pala përgjegjëse sipas ligjeve dhe rregullave që janë në fuqi në Republikën e Kosovës. Procedurat specifike për pagesat jepen në Aneks 10 "Faturimi, Pagesat dhe Garancia".

5. Nëse Operatori Përfitues nuk kryen pagesat brenda afatit të përcaktuar në pikën 4 të këtij neni, atëherë do të aplikohet kamatëvonesë në masën 0.5% e vlerës së shumës së detyruar për çdo ditë kalendrike që tejkalohet ky afat, por jo më shumë se për 10(dhjetë) ditë ne vijim.

6. Me nënshkrimin e marrëveshjes së interkoneksionit Operatori Përfitues/TiK i siguron një garanci bankare TiK-ut/Operatorit Përfitues sipas formatit të garancisë dhënë në Aneks 11 "Formulari i Garancisë",e cila do të jetë e lëshuar nga një Bankë komerciale për shumën të përcaktuar në bazë të Aneksit 10 "Faturimi,Pagesat dhe Garancia".

7. Në rast se detyrimi neto është negativ TiK është e gatshme të vendosë një garanci sipas përlogaritjeve në pikën 5 "Garancia Financiare" në Aneks 10 "Faturimi,Pagesat dhe Garancia", në rast se kjo kërkohet nga Operatori Përfitues.

8. Vlefshmëria e Garancisë do të jetë minimalisht tre muaj më shumë se periudha e vlefshmërisë së marrëveshjes, duke filluar nga data e nënshkrimit të marrëveshjes së interkoneksionit. Një (1) muaj para datës së përfundimit te periudhës së vlefshmërisë do të dorëzohet një garanci e re. Në kohën e dorëzimit të Garancisë, TiK/Operatori Përfitues do ti lirojë Operatorit Përfitues/TiK garancinë pararendëse.

9. Garancia do të kërkohet të aktivizohet (preket) menjëherë pjesërisht apo tërësisht nga ana e TiK/Operatorit Përfitues në raste mospagese deri në përfundimin e periudhës së llogaritjes së kamatvonesës të shumave neto që Operatori Përfitues i detyrohet TiK, për shërbimet e interkoneksionit të ofruara në përputhje me këtë Ofertë Referencë dhe specifikisht sipas Aneksit 10 "Faturimi, Pagesat dhe Garancia".

10. Në çdo rast, mosdorëzimi i garancisë brenda 15 ditëve nga nënshkrimi i marrëveshjes së interkoneksionit siç përshkruhet më sipër dhe në detaje në Aneks 10 "Faturimi, Pagesat dhe Garancia" do të konsiderohet arsye për palën jo në shkelje për mosimplementimin e shërbimeve të interkoneksionit në rastin e operatorëve të rinjë dhe pezullimin e shërbimeve te interkoneksionit në rastin e operatorëve ekzistues.

11. Çështjet specifike në lidhje me sigurimin e garancisë në favor të TiK/Operatorit Përfitues si dhe rastet e kërkesës për prekjen (aktivizimin) e saj jepen në Aneks 10 "Faturimi, Pagesat dhe Garancia"

12. Mospërbushja e detyrimeve që rrjedhin nga neni 16 dhe 17 i kësaj Ofertë Referencë do të çojnë në aplikimin e sanksioneve sipas specifikimeve në këtë Ofertë Referencë dhe në Marrëveshjen e Palëve.

NENI 18
STANDARDET E CILËSISË DHE MARRËVESHJA PËR NIVELIN E SHËRBIMIT
SLA

- 1.** TiK dhe Operatori Përfitues janë të detyruar të zbatojnë standardet e cilësisë së shërbimeve sipas Rregullores për Sigurimin e Qasjes dhe Rregullores për Interkoneksion.
- 2.** TiK dhe Operatori Përfitues angazhohen të sigurojnë parametrat e cilësisë për shërbimet përkatëse konform përcaktimeve në Rregulloren për Sigurimin e Qasjes dhe Rregullores për Interkoneksion. Cilësia dhe siguria për transportimin e trafikut të interkonektuar nga TiK do të jetë në përputhje me cilësinë dhe sigurinë që TiK ofron për trafikun e tij. Me qëllim mbajtjen e këtyre parametrave të cilësisë TiK do të ofrojë informacione të dhëna në Aneks 12 "Marrëveshja e Nivelit të Shërbimit - SLA".
- 3.** Palët e interkonektuara shkëmbejnë të dhëna për treguesit e cilësisë (QoS) çdo muaj brenda datës 5 të muajit pasardhës. Në rast se njëra palë nuk zbaton standardet e cilësisë, pala tjetër ka të drejtë të pezullojë ofrimin e shërbimeve të interkoneksionit, pasi ka shterrur të gjitha mundësitë bazuar në procesin e paralajmërimit duke i dërguar fillimisht njoftim palës tjetër, si dhe ARKEP-it sipas procedurave të përcaktuara në nenin 27 "Shkelja, Pezullimi dhe Shkëputja e Marrëveshjes së Interkoneksionit".
- 4.** TiK angazhohet që të sigurojë shërbimet e përshkruara në Marrëveshjen e Interkoneksionit sipas kësaj Oferte Referencë në Aneks 3 "Përshkrimi i Shërbimeve" dhe ka përcaktuar procedurat kryesore me anë të të cilave arrihet niveli i kërkuar i Cilësisë së Shërbimeve. Për këtë qëllim, TiK ka përgatitur një Marrëveshje të Nivelit të Shërbimit (SLA-Service Level Agreement), që mbulon në veçanti aspekte të cilësisë së sigurimit të Shërbimeve të Interkoneksionit. Kjo Marrëveshje e Nivelit të Shërbimit është pjesë e Marrëveshjes së Interkoneksionit të lidhur ndërmjet TiK dhe Operatorit Përfitues. Marrëveshja e Nivelit të Shërbimit konsiderohet si një dokument në zhvillim, objekt diskutimi dhe kur është e nevojshme mund të rishikohet.
- 5.** Procedurat dhe koha e realizimit lidhur me ofrimin dhe mirëmbajtjen e shërbimeve të përfshira në këtë Ofertë Referencë jepen në Aneks 12 "Marrëveshja e Nivelit të Shërbimit-SLA".

NENI 19
KONFIDENCIALITETI

- 1.** Për zbatimin e marrëveshjes së interkoneksionit sipas kësaj Oferte Referencë, palët do të mbajnë Informacionin Konfidencial kur jepet si "i tillë" dhe do angazhohen që stafi dhe drejtuesit, punonjësit, e agjentet do të informohen për rëndësinë e ruajtjes së informacionit dhe nuk do t'ia mundësojnë këtë informacion palëve të treta.
- 2.** Operatori Përfitues do të angazhohet si dhe do sigurojë TiK që të dhënat dhe/ose informacioni nuk do disponohet nga persona të pa kualifikuar ose jo ekspert që mund t'i transformojnë ose të keqinterpretojnë informacionin ose të dhënat e ofruara nga TiK.
- 3.** Pala që disponon Informacion Konfidencial do të kufizojë përmbajtjen e të dhënave për personat që për nga natyra e punës duhet të njihen me përmbajtjen e Informacionit Konfidencial. Informacioni Konfidencial do të përdoret në masën e nevojshme vetëm për qëllimin e lidhjes dhe zbatimit të marrëveshjes së interkoneksionit për shërbimet e ofruara nga TiK.
- 4.** Përfshihen nga rregulli i klauzolës të mësipërme informacioni ose çdo dokument tjetër:

- a) që është siguruar në mënyrë të ligjshme nga të tretët;
- b) që njihej si i ligjshëm për t u publikuar nga marrësi në ditën e marrjes;
- c) që është ose bëhet publik jo në kundërshtim me këto dispozita të konfidencialitetit;
- d) që është i lirë në zotërim të publikut ose bëhet publik nga përfaqësuesit e TiK-ut;

5. Për qëllim të marrëveshjes së interkoneksionit nëqoftë se njëra nga palët ndodhet para faktit të publikimit të dhënave sipas pikave **4.c** dhe **4.a** duhet të njoftojë sa më shpejtë të jetë e mundur përfaqësuesit e Palës tjetër.

6. Në çdo rast, palët janë të detyruara të vazhdojnë të respektojnë kushtet e konfidencialitetit sipas këtij neni deri në 5 (pesë) vjet pas përfundimit ose ndërprerjes së njëanshme të saj.

NENI 20 SIGURIA DHE MBROJTJA E TË DHËNAVE

1. Asnjëra palë nuk do jetë përgjegjëse për përmbajtjen e mesazheve, informacionit dhe të dhënave të transmetuara nga palët në qarkun e interkoneksionit të shërbimeve të ofruara.

2. Palët do të veprojnë në përputhje me të drejtat dhe detyrimet sipas legjislacionit përkatës për privatësinë dhe mbrojtjen e të dhënave.

NENI 21 TË DREJTAT E PRONËSISË INTELEKTUALE

1. Marrëveshja e Interkoneksionit nuk i jep palëve ndonjë të drejtë pronësie intelektuale që i përket palës tjetër për efekte të rregullimit të marrëdhënieve që lindin dhe zhvillohen për shkak të kësaj Oferte Referencë.

2. Kur pronësia intelektuale zhvillohet në lidhje me zbatimin e marrëveshjes së interkoneksionit, atëherë në mungesë të ndonjë marrëveshje tjetër midis palëve, pronësia intelektuale do ti mbetet palës e cila e zhvilloi atë, gjithmonë me kusht që sipas marrëveshjes së interkoneksionit, pala tjetër duhet të ketë një leje me shkrim që të përdorë pronësinë intelektuale pa pagesë me qëllim zbatimin e marrëveshjes.

NENI 22 KALIMI I TË DREJTAVE DHE DETYRIMEVE TË PALËVE

1. Marrëveshja e Interkoneksionit është e detyrueshme dhe e vlefshme vetëm për palët nënshkruese.

2. Marrëveshja e Interkoneksionit nuk mund të kalohet, transferohet apo tjetërsohet nga palët përveçse kur ky veprim është i ligjshëm dhe në konformitet me të drejtat civile që shoqërojnë ndryshime që mund të ndodhin në pronësinë e ndonjërës palë apo të dyjave së bashku.

3. Në rast kalimi të të drejtave të pronësisë nga palët me ndonjërin nga format që nje Ligji mbi Detyrimet, pala pasuese detyrimisht duhet të nënshkruajë një marrëveshje të re me të njëjtat kushte si marrëveshja ekzistuese.

4. Asnjëra nga palët nuk kanë të drejtë të kalojë marrëveshjen e Interkoneksionit ose të transferojnë asnjë të drejtë ose detyrim në mënyrë të plotë ose të pjesshme, në mënyrë direkte ose indirekte që rrjedh nga marrëveshja, tek palët e treta, pa marrë më parë miratim me shkrim nga pala tjetër.

NENI 23 PËRDORIMI ABUZIV I MARRËVESHJES SË INTERKONEKSIONIT

- 1.** Lidhjet e Interkoneksionit do të përdoren nga secila Palë në marrëveshjen e interkoneksionit bazuar në këtë Ofertë Referencë, ekskluzivisht për shërbimet e rëna dakord midis palëve.
- 2.** Palët bien dakord që të bëjnë të gjitha përpjekjet e nevojshme për zbulimin, identifikimin dhe eliminimin e çdo orvajtje për përdorimin e shërbimeve në kundërshtim me qëllimin për të cilin është ofruar si dhe për çdo rritje artificiale të trafikut për shkak të ndonjë veprimi abuziv nga palë të treta. Gjithashtu palët bien dakord që të bëjnë të gjitha përpjekjet e nevojshme për shkëmbimin e informacionit në lidhje me bashkëpunimin brenda masave të caktuara për parandalimin e shfaqjes së abuzimeve të tilla në rrjetet përkatëse të Palëve dhe eliminimin e tyre.
- 3.** Evidentimi i një ose më shumë situatave të përcaktuara në këtë nen konsiderohet si përdorim abuziv dhe përbën shkelje të kushteve të marrëveshjes.
- 4.** Me kërkesë të Palës (së cënuar) që identifikon një ose më shumë situata abuzive, Pala tjetër (në shkelje) është e detyruar të korrigjojë situatën dhe të japë një përgjigje brenda një afati 15-ditor nga marrja e pretendimit. Nëse abuzimi vazhdon, aplikohen sanksionet sipas parashikimeve në Marrëveshjen e Interkoneksionit, sipas kësaj Oferte Referencë.
- 5.** Në çdo rast, për dëmet financiare që kanë ardhur si pasojë e shkeljeve të përmendura më sipër në këtë nen, Pala jo në shkelje ka të drejtën e kompensimit dhe faturimit të vlerës financiare, vlerë e cila do të konsiderohet detyrim financiar sipas kushteve dhe termave të kësaj Ofertë Reference në Marrëveshjen e Interkoneksionit.

NENI 24 KUFIZIME TË PËRGJEGJËSISË

- 1.** Asnjëra nga palët nuk do të mbajë përgjegjësi për kërkesat, procedurat ose paditë e ngritura nga përdoruesit e njërës palë kundër palës tjetër. Secila palë është e vetme përgjegjëse ndaj përdoruesve të saj qoftë për shkaqe që mund të rrjedhin nga zbatimi ose moszbatimi i marrëveshjes së interkoneksionit.
- 2.** Palët nuk do të konsiderohen përgjegjëse në rast të ndonjë kufizimi ose ndërpreje të plotë të Interkoneksionit nëse kjo gjykohet e nevojshme nga një organ kompetent si ARKEP, dhe/ose Organ Gjyqësor. Në këtë rast, secila nga palët është e detyruar të njoftojë në kohë palën tjetër, duke i vënë në dispozicion të gjithë informacionin e mundshëm.
- 3.** Përveç rasteve kur përcaktohet qartësisht nga marrëveshja e interkoneksionit, Kapaciteti i Interkoneksionit do të përdoret nga Operatori Përfitues vetëm për të realizuar dhe ofruar shërbimet e përcaktuara në Aneks 3 "Përshkrimi Shërbimeve" të kësaj Oferte Referencë në përputhje me të gjithë të drejtat dhe detyrimet e tjera të marrëveshjes konform autorizimeve përkatëse dhe akteve të tjera rregulluese nga ARKEP.
- 4.** Palët bien dakord që do të bëjnë të gjitha përpjekjet e mundshme për zbulimin, identifikimin dhe eliminimin e ndonjë praktike të pandershme, ose zvogëlim apo rritje artificiale të volumit të trafikut si rezultat i veprimeve abuzive të palëve apo të të tretëve dhe që do të shkëmbejnë informacionin e lidhur me matjet e trafikut me qëllim parandalimin e shfaqjes së një fenomeni të tillë dhe eliminimin e kësaj sjellje abuzive, në përputhje me

legjislacionin në fuqi, dispozitat e nenit 14 dhe 18 dhe mundësitë teknike të rrjeteve/sistemeve të tyre. Në rast se ky aktivitet abuziv origjinohet nga rrjeti/sistemi i njëjës Palë, do të konsiderohet shkelje e marrëveshjes nga pala tjetër.

NENI 25 FORCA MADHORE

1. Asnjëra nga palët nuk do të jetë përgjegjëse për ndonjë shkelje të marrëveshjes në qoftëse ajo shkaktohet nga forca madhore, ndonjë fatkeqësi natyrore, luftë, gjendje të jashtëzakonshme në shkallë kombëtare ose lokale, ose nga çdo lloj fenomeni tjetër i cili deklarohet dhe njihet si forcë madhore nga Autoriteti Qeverisës, Kuvendi ose ndonjë organ gjyqësor.

2. Palët, gjithashtu, nuk do të mbajnë përgjegjësi për dëme të rrjedhura për shkaqe të cilat megjithëse nuk cilësohen si Forcë Madhore, mund të konsiderohen si të tilla, pasi nuk mund të shmangen edhe sikur palët të kenë dijeni paraprake për to. Pala e prekur nga një ngjarje e tillë do të njoftojë menjëherë palën tjetër për shkallën dhe kohëzgjatjen përafërsisht të kësaj pamundësie për të përmbushur detyrimet e saj.

3. Me pushimin e vonesave ose të humbjeve që kanë rezultuar nga kjo ngjarje, pala e prekur do të njoftojë palën tjetër për këtë ndërprerje. Nëqoftëse si rezultat i kësaj ngjarje, përmbushja nga ndonjëra palë e detyrimeve të saj për shkak të Marrëveshjes së Interkoneksionit, preket vetëm pjesërisht, atëherë kjo palë mbetet përgjegjëse për realizimin e detyrimeve të pa prekura.

NENI 26 NJOFTIMET

1. Çdo korrespondencë, njoftim, kërkesë, ofertë, propozim, udhëzim ose komunikime të tjera ose dokument për tu dhënë në lidhje me këtë marrëveshje nga një palë, duhet të jetë me shkrim, të dërgohet zyrtarisht në adresat e përcaktuara saktësisht nga palët dhe duhet që detyrimisht të përmbajë:

- Adresa e Subjektit _____
- Personi i autorizuar për marrjen e njoftimit
- Nr.Telefoni (Fix/Mobil)
- Fax (24/24 ore)
- E -mail

2. (A) Në rast të njoftimeve për TIK :

TiK
Adresa: PTK JSC HQ Dardania p.n,Prishtine
Telefon: _____ Fax: _____
e-mail: _____@

(B) Në rast të njoftimeve për Operatorin Përfitues

Operatori Përfitues: _____
Adresa: _____
Ne vëmendje të Z. _____
Telefon: _____ Fax: _____ Cel: _____
e-mail: _____@

3. Në rastin e dërgimit me shërbim postar do të quhet automatikisht i dërguar me marrjen e konfirmimit të shërbimit postar dhe kur dërgohet dorazi, me nënshkrimin e palës marrëse.

NENI 27

SHKELJA, PEZULLIMI DHE SHKËPUTJA E MARRËVESHJES SË INTERKONEKSIONIT

1. Kushtet e përcaktuara në këtë Ofertë Referencë nuk mund të kufizojnë kohëzgjatjen e shërbimeve të specifikuar aty. Ofrimi i shërbimeve i përshkruar në Ofertën Referencë mund të pezullohet ose të përfundojë në mënyrë të njëanshme vetëm në rastet e mëposhtme:

1.1. Operatori Përfitues anulon qasjen tek shërbimet e ofruara.

1.2. Operatori Ofrues përfundon kohën e veprimit të elementit të rrjetit të përdorur për ofrimin e qasjes tek Operatori Përfitues. Një përfundim i tillë nuk duhet të shkelë detyrimet e vendosura mbi operatorin ofrues sipas ligjit në fuqi. Operatori Ofrues duhet të informojë Operatorin Përfitues për një përfundim të tillë të paktën 36 muaj para kohe.

1.3. Operatori Përfitues shkel dispozitat themelore të marrëveshjes së qasjes. Operatori ofrues do të njoftojë menjëherë ARKEP-in për secilin prej këtyre rasteve.

1.4. Kur ka kritere të tjera të përcaktuara në ligj dhe aktet e lëshuara për zbatimin e tij.

2. Në rast se rrjeti i njëjës Palë ndikon negativisht në funksionimin normal të rrjetit të Palës tjetër, ose paraqet rrezik për sigurinë e ndonjë personi, Pala tjetër mund të pezullojë, në masën që gjykohet e nevojshme, detyrimet e saj të lindura nga marrëveshja e interkoneksionit e lidhur në bazë të kësaj Oferte Referencë, dhe për aq gjatë sa mendohet e arsyeshme për të siguruar funksionimin normal të sistemeve të saj ose për të ulur shkallën e rrezikut ndaj sigurisë. Në cdo rast pala që ndërmerr masën e pezullimit njofton edhe ARKEP.

3. Nëse një Palë ka kryer shkelje të Marrëveshjes së Interkoneksionit të lidhur në bazë të kësaj Oferte Referencë (përveç rasteve të parashikuara në pikat 11 deri 14, Pala që nuk ka kryer shkeljen mund ti dërgojë një njoftim me shkrim Palës tjetër që ka kryer shkeljen (Njoftimin për Shkelje) duke specifikuar shkeljen dhe duke kërkuar që ajo të korrigjohet brenda:

3.1. Pesëmbëdhjetë (15) ditë pune nga dita e marrjes së njoftimit për shkelje ose,

3.2. Në raste emergjente (përveç detyrimeve financiare), brenda një periudhe të tillë të shkurtër të cilën Pala që nuk ka kryer shkelje mund ta përcaktojë në mënyrë të arsyeshme.

4. Nëse Pala që ka kryer shkeljen nuk arrin ta korrigjojë këtë shkelje brenda periudhës së përcaktuar në paragrafin 3, Pala tjetër mund, që derisa shkelja të jetë korrigjuar, të pezullojë kryerjen e detyrimeve të saj të lindura nga Marrëveshja e Interkoneksionit në masën që konsiderohet e arsyeshme në rrethana të tilla.

5. Nëse Pala që ka kryer shkeljen nuk arrin ta korrigjojë këtë shkelje brenda periudhës së përcaktuar në njoftimin për shkeljen, Pala tjetër mund ta shkëpusë Marrëveshjen e Interkoneksionit me anë të një njoftimi me shkrim të dërguar 3 muaj para tek Pala që ka kryer shkeljen. Në qoftë se gjatë periudhës 3 mujore të njoftimit Pala që ka kryer shkeljen arrin ta korrigjojë plotësisht dëmin e shkaktuar nga kjo shkelje, Marrëveshja nuk do të shkëputet edhe pas dërgimit të një njoftimi të tillë.

6. Secila nga Palët mund ta shkëpusë Marrëveshjen e Interkoneksionit në çdo kohë duke i dhënë palës tjetër njoftim me shkrim, nëse pala tjetër ndodhet në kushtet e:

6.1. Përfundimit të afatit, anulimi dhe raste të tjera të përfundimit të parakohshëm të licencës ose autorizimit, kur një licensë ose autorizim i tillë kërkohet me ligj; ose,

6.2. Likuidimit të vullnetshëm ose të detyruar (përveçse për qëllime riorganizimi ose bashkimi të bizneseve);ose është deklaruar në falimentim; ose

6.3. Mbylljes së aktivitetit para afatit të përfundimit të marrëveshjes;ose

6.4. Njoftimit nga pala që shkëput marrëveshjen, për ndërprerjen e marrëveshjes në mënyrë të njëanshme për arsye të parashikuara në marrëveshje interkoneksionit sipas kësaj Oferte Referencë.

7. Me shkëputjen ose përfundimin e rregullt të Marrëveshjes së Interkoneksionit, secila nga Palët do të ketë të drejtë pas dërgimit tek Pala tjetër të një njoftimi paraprak brenda një afati të arsyeshëm, për të hyrë në ambientet e Palës tjetër me qëllim kryerjen e procedurave të nevojshme për çmontimin dhe rimarrjen në dorëzim të pajisjeve, impianteve ose aparaturave që i përkasin kësaj të fundit ose një Pale të tretë të instaluar nga ose për atë Palë me kusht që Pala që kërkon të hyjë në këto ambiente të japë një njoftim tjetër brenda një afati të arsyeshëm duke kërkuar që Pala tjetër të kryejë çmontimin dhe kthimin e këtyre pajisjeve impianteve dhe aparaturave dhe të hyjë në këto ambiente vetëm në rast se vete ajo Palë nuk e ka bërë këtë. Pala në ambientet e së cilës janë instaluar këto pajisje,impiante dhe aparatura do të kompensojë Palën tjetër për çdo pajisje,impiant dhe aparaturë që i përket Palës tjetër ose ndonjë pale të tretë, të cilat nuk dorëzohen në kushte të mira (një shkallë e lehtë amortizimi është e pranueshme). Asnjëra nga Palët nuk do të konsiderohet përgjegjëse për ndonjë dëmtim të pajisjeve, impianteve dhe aparaturave që i përkasin Palës tjetër ose një Pale të tretë, i cili është shkaktuar nga moskryerja e procedurave të nevojshme të mirëmbajtjes nga Pala tjetër ose Pala e tretë.

8. Pa cenuar të drejtat e Palëve,me zgjidhjen e Marrëveshjes së Interkoneksionit,secila nga Palët do të rimbursojë Palës tjetër shumat periodike të paguara(nëse ka të tilla) për periudhën e kohës që tejkalon afatin e vlefshmërisë së marrëveshjes së interkoneksionit.

9. Shkëputja apo përfundimi i vlefshmërisë së Marrëveshjes së Interkoneksionit nuk do të nënkuptojë shkarkimin e përgjegjësisë së njërës nga Palët e Marrëveshjes së Interkoneksionit për shkeljen e ndonjëre prej dispozitave të Marrëveshjes së Interkoneksionit dhe do të bëhet pa cenuar të drejtat dhe detyrimet e asnjërës prej Palëve, të cilat kanë lindur dhe janë akumuluar deri në datën e shkëputjes së kësaj Marrëveshje ose përfundimit të saj të rregullt.

10. Pavarësisht sa parashikohet në këtë nen 27 për ndërprerje apo shkëputje të interkoneksionit, secila palë ka të drejtë të paraqesë çështjen në ARKEP për shkëputje të marrëveshjes.

11. Në rast se ndonjë nga palët dështon të kryejë pagesat e shërbimeve, në përputhje me përcaktimet e dhëna në nenin 17, Aneks 3, 4,dhe 10 "Përshkrimi i Shërbimeve", "Tarifat e Shërbimeve", dhe "Faturimi, Pagesat dhe Garancia" për faturat e emetuara në përputhje me përcaktimet e kësaj Oferte Referencë, një shkelje e tillë do të konsiderohet Shkelje Pagesash, dhe pala që nuk është në shkelje ka të drejtë:

11.1 Të aktivizojë ekzekutimin e menjëhershëm të Garancise Financiare të vendosur në favor të saj nga pala tjetër sipas përcaktimeve në nenin 17 pikat 6, 7, 8, 9, 10, 11 "Faturimi, Pagesat dhe Garancia" dhe më pas të njoftojë me shkrim dhe/ose me email palën tjetër duke kërkuar, që brenda 10(dhjetë) ditëve kalendarike nga data e përfundimit të afatit 10(dhjetë) ditor të kamatëvonesës:

a. të plotësojë vlerën e Garancisë Financiare pas përdorimit nga pala jo në shkelje, në vlerën e mëparshme ose në një vlerë të rivlerësuar nga pala jo-në shkelje;

b. të paguajë diferencën midis vlerës së detyrimit financiar përkatës dhe Garancisë Financiare, në rast se Garancia Financiare nuk mbulon vlerën e këtij detyrimi.

11.2 Të pezullojë menjëherë me përfundimin e afatit 10 (dhjetë) ditor të kamatëvonesës, ofrimin e shërbimeve të interkoneksionit, duke njoftuar palën në shkelje për masën e marrë, dhe me kalimin e 10 (dhjetë) ditëve nga përfundimi i afatit 10 (dhjetë) ditor të kamatëvonesës, të shkëpusë marrëveshjen e interkoneksionit.

12. Në rast se pala në shkelje korrigjon shkeljen brenda afatit kohor të përcaktuar sipas 11.1, pala jo në shkelje nuk do të ndërpresë interkoneksionin apo shkëpus marrëveshjen e interkoneksionit, në rast se nuk ndodhemi në kushtet e pikës 14.

13. Dështimi apo refuzimi nga pala në shkelje për të korrigjuar shkeljen e pagesave brenda afatit kohor të përcaktuar sipas pikës 11.2, i jep të drejten palës jo-në shkelje të pezullojë ofrimin e shërbimeve të interkoneksionit dhe me kalimin e 10 (dhjetë) ditëve kalendarike nga përfundimi i afatit 10(dhjetë) ditor të kamatëvonesës, të shkëpus marrëveshjen e interkoneksionit duke bërë njoftimin me shkrim dhe/ose me email 5 (pesë) ditë përpara datës së bërjes efektive të ndërprejes përfundimtare të interkoneksionit (shkëputjes së marrëveshjes).

14. Në rast se, një palë që është njoftuar për tre shkelje të pagesave të mëparshme, ndodhet në kushtet e një shkelje pagesash për herë të katërt brenda një periudhe 24 (njëzet e katër) mujore, marrëveshja e interkoneksionit mund të shkeputet nga pala jo në shkelje nëpërmjet një njoftimi me shkrim dërguar palës në shkelje. Shkëputja e interkoneksionit do të realizohet 30 (tridhjetë) ditë pas datës së dërgimit të njoftimit. Shkëputja mund të kryhet pavarësisht nëse shkelja e pagesave është korrigjuar gjatë kësaj periudhe kohore. Detyrimet për pagesa ngelen edhe pas shkëputjes së interkoneksionit.

15. TiK/Operatori Përfitues ka detyrimin të njoftojë ARKEP menjëherë në secilin prej këtyre rasteve të përmendura në kete nen si dhe për rastet e ndërprejeve për shkak të forcave madhore dhe emergjencës.

NENI 28 LIGJI I ZBATUESHËM, ZGJIDHJA E MOSMARRËVESHJEVE

1. Marrëveshja e Interkoneksionit sipas kësaj Oferte Referencë dhe të gjitha çështjet që kanë të bëjnë me të do të rregullohen, interpretohen në përputhje me Ligjet e Republikës së Kosovës.

2. Cdo mosmarrëveshje për marrëveshjen e lidhur mes palëve, pretendim ose kundërshtim, ose cdo shkelje, pretendim ose pavlefshmëria e saj do të synohet të zgjidhet me mirëkuptim midis palëve.

3. Në rast të një mosmarrëveshje që lind mes Operatorit Përfitues dhe TiK në lidhje me ose për shkak të Marrëveshjes së Interkoneksionit, përfshirë këtu lidhjen, implementimin, zbatimin, interpretimin, amendimin, përfundimin dhe shkëputjen e Marrëveshjes së Interkoneksionit, përfaqesuesit e autorizuar të TiK dhe Operatorit Përfitues duhet të takohen brenda një periudhe prej 10(dhjetë) ditësh pune nga marrja e njoftimit me shkrim për Mosmarrëveshjen, i cili dërgohet nga njëra prej Palëve në marrëveshje tek tjetri (ose brenda një periudhe për të cilën palët kanë rënë dakord mes tyre në marrëveshje) dhe do të realizojnë një përpjekje vullnetmirë për të negociuar dhe arritur zgjidhjen e Mosmarrëveshjes me mirëkuptim mes tyre.

4. Pavarësisht procedurave për zgjidhje mosmarrëveshje të parashikuara në këtë Ofertë Referencë apo të rëna dakord në marrëveshjen e interkoneksionit të lidhur midis palëve, secila nga palët ka të drejtë që në cdo kohë ta adresojë çështjen në ARKEP për zgjidhje.

5. Megjithatë në çdo rast të ndonjë mosmarrëveshjeje të mundshme palët kanë të drejtë t`i drejtohen Gjykatës Themelore në Prishtinë.

6. Fakti që një mosmarrëveshje dërgohet në ARKEP apo në Gjykatë, nuk i liron palët nga detyrimet e tyre për të përmbushur anagazhimet e tyre sipas marrëveshjes së interkoneksionit të nënshkruar mes palëve.

7. Asnjë palë nuk do të ndermarre masa për kufizim të kapaciteteve të interkoneksionit (reduktim të numrit të E1 apo kapaciteteve të tyre) nëse nuk është rënë dakord paraprakisht me palen tjetër, dhe në rast të mosmarrëveshjeve për këto çështje, palët i drejtohen ARKEP, dhe pala që do të reduktojë kapacitetet nuk mund të ndermarre këto veprim, për sa kohë ARKEP nuk ka marrë vendim për zgjidhjen e mosmarrëveshjes.

NENI 29 DISPOZITA PËRFUNDIMTARE

1. Pavlefshmëria ose pamundësia për tu zbatuar ndonjë pjesë e marrëveshjes së interkoneksionit nuk do të çënojë dhe as nuk do të ndikojë në vlefshmërinë ose zbatimin e pjesës tjetër të marrëveshjes, përveçse kur ky fakt rrjedh si pasojë e ndonjë vendimi në formë të prerë nga Gjykata kompetente ose si vendim i arsyetuar ligjërisht i ARKEP.

2. Asnjë ndryshim, heqje apo shtim dispozitash të marrëveshjes së interkoneksionit lidhur në bazë të kësaj Oferte Referencë dhe anekseve të saj, nuk do të jetë i vlefshëm nëse nuk nënshkruhet rregullisht një amendament nga palët i cili do të jetë pjesë integrale e marrëveshjes përjashtuar rasteve të parashikuara për përditësim automatik kundrejt njoftimit përkatës të palëve sipas vetë marrëveshjes së interkoneksionit.

3. Marrëveshja e Interkoneksionit dhe anekset e saj hartohen në gjuhën shqipe, në tre kopje, nga një për secilën palë dhe një për tu depozituar pranë ARKEP.

4. Çdo përkthim i marrëveshjes, i bërë nga palët për nevojë negociimi ose zbatimi, duhet të bëhet nga personat e autorizuar dhe të licencuar për këtë lëmi, por pa marrë fuqinë dhe cilësinë e një ekzemplari origjinal.

NENI 30 AFATI, HYRJA NE FUQI DHE VLEFSHMERIA

1. Marrëveshja e Interkoneksionit bazuar në këtë Ofertë Referencë hyn në fuqi në datën _____, datë për të cilën është dakord mes palëve dhe është e vlefshme deri:

1. Në kohën që Operatorit i mbaron afati i autorizimit, i revokohet autorizimi dhe Operatori nuk ka marrë autorizim tjetër zëvendësues për ofrimin e rrjetit dhe ose shërbimeve të komunikimeve elektronike për ofrimin e rrjetit ose shërbimeve të komunikimeve elektronike;
2. Në kohën që TiK i mbaron afati i autorizimit, i revokohet autorizimi dhe TiK nuk ka marrë autorizim tjetër zëvendësues për ofrimin e rrjetit dhe ose shërbimeve të komunikimeve elektronike për ofrimin e rrjetit ose shërbimeve të komunikimeve elektronike;
3. Shkëputjen e marrëveshjes sipas përcaktimeve të kësaj marrëveshjeje në nenin 27.

NENI 31
NDRYSHIMET

1. Ndryshimet ose shtesat e kesaj Oferte Referencë, duke përfshire Anekset e saj, Amendamentet, Shtojcat dhe Listat e Shërbimeve bëhen sipas përcaktimeve ligjore dhe nënligjore dhe janë objekt i miratimit nga ARKEP.

2. Çdo amendim i RIO se TiK që kryhet në përputhje me udhëzimet/vendimet e ARKEP që ka lidhje me:

- përcaktimin/rregullimin e tarifave të përfshira në RIO-n e TiK;
- çdo vendim apo udhëzim i ARKEP në lidhje me RIO e TiK do të konsiderohet si pjesë përfshirë automatikisht në marrëveshjen e interkoneksionit midis palëve, dhe me efekte nga data e përcaktuar nga ARKEP për hyrjen në fuqi të tyre.

PTK sh.a

Mehdi Latifaj
U.D Kryeshef Ekzekutiv

_____ **sh.a/sh.p.k**

_____ **Personi Autorizuar**

ANEKS 1 PËRKUFIZIME

Qasje	është bërja e disponueshme e lehtësive dhe/ose shërbimeve një ndërmarrësi tjetër, sipas kushteve të përcaktuara, në baza ekskluzive ose joekskluzive, për sigurimin e shërbimeve të komunikimeve elektronike. Qasja, ndërmjet të tjerash, përfshin qasje në elementet e rrjetit dhe faciliteteve shoqëruese, të cilat mund të përfshijnë lidhjen e pajisjeve në mënyrë fikse ose jofikse (në veçanti kjo përfshin qasje të hapur në rrjetin lokal dhe qasje në fasilitetet dhe shërbimet e nevojshme, për të ofruar dhe mundësuar shërbimet e bazuara në rrjetin lokal); qasje në infrastrukturën fizike, përfshirë ndërtesat, tubacionet dhe kullat; qasjen në rrjetet fikse apo qasjen në shërbimet e rrjeteve virtuale.
ARKEP	Autoriteti Rregullativ për Komunikime Elektronike dhe Postare
Autorizim i Përgjithshëm	është një akt i natyrës së përgjithshme, që përbëhet nga kuadri ligjor, i përcaktuar nga ky ligj dhe rregullat e nxjerra nga ARKEP, në zbatim të tij, për të siguruar të drejtat për ofrimin e rrjeteve ose të shërbimeve të komunikimeve elektronike, duke vendosur edhe detyrimet specifike, të cilat mund të zbatohen ndaj të gjitha ose ndaj disa prej rrjeteve dhe/ose shërbimeve të komunikimeve elektronike
Bashkëvendosje	është shërbimi i cili mundëson vendosjen e përshtatshme të pajisjeve të operatorit përfitues dhe lidhjen e tyre tek pajisjet korresponduese të operatorit ofrues.
Bashkëvendosje fizike	është bashkëvendosja e pajisjeve të operatorit përfitues në të njëjtat mjedise ku operatori, i cili ofron qasjen, ka të vendosur elementin e rrjetit të tij, në të cilin ofrohet qasja.
Bashkëvendosje në distancë	është bashkëvendosja e pajisjeve të operatorit përfitues në mjedise të operatorit ofrues të qasjes, të ndryshme nga ato në të cilat ky operator ka të vendosur elementin e rrjetit të tij, në të cilin ofrohet qasja.
Bashkëvendosje Virtuale	është vendosja e pajisjeve korresponduese të operatorit përfitues, përmes instalimit të tyre në të njëjtin permutator, (distribution frame) pranë një elementi të rrjetit në të cilin ofrohet qasja dhe që operohet nga

	ofruesi i qasjes.
Central Interkoneksionit	është centrali që mund të dërgojë dhe të marrë thirrje direkt nga Pika e Interkoneksionit, pa qenë nevoja që thirrjet të kalojnë nëpërmjet një Centrali Tjeter.
Centrali Gateway i Qasjes ne zonën e interkoneksionit	Centrali digjital i TiK i cili lidhet me pikën e interkoneksionit në të cilin thirrjet fillojnë të komutohen në rrjetin TiK kur përcillen nga operatori përfitues përmes pikës së interkoneksionit ose përfundojnë se komutuari në rrjetin TiK kur ato përcillen drejt operatorit përfitues përmes pikës së interkoneksionit.
Ditë pune	E hënë deri të premten përveç pushimeve zyrtare të Kosovës.
ETSI	Instituti European i Standardeve të Telekomunikacionit
Facilitet	si pjesë e infrastruktures shoqëruese të komunikimeve elektronike, përfshin ndërtesen, pjesë të një ndërtese, apo mjediset e pavarura brenda një ndërtese ku janë instaluar pajisje të komunikimeve elektronike, si edhe elemente ndërtimore, të tilla si tubacione kabllore, shtylla, antena etj.
Facilitete shoqëruese	janë facilitetet e lidhura me një rrjet të komunikimeve elektronike dhe/ose një shërbim të komunikimeve elektronike, të cilat mundësojnë ose mbështesin ofrimin e shërbimeve nëpërmjet këtij rrjeti ose shërbimi
Integritet i rrjetit	është funksionimi dhe aftësia për të hyrë në veprim e rrjeteve të komunikimeve elektronike të interkonektuara mes tyre dhe mbrojtja e këtyre rrjeteve ndaj defekteve të shkaktuara nga shqetësimet elektromagnetike dhe/ose ngarkesat e punës
Identifikimi i linjës thirrëse (CLI)	Është funksioni që, në bazë të numrit ose kodit të caktuar për pikën fundore të rrjetit, i mundëson konsumatorit marrës të thirrjes të identifikojë pikën fundore të rrjetit, ku ka pikënisjen thirrja.
Identifikimi i linjës së thirrur	është funksioni, që lejon dërguesin e thirrjes të identifikojë pikën fundore të rrjetit, ku përfundon thirrja, bazuar në numrin ose kodin që i është caktuar kësaj pike fundore të rrjetit.
Interferencë	Është ndikimi i një energjie të padëshiruar, të shkaktuar nga një ose më shumë kombinime të emetimeve, rrezatimeve ose induktimeve kundrejt marrësit në një sistem/stacion radiokomunikimi, i cili

	shoqërohet me përkeqësim të cilësisë, keqinterpretim ose humbje të informacionit, që duhet të përftohej në mungëse të energjisë së padëshiruar.
Interkoneksioni	Është lidhja fizike dhe logjike e rrjeteve publike të komunikimit, të cilat përdoren nga i njëjti operator apo operatorë të ndryshëm, në mënyrë që ti lejojë përdoruesit e një operatori të komunikojnë me përdoruesit e të njëjtit operator ose të një operatori tjetër, ose të lejojë qasjen për shërbimet e ofruara nga një operator tjetër. Interkoneksioni është një lloj i veçantë i qasjes, që zbatohet ndërmjet operatorëve të rrjeteve publike të komunikimit.
Interkoneksioni (in-span)	Është forma e interkoneksionit sipas të cilës, pika e interkoneksionit është e vendosur brenda një tubacioni kabllor apo në dhomën e kabllave që ndodhet ndërmjet ambienteve (premisave) të operatorit ofrues dhe operatorit përfitues, në të cilën vendosen elementet e rrjetit që formojnë lidhjen (link) e interkoneksionit.
Interkoneksioni në anën e operatorit përfitues	Është forma e interkoneksionit, sipas të cilës pika e interkoneksionit është e vendosur brenda ambienteve të operatorit përfitues, ku vendosen elementet e rrjetit që formojnë lidhjen (link) e interkoneksionit.
Interkoneksioni i bashkëvendosur (në anën e operatorit ofrues)	Është forma e interkoneksionit, sipas së cilës pika e interkoneksionit është e vendosur brenda ambienteve të ofruesit të qasjes, ku vendosen elementet e rrjetit që formojnë lidhjen e interkoneksionit.
ITU	Bashkimi Ndërkombëtar i Telekomunikacioneve (International Telecommunications Union).
Kapacitet lidhje	Kapaciteti i shprehur në nxE1 në Pikën e Interkoneksionit.
Kod numeracioni	është një numër apo një kombinim numrash pa prefiksin kombëtar "0", i cili karakterizon zonën e numeracionit të thirrur. Nëse plani kombëtar i numeracionit është "i hapur" dhe kur konsumatori thirrës dhe ai i thirrur u përkasin zonave të ndryshme të numeracionit, ky kod formohet përpara numrit të konsumatorit të thirrur.

Koha e Komunikimit	Është intervali kohor që fillon prej momentit kur kushti i përgjigjes të të thirrurit (sinjali i përgjigjes të të thirrurit, i dërguar nga i thirruri për tek thirrësi) është prezent (dedektohet) në pikën ku ndodh dërgimi i thirrjes dhe bëhet regjistrimi i kohëzgjatjes së komunikimit deri në momentin kur kushti i lëshimit (sinjali i lëshimit) është present (dedektohet) në pikën ku ndodh dërgimi i thirrjes.
Komunikim	Është shkëmbimi ose transmetimi i informacionit ndërmjet një numri të kufizuar përdoruesish, por që nuk përfshin transmetimin e informacionit që është pjesë e transmetimeve radio-televizive nëpërmjet rrjeteve të komunikimeve elektronike, përveç rasteve kur informacioni mund të ketë të bëjë me një pajtimtar ose përdorues të mirënjohur, i cili merr këtë informacion.
Linku i Interkoneksionit	është kapaciteti (rruga-path) e transmetimit midis pajisjeve të transmetimit (të dy operatorëve) me të aferta me Pikën e interkoneksionit, e cila përbëhet nga një numër specifik i linjave të huazuara 2 Mbps (E1).
Linja me qira apo linja e huazuara	është një shërbim, që përfshin ofrimin e kapaciteteve transmetuese, ndërmjet pikave të ndryshme të të njëjtit rrjet ose të rrjeteve të ndryshme, pa përfshirë funksionet komutuese, të kontrolluara prej përdoruesit të vet.
Marrëveshje	është akti që lidhet mes Operatorit Ofrues të Interkoneksionit dhe Operatorit Përfitues për sigurimin e interkoneksionit e të fasiliteve shoqëruese, të cilat Operatori Ofrues është i detyruar ti sigurojë sipas detyrimeve të vendosur
Ndërfaqe	është tërësia e karakteristikave që përshkruajnë pikën e lidhjes ndërmjet dy njësive të komunikimeve elektronike, si p.sh. ndërmjet dy rrjeteve të komunikimeve, ose ndërmjet një rrjeti të komunikimeve dhe pajisjes së përdoruesit. Ndërfaqja mund të jetë pajisje (hardware) ose program (software).
Numër	është një seri alfa-numerike e përcaktuar në planin e numeracionit, që shërben për adresim në rrjetet dhe shërbimet e komunikimeve elektronike.

Numrat e shërbimeve të emergjencës	janë numrat e percaktuar në planin e numeracionit për shërbimet dhe rrjetet e komunikimeve elektronike për policinë, zjarrfikësit, numrat e emergjencës për shërbimet shëndetësore, shërbimet lajmëruese dhe ato të deklaruara, që përfshihen në numrin e harmonizuar europian "112".
Numër gjeografik	është një numër kombëtar, i cili i përket një rajoni gjeografik të caktuar.
Numrat jogjeografik	janë numrat kombëtarë, që nuk i përkasin një rajoni gjeografik të caktuar dhe përfshijnë: a) numrat për qasje në shërbimet me vlerë të shtuar; b) numrat për qasje në shërbimet, për të cilat e gjithë tarifa për trafikun drejt këtyre shërbimeve paguhet nga ofruesi i shërbimeve, pra drejt numrave që janë pa pagesë për përdoruesit (numra pa pagesë,); c) numrat për qasje në shërbimet, për të cilat tarifa për trafikun drejt këtyre shërbimeve paguhet pjesërisht nga thirrësi dhe pjesërisht nga ofruesi i shërbimit, pra drejt numrave, të cilët i janë dhënë përdoruesit përkundëjt një marrëdhënie të paracaktuar(numra me ndarje të kostos);
Operator	është një ndërmarrës, që është i licencuar/autorizuar për ofrimin e Rrjetave dhe Shërbimeve Telekomunikuese Publike.

Ofrimi i një rrjeti të komunikimeve elektronike	Është ndërtimi, përdorimi, mbikëqyrja ose bërja e disponueshme e një rrjeti të tillë
Ofertë Referencë e Interkoneksionit (RIO)	është një ofertë e publikuar nga një ndërmarrës për shërbimet dhe/ose facilitetet e qasjes sipas detyrimeve të ligjit.
Operator Përfitues	është operatori i një rrjeti publik të komunikimeve elektronike dhe/ose shërbimeve të komunikimeve elektronike, i cili ka aplikuar me shkrim për qasje.
Orari zyrtar	08.00 – 16.00 e Hënë – e Premte
Konsumator	është cilido që ka lidhur një kontratë me një ndërmarrje që ofron shërbime të komunikimeve elektronike, të disponueshme për publikun, për përfitimin e shërbimeve të ofruara.

Përdorues	është cilido që përdor ose kërkon të përdorë shërbime të komunikimeve elektronike, të disponueshme për publikun.
Përdorues fundor	është një përdorues, i cili nuk ofron rrjete komunikimesh publike ose shërbime komunikimesh elektronike, të disponueshme për publikun
Pika fundore e rrjetit	është pika fizike, në të cilën një konsumator ka qasje në rrjetin e komunikimeve publike. Në rastin e rrjeteve, që përfshijne komutimin ose rrugëzimin pika fundore e rrjetit identifikohet si një adresë specifike e rrjetit, e cila mund të lidhet me numrin ose emrin e një konsumatori. Është një pikë e përcaktuar gjeografikisht ku fizikisht bëhet interkoneksioni. In-span në pikën lidhëse të kablove TiK me Operatorin Përfitues Costumer-site në ambientet e Operatorit Përfitues. Co-location në ambientet e TiK Shërbimet e lidhjes dhe kapaciteti i lidhjes (link), sigurohen në pikën e interkoneksionit.
Pika e Interkoneksionit	është një pikë e përcaktuar gjeografikisht në rrjetin publik të komunikimeve elektronike të operatorit ofrues, ku operator i ofrues dhe operator i përfitues janë të interkonektuar.
Plani i numeracionit	është struktura e numrave dhe e serive të numrave, si dhe caktimi i tyre për sigurimin e aksesit në rrjetet dhe shërbimet e komunikimeve publike.
Postë elektronike	është çdo mesazh në formën e tekstit, tingullit apo imazhit, të dërguar nëpërmjet rrjetit publik të komunikimeve, i cili mund të ruhet në rrjet ose në pajisjen fundore të marrësit derisa marrësi ta marr atë.
Qark interkoneksioni E1	është një kapacitet E1 transmetimi që kalon nga pika e interkoneksionit midis dy centraleve të interkonektuar përfshirë portat E1 të centraleve (switch). Kapaciteti minimal për qarqet dhe linket e interkoneksionit për çdo pikë interkoneksioni është 2 Mbps apo 1E1. Kapaciteti minimal për shtimin e kapaciteteve në secilën pikë interkoneksioni është 2 Mbps.
Qark Zgjatues interkoneksioni	është një qark Interkoneksioni E1 që lidh një pikë interkoneksioni me një central tjetër interkoneksioni që nuk është i lidhur direkt me këtë pikë interkoneksioni.
Rrjet i komunikimeve elektronike	janë sistemet e transmetimit dhe, nëse ekzistojnë, sistemet e komutimit ose rrugëzimit dhe burime të tjera, të cilat lejojnë përcjelljen e sinjaleve nëpërmjet përcjellësve, radios, mjeteve optike ose

	mjeteve të tjera elektromagnetike, duke përfshirë rrjetet satelitore, rrjetet fikse (me komutim të qarqeve ose me komutim të paketave, përfshire internetin) , sistemet e kabllave elektrike në raste kur ato përdoren, për transmetimin e sinjaleve, , pavarësisht nga tipi i informacionit të përcjellë.
Rrjet i komunikimeve publike	është një rrjet i komunikimeve elektronike, që përdoret, tërësisht ose pjesërisht, për ofrimin e shërbimeve të komunikimeve elektronike, të disponueshme për publikun.
Rrjet telefonik publik	është një rrjet i komunikimeve elektronike, i cili përdoret për të ofruar shërbime telefonike të disponueshme për publikun. Ai mundëson përcjelljen ndërmjet pikave fundore të rrjetit të komunikimit zanor, si edhe të formave të tjera të komunikimit, të tilla si faksimile dhe të dhëna etj.
Rrjeti Telefonise Fikse	është rrjeti, në të cilin pikat fundore janë të vendosura në vende të fiksuara
Ndërmarrës	është çdo person fizik, juridik i regjistruar sipas legjislacionit në fuqi, i cili ofron rrjete të komunikimeve elektronike ose shërbime të komunikimeve elektronike.
Shërbim publik telefonik ne lokacionin fiks	është shërbimi publik telefonik, i ofruar për përdoruesit, pajisjet fundore të të cilëve lidhen në pikat fundore me vendndodhje të qëndrueshme të rrjetit publik të telekomunikacioneve.
Shërbim me vlerë të shtuar	Është shërbimi që ofron informacion, përkundërt pagesës, nëpërmjet rrjetit publik të komunikimit.
Thirrje	është lidhja ndërmjet dy pikave fundore, e realizuar nëpërmjet shërbimit telefonik të disponueshëm për publikun, e cila lejon komunikimin dydrejtë.
Thirrje e suksesshme	Është një thirrje me anë të së cilës pala thirrëse ka marrë një sinjal përgjigjeje
Zonë numeracioni gjeografike	është një rajon gjeografik i përcaktuar, i cili ka një kod të caktuar numeracioni.
Shërbimi i përkthimit të numrit (NTS)	Është shërbimi i rrugëzimit të thirrjeve telefonike drejt një numri jo-gjeografik, sipas përcaktimeve të Planit Kombëtar të Numeracionit, drejt një numri gjeografik të "fshehur".
Kodi i Zonës	Kodi i Zonës identifikon një zonë gjeografike/jo-gjeografike të quajtur Zonë Numeracioni
Palë	TiK ose Operatori Përfitues
SCCP	Pjesa e Sinjalizimit për Kontrollin e Lidhjes

SS	Sistem Sinjalizimi
STP	Pikë për Transferimin e Sinjalizimit
CDR	Të dhëna të detajuara për cdo thirrje (Call Details Record)
Shërbimet e Interkoneksionit	Shërbimet e trafikut dhe shërbime tjera
Shërbimet e trafikut	Shërbimet e terminimit, tranzitimit dhe origjinimit të thirrjeve
Shërbimet tjera	Shërbimet e nevojshme për lidhjen, operimin dhe mirëmbajtjen e interkoneksionit dhe bashkvëndosjes
Shërbimi Terminimit në TiK	Shërbimi nëpërmjet të cilit TiK, në emer të Operatorit përfitues përcjell Thirrjet nga Pika e Interkoneksionit për në një Pikë fundore të Rrjetit të tij në Republikën e Kosovës, të identifikuar nëpërmjet numrave gjeografike të TiK sipas planit të numeracionit.
Shërbimi Tranzitimit të TiK	Është përcjellja e thirrjeve telefonike nga TiK midis pikës së interkoneksionit me operatorin Përfitues deri në pikën e Interkoneksionit të një Operatori Tjetër Përfitues të cilët nuk janë të interkonektuar direkt midis tyre.
Zonë Kombëtare interkoneksioni	Një zonë gjeografike që mbulon të gjitha zonat e numeracionit të TiK.

ANEKS 2 INTERKONEKSIONI ME RRJETIN TiK

1. Të Përgjithshme

Rrjeti i TiK për qëllime të interkoneksionit është ndarë në 1 zonë kombëtare. Kjo zonë interkoneksioni së bashku me kodet përkatëse të numeracionit janë të paraqitura në Aneks 17 "Zonat e Interkoneksionit dhe Numeracioni i TiK".

TiK ofron Pikë Interkoneksioni në zonën kombëtare. Pikë interkoneksioni do të konsiderohet vendi ku rrjeti i TiK lidhet me rrjetin e Operatorit Përfitues dhe do të jetë pika fizike ku lidhja mund të shkëputet me qëllim kryerjen e testeve. Pika e interkoneksionit lidhet me centralet e interkoneksionit të TiK dhe Operatorit Përfitues. Vendodhja e pikës së interkoneksionit varet nga forma e interkoneksionit. Për interkoneksionin e bashkëvendosur në TiK pikat e interkoneksionit ndodhen në centralet respektive të TiK.

Pika e interkoneksionit është një shërbim ku Operatori Përfitues lidhet në interkoneksion me TiK. Operatori Përfitues lidh centralin gateway të tij me centralin përkatës të TiK në interkoneksion nëpërmjet linjave të interkoneksionit prej 2 Mbps. Në këtë mënyrë implementohet një lidhje fizike dhe logjike nëpërmjet dy rrjeteve duke caktuar në këtë mënyrë dhe trafikun e interkoneksionit.

2. Pikat e interkoneksionit ndahen në 2 kategori:

2.1. Pikë interkoneksioni ndërkombëtare që ndodhet (apo lidhet me) në centralet transit ndërkombëtare në Prishtinë dhe shërbejnë për interkoneksion me rrjetin TiK të Operatoreve Përfitues të autorizuar për tranzit ndërkombëtar për terminimin e thirrjeve drejt gjithë përdoruesve të rrjetit TiK.

2.2. Pikë interkoneksioni kombëtare që ndodhet (apo lidhet me) në centralet tranzit kombëtare në Prishtinë dhe shërbejnë për interkoneksion me rrjetin TiK për terminimin e thirrjeve të origjinuara nga konsumatorët e operatorëve të rrjeteve publike të telefonisë të autorizuar në Republikën e Kosovës, drejt të gjithë përdoruesve të rrjetit TiK.

Operatori Përfitues, ka të drejtë të kërkojë të interkonektohet me TiK në secilin prej 2 llojeve të pikave të interkoneksionit të cituara më sipër, sipas regjimit të autorizimit, zonës së tij të mbulimit me rrjet lokale dhe mundësive teknike të TiK. Shërbimet që përfitohen në secilën pikë interkoneksioni i korrespondojnë kategorisë së pikës së interkoneksionit dhe janë specifikuar më sipër në këtë seksion.

3. Vendodhja e Centraleve të Interkoneksionit

Vendndodhja e centraleve të interkoneksionit të cituara në paragrafin e mësipërm, paraqitet në Aneks 15 "Pikat e Interkoneksionit" ndërsa adresat përkatëse përfshihen në bllokskemat e interkoneksionit, Aneks i çdo Marrëveshje Interkoneksioni.

4. Implementimi i qarqeve (linq-eve) të interkoneksionit

Lidhja fizike midis rrjeteve bazohet në lidhjen e pikave përkatëse të interkoneksionit të dy rrjeteve nëpërmjet linqeve dhe qarqeve të interkoneksionit.

4.1. Link interkoneksioni (interconnection link) është kapaciteti (rruga-path) i transmetimit midis pajisjeve të transmetimit (të dy operatorëve) më të afërta me Pikën e interkoneksionit, e cila përbëhet nga një numër specifik qarqesh 2 Mbps (E1).

4.2. Një qark interkoneksioni E1, është një kapacitet E1 transmetimi që kalon nga Pika e interkoneksionit midis dy centraleve të interkonektuar, përfshirë portat E1 të centraleve (switch).

5. Kapaciteti minimal për qarqet dhe linket e interkoneksionit për çdo pikë interkoneksioni është 2 Mbps apo 1XE1. Kapaciteti minimal për shtimin e kapaciteteve në secilën pikë interkoneksioni është 2Mbps.

6. Format e lidhjes së interkoneksionit

TiK ofron një nga format e lidhjes së interkoneksionit të referuara më poshtë.

6.1. Interkoneksion i bashkëvendosur në ambientet e TiK

Për interkoneksionin e bashkëvendosur në TiK, Operatori Përfitues është përgjegjës për sigurimin dhe mirëmbajtjen e linjës së interkoneksionit deri në pikën e interkoneksionit të TiK. Operatori Përfitues do të vendosë pajisjet e transmetimit në ambientet e TiK sipas kushteve të specifikuara në këtë Ofertë Referencë të interkoneksionit dhe të rëna dakord në marrëveshjen e interkoneksionit. TiK do të sigurojë lidhjen e pikës së interkoneksionit me centralin e interkoneksionit me kapacitetet dhe portat e nevojshme E1.

Kostot e interkoneksionit të bashkëvendosur përfshijnë kostot e studimit dhe planifikimit të interkoneksionit, të përgatitjes dhe mirëmbajtjes së ambientit përkatës të bashkëvendosjes, të qerasë për ambientet e bashkëvendosjes, përdorimit të infrastrukturës së Operatorit Ofrues(duke përfshirë kostot fikse për lidhjen primare dhe kostot variabël të llogaritur për një E1) si dhe kostot e sigurimit të kapacitetit prej 2MBit/s.

6.2. Interkoneksioni i bashkëvendosur në ambientet e Operatorit Përfitues dhe interkoneksionin i ndërmjetëm

Në rastin e interkoneksionit të bashkëvendosur në ambientet e Operatorit Përfitues realizohet me Linja të huazuara interkoneksioni ku Operatori Ofrues ofron transmetimin kundrejt pagesave përkatëse në vendndodhjen e kërkuar nga Operatori Përfitues dhe i përfundon këto lidhje në paisjet e veta të transmetimit. Operatori Përfitues është i detyruar të sigurojë kushtet e nevojshme për vendosjen e këtyre pajisjeve pa kërkuar pagesa për sigurimin e tyre.

Kostot e TiK për ofrimin e linjave të huazuara të interkoneksionit (në anën e klientit-customer site) përfshijnë kostot për sigurimin e kapacitetit prej 2MBit/s, pajisjeve të transmetimit përkatëse dhe mjeteve të transmetimit.

Interkoneksioni i ndërmjetëm realizohet me Link Interkoneksioni (in-span), ku lidhjet kabllore të përshtatura bashkohen në një pikë midis vendndodhjes së Operatorit Përfitues dhe Operatorit Ofrues.

Kostot e TiK për ofrimin e linjave të interkoneksionit (in-span) përfshijnë kostot e përdorimit të infrastrukturës së TiK (duke përfshirë kostot fikse të, ODF, fibrave optike dhe kabllave lidhës si dhe kostot variabël për DDF dhe kabllave prej bakri të llogaritura për E1) sigurimin e një kapaciteti prej 2MBit/s si dhe kostot e multipleksimit si rezultat i sigurimit të linkut të dedikuar STM-1 multiplekser dhe kartave kontribuese.

Në rastet kur pika e interkoneksionit e TiK-ut nuk ndodhet në vendin e përshtatshëm për të realizuar interkoneksionin, mbetet përgjegjësi e Operatorit Përfitues që të bëjë investimet shtesë për të arritur nga pajisjet e tij deri te pika e interkoneksionit e TiK-ut

Për interkoneksionin e bashkëvendosur, interkoneksionin në anën e operatorit përfitues dhe interkoneksionin e ndërmjetëm, TiK ofron shërbimet e linjave të huazuara të interkoneksionit duke aplikuar tarifat në fuqi për këto shërbime.

Lista e ambienteve me prezencë fizike të TiK ku ofrohet mundësia për lidhjen fizike për realizimin e interkoneksionit deri në centralin më të afërt ku ofrohen shërbimet e

interkoneksionit sipas përshkrimit më sipër, paraqitet në Aneks 16 "Mundësitë për bashkëvendosje".

7. Interkoneksioni me Operatorin Përfitues _____

7.1. Operatori Përfitues mund të kërkojë të lidhet në pikën/pikat e mëposhtme të interkoneksionit:

- 7.1.1. Pikë Ndërkombëtare Interkoneksioni "DDF e TiK, CT Transit EWSD Prishtinë;
- 7.1.2. Pikë Kombëtare Interkoneksioni "DDF e TiK, CT Transit EWSD Prishtinë;

7.2. Forma e interkoneksionit me Operatorin Përfitues:

- 7.2.1. Për pikën ndërkombëtare të interkoneksionit CT EWSD Prishtinë, Interkoneksioni është (i bashkëvendosur ose i ndërmjetëm ose në ambientet e Operatorit Përfitues).
- 7.2.2. Pë pikën kombëtare të interkoneksionit CT EWSD Prishtinë, interkoneksioni është (i bashkëvendosur ose i ndërmjetëm ose në ambientet e Operatorit Përfitues).

Tarifat për bashkëvendosjen për interkoneksion në rastet e interkoneksionit të bashkëvendosur jepen në Aneks 4 "Tarifat e Shërbimeve".

Për qarqet E1 dhe për lidhje me fibër optik apo mjete të tjera transmetimi, si dhe në rastin e interkoneksionit të ndërmjetëm dhe në ambientet e Operatorit Përfitues, TiK do të aplikojë tarifat në fuqi për këto shërbime.

ANEKS 3 PËRSHKRIMI I SHËRBIMEVE

Shërbimet e interkoneksionit të ofruara në Marrëveshjen e Interkoneksionit në bazë të kësaj Oferte Referencë janë si më poshtë:

I. Shërbimet e Interkoneksionit të ofruara nga TiK:

TiK në këtë Marrëveshje Interkoneksioni përshkruan shërbimet e telekomunikacionit (interkoneksioni) që ofron për Operatorin Përfitues dhe që i kategorizon në: Shërbime të trafikut (terminimi, tranzitimi, origjinimi) dhe shërbime të tjera (shërbime të linjës së interkoneksionit, shërbime të bashkëvendosjes) të përshkruara më poshtë.

I.1 Shërbimet e Trafikut

Shërbimet e trafikut të ofruar nga TiK për Operatorin Përfitues përfshijnë Shërbimet për Trafikun Kombëtar të Komunikimeve Telefonike dhe Shërbimet për Trafikun Ndërkombëtar të Komunikimeve Telefonike.

TiK Ofron për Operatorin Përfitues shërbimet e trafikut të përshkruara si më poshtë.

I.1.1 Shërbimi i Terminimit

TiK nëpërmjet Ofrimit të Shërbimit të Terminimit i krijon mundësinë Operatorit Përfitues që thirrjet e dorëzuara nga Operatori Përfitues të terminojnë për tek Përdoruesit dhe Shërbimet e Rrjetit të TiK sipas kategorive përkatëse të trafikut dhe pikave të interkoneksionit.

I.1.1.1 Terminim për thirrjet drejt Përdoruesve të Rrjetit TiK

TiK Ofron Shërbimin e Terminimit të thirrjeve të dorëzuara nga Operatori Përfitues drejt përdoruesve (konsumatorëve) të Rrjetit të TiK për:

- a) Thirrje të origjinuara nga konsumatorët e Operatorit Përfitues (trafik kombëtar);
- b) Thirrje ndërkombëtare të tranzituara nga rrjeti i Operatorit Përfitues (që ka autorizimin përkatës nga ARKEP për tranzitim të thirrjeve ndërkombëtare). Ky shërbim ofrohet sipas përcaktimeve të vendimeve në fuqi të ARKEP.

TiK Ofron Shërbimin e Terminimit për thirrjet drejt Përdoruesve të Rrjetit TiK, shërbim nëpërmjet të cilit TiK, në emër të Operatorit Përfitues përcjell Thirrjet nga Pika e Interkoneksionit për në një Pikë fundore të Rrjetit të tij në Republikën e Kosovës, të identifikuar nëpërmjet numrave gjeografik të TiK sipas planit të numeracionit, duke krijuar një qark të komutuar nga pika e interkoneksionit deri në pikën fundore të rrjetit TiK.

Tarifimi i shërbimit të terminimit për trafikun të origjinuar nga konsumatorët e Operatorit Përfitues bëhet sipas segmenteve përkatës të terminimit të përcaktuar në Aneks 4 "Tarifat e Shërbimeve".

Tarifimi i shërbimit të terminimit për trafikun ndërkombëtar vendoset sipas përcaktimeve të vendimeve në fuqi të ARKEP dhe do të paraqitet në marrëveshjen e interkoneksionit të lidhur mes palëve.

I.1.1.2 Terminim për Shërbimet e Rrjetit TiK

TiK Ofron Shërbimin e Terminimit për Shërbimet në rrjetin TiK, që janë Shërbimet e Informacionit dhe të Emergjencës, nga Rrjeti i Operatorit Përfitues duke krijuar një qark të komutuar nga pika e interkoneksionit deri në pikën e ofrimit të Shërbimit të rrjetit TiK sic përshkruhet në Aneks 1 "Përkufizime" dhe në përcaktimet sipas kësaj marrëveshje në lidhje me segmentet e terminimit.

Shërbimet e Ofruara nga TiK janë si më poshtë:

- Shërbimi i policisë	192
- Shërbimi i emergjencës mjekësore	194
- Shërbimi zjarrfikës	193
- Qendra e Alarmimit dhe Koordinimit Emergjent	112

Tarifimi i shërbimit të terminimit bëhet sipas segmenteve përkatës të terminimit të përcaktuar në Aneks 4 "Tarifat e Shërbimeve".

I.1.1.3 Terminim në rrjetin e TiK për Free Phone (Telefoni pa pagesë)

TiK Ofron Shërbimin e Terminimit për thirrjet e gjeneruara nga përdoruesit e rrjetit të Operatorit Përfitues drejt numrave 0800 (Shërbimin Telefoni pa Pagesë) në rrjetin TiK duke krijuar një qark të komutuar nga pika e interkoneksionit të tij deri në pikën e ofrimit të Shërbimit të rrjetit TiK siç përshkruhet në Aneks 1 "Përkufizime" dhe në përcaktimet sipas kësaj marrëveshje në lidhje me segmentet e terminimit. Tarifimi i këtij shërbimi të terminimit bëhet sipas përcaktimeve në Aneks 4 "Tarifat e Shërbimeve".

I.1.2 Shërbimi i tranzitimit

TiK ofron shërbimin e tranzitimit të thirrjeve kombëtare dhe thirrjeve ndërkombëtare sipas përcaktimeve në seksionet në vijim.

I.1.2.1 Shërbimi i Tranzitimit të thirrjeve kombëtare drejt destinacioneve kombëtare

TiK nëpërmjet Ofritit të Shërbimit të Tranzitimit të thirrjeve kombëtare i krijon mundësinë Operatorit Përfitues që thirrjet e dorëzuara nga Operatori Përfitues në pikën/pikat e interkoneksionit me TiK të transitojnë nga ana e TiK, drejt pikave të interkoneksionit me Operatorët të tjerë kombëtar sipas marrëveshjeve që ata kanë me TiK dhe për:

- a) Thirrje të origjinuara nga konsumatorët e operatorit përfitues;
- b) Thirrje të tranzituara nga rrjeti i operatorit përfitues (që ka autorizimin përkatës të ARKEP-it për tranzitim të thirrjeve ndërkombëtare).

TiK ofron shërbimin e specifikuar në pikën I.1.2.1. b sipas vendimeve përkatëse të ARKEP. Ky shërbim implementohet pasi Operatori Përfitues të ketë rënë dakord paraprakisht me operatorin terminues të thirrjeve për termat e terminimit të thirrjeve në rrjetin e tij, thirrje të tranzituara nga Operatori Përfitues nëpërmjet TiK për terminim në rrjetin e Operatorit terminues.

Operatori Përfitues njofton TiK për termat e rënë dakord me Operatorin terminues të thirrjes. Shërbimin e tranzitimit për Operatorin Përfitues, TiK e realizon duke krijuar një qark komutues ndërmjet pikës së interkoneksionit me Operatorin Përfitues dhe me pikën e Interkoneksionit/Qasjes të Operatorëve Tjerë.

Shërbimi i tranzitimit për thirrjet kombëtare për Operatorin Përfitues ofrohet nga TiK sipas modelit të tranzitimit me mbartje të detyrimeve, siç përshkruhet në vijim:

- Operatori Përfitues paguan TiK, për trafikun e transituar nga TiK:
 - Pagesën e tranzitimit për TiK,
 - Pagesën e terminimit në Rrjetin e Operatorit Tjetër Përfitues,

TiK i paguan operatorit ku terminohen thirrjet pagesën përkatëse për terminimin e thirrjeve. TiK, njofton operatorin ku terminojnë thirrjet për identitetin e operatorit origjinues dhe numeracionin e këtij operatori.

Numeracioni i operatorëve njoftohet në marrëveshjen e interkoneksionit sipas Aneks 19 "Numeracioni i Operatorëve tjerë Kombëtar" të kësaj Oferte Referencë.

Për faturën e interkoneksionit për shërbimin e tranzitimit duhet të jetë përgatitur informacioni ku

përfshihet identiteti i operatorit origjinues dhe terminues, dhe sasi të respektive mbi të cilën hartohet fatura (e detajuar nëse do të kërkohet), dhe të përgatitur mbi bazën e Raportit të Përdorimit të Interkoneksionit dhe Raportit të trafikut të origjinuar/tranzituar të përmendur në Aneks 9 "Matja, Deklarimi i Trafikut/Procedurat".

Tarifat e shërbimit të tranzitimit sipas llojit të trafikut të tranzituar specifikuar në pikën a dhe b më sipër si dhe sipas segmenteve përkatës për pagesat për tranzitim janë përcaktuar në Aneks 4 "Tarifat e Shërbimeve."

I.1.3 Shërbimi i Origjinimit të thirrjeve nga Rrjeti i TiK-ut

TiK ofron shërbimin e origjinimit të thirrjeve duke dorëzuar thirrjen e origjinuar nga konsumatori drejt Operatorit Përfitues të përzgjedhur nga konsumatori.

Te rasti i origjinimit të thirrjeve TiK ofron këto shërbime:

- Zgjedhja e Operatorit për secilën thirrje dhe
- Parazgjedhja e Operatorit

I.1.3.1 Shërbimi Zgjedhja e operatorit për secilën thirrje

Zgjedhja e operatorit për secilën thirrje ka të bëjë me mundësinë e shfrytëzuesit që të zgjedhë Operatorin Përfitues kur bën një thirrje.

Zgjedhja zakonisht bëhet me prefiksin e operatorit të zgjedhur para se të formohet sekuenca e shifrave, e cila përdoret për të arritur tek i thirruri kur nuk zgjedhet operator.

Pas kësaj, TiK i cili ofron qasje në rrjetë për konsumatorët do të analizojë prefiksin e thirrur dhe do ta drejtojë thirrjen tek Operatori Përfitues i caktuar përmes pikës më të afërt të interkoneksionit. Përgjegjësia për të kontrolluar nëse konsumatori është i autorizuar për të përdorur shërbimet, kalon tek Operatori Përfitues i atyre shërbimeve.

I.1.3.2 Shërbimi Parazgjedhja e Operatorit

Me parazgjedhjen e operatorit, Operatori Përfitues programohen në centralin e TiK-ut ku ofrohet qasje në rrjetë për shfrytëzuesit sipas zgjedhjes së këtij të fundit. Zgjedhja e Operatorit Përfitues është e aplikueshme për secilën thirrje dhe në këtë rast zgjedhja e prefiksit të operatorit nuk është e nevojshme.

Mundësia e Operatorit Përfitues për të përfitur këto shërbime nga TiK do të bazohet në kërkesat dhe kushtet e parapara në rregullorën e ARKEP për Zgjedhjen dhe Parazgjedhjen e Operatorit.

I.2 Shërbime të Tjera

I.2.1 Shërbimet e Linjës për realizimin e linkut të interkoneksionit

Shërbimet e lidhjes të Ofruara nga TiK për Operatorin Përfitues të Autorizuar nga ARKEP, ofrohen e jepen në Pikën e Interkoneksionit dhe në Centralin e Interkoneksionit (ose në centralin gateway të qasjes në zonën e interkoneksionit) të përcaktuar në nenin 9 "Interkoneksioni me Rrjetin TiK" dhe në detaje Aneksi 2 "Interkoneksioni me Rrjetin TiK". Në kuadër të Shërbimit për realizimin e linkut të Interkoneksionit bëjnë pjesë shërbimet e Aktivizimit të Interkoneksionit, shërbimet e ndryshme për interkoneksion dhe sigurimi i kapaciteteve për realizimin e interkoneksionit të cilat mundësojnë qasjen në rrjetin TiK nëpërmjet pikës së interkoneksionit dhe Centralit të Interkoneksionit (ose centralit gateway të qasjes në zonën e interkoneksionit).

Këto shërbime shoqërohen me secilën formë të realizimit të interkoneksionit dhe referohen bashkarisht si shërbime të qasjes në zonën e interkoneksionit. Tarifat e këtyre shërbimeve janë të paraqitura në Aneksin 4 "Tarifat e Shërbimeve".

Shërbimet e Lidhjes, realizimit të linkut të interkoneksionit dhe implementimit të qarqeve E1 (2 Mbit/sec) në linkun e interkoneksionit të Ofruara nga TiK janë:

I.2.1.1. Aktivizimi i Interkoneksionit

Shërbimi i aktivizimit të interkoneksionit përfshin kryerjen e procedurave tekniko-administrative të nevojshme për realizimin e Interkoneksionit ndërmjet rrjeteve të palëve. Këto procedura bëhen në fazën fillestare të realizimit të interkoneksionit dhe vetëm një herë. Disa nga procedurat kryesore teknike që karakterizojnë këtë shërbim janë:

- a. Lidhje në pikën e interkoneksionit
- b. Implementim Numeracioni
- c. Krijim Trunk Group
- d. Krijim Link Sinjalizimi (DL)
- e. Konfigurimi strukturës së matjeve të trafikut dhe treguesve të cilësisë

I.2.1.2. Shërbime të Ndryshme për Interkoneksionin

Në këtë shërbim përshkruhen disa nga procedurat kryesore që kërkojnë konfigurime ose punime instaluese shtesë në qarkun e interkoneksionit në rastin e zgjerimeve të ndryshme që bëhen në interkoneksion.

Disa nga procedurat kryesore të përfshira në këtë shërbim janë:

- a. Ndërprerje/Rilidhje në pikën e interkoneksionit
- b. Ç'aktivizim/aktivizim numeracioni i plotë ose të pjesshëm
- c. Ndryshim i pikës së interkoneksionit

Shërbimet e mësipërme ofrohen nga TiK me kërkesë të Operatorit Përfitues pasi të jetë nënshkruar e hyrë në fuqi Marrëveshja e Interkoneksionit midis TiK e Operatorit Përfitues.

I.2.1.3 Sigurimi i kapaciteteve për realizimin e Interkoneksionit në rastin e ndërmjetëm, në ambientet e Operatorit Përfitues apo me bashkëvendosje në hapësirat e TiK-ut

I.2.1.3.1.a Në rastet kur interkoneksioni realizohet me qarqet digjitale 2Mbps të TiK me bashkëvendosje në ambientet e Operatorit Përfitues apo interkoneksion i ndërmjetëm në nivel 2Mbps, Operatori Përfitues do të paguajë çmimin për shërbimin e linjës së interkoneksionit që do të përbëhet nga :

- a- pagesa e njëherëshme për instalimin/realizimin e çdo lidhje prej 2 Mbps
- b- pagesa mujore për çdo lidhje prej 2 Mbps

Tarifa për këtë shërbim përfshihet në çmimoren në fuqi të PTK-së për linjat e huazuara në kategorinë e tarifave për instalim të linjës dhe për kapacitet të linjës e cila ndryshon varësisht nga kapaciteti i kërkuar nga Operatori Përfitues dhe nga gjatësia e segmentit të linjës së huazuar.

I.2.1.3.1.b Në rastet kur, për Interkoneksionin e ndërmjetëm apo deri në ambientet e operatorit përfitues, përdoren mjete fizike transmetimi (FO, linja bakri) të TiK, Operatori Përfitues do të paguajë për mjetet e transmetimit:

- a- pagesën e njëherëshme për instalimin/realizimin e çdo lidhje të mjetit fizik të transmetimit
- b- pagesën mujore të mjetit fizik të transmetimit

Pagesat për këto lloje interkoneksioni vendosen sipas parashikimit në nenin 9 "Interkoneksioni me Rrjetin TiK" dhe në detaje Aneksi 2 "Interkoneksioni me rrjetin TiK", Aneks 4 "Tarifat e Shërbimeve" dhe çmimoren në fuqi për këto shërbime. Pagesat do të jenë edhe në varësi se sa përdoret qarku i interkoneksionit për trafikun që zhvillon operatori përfitues ndaj trafikut total të

zhvilluar nga të dy palët. Për këtë është përcaktuar formula në Aneksin 4 "Tarifat e Shërbimeve".

I.2.1.3.2 Interkoneksioni i bashkëvendosur në ambientet e TiK

Në rastet kur interkoneksioni realizohet me bashkëvendosje në ambientet e TiK, Operatori Përfitues do të paguajë për shërbim të linkut për realizimin e Interkoneksionit dhe për shërbim të bashkëvendosjes së pajisjes së Operatorit Përfitues në ambientet e TiK.

I.2.2 Shërbimi Bashkëvendosjes

TiK Ofron Shërbimin e Bashkëvendosjes për Operatorin Përfitues me kërkesën e tij për vendosjen e Pajisjeve të Operatorit Përfitues në bashkëvendosje në ambientet e TiK detaje të cilat jepen më poshtë.

Qendrat e prezencës fizike të TiK ku mund të ofrohet bashkëvendosja ose mundësia për lidhjen fizike për realizimin e interkoneksionit deri në centralin më të afert ku ofrohen shërbimet e interkoneksionit paraqiten në Aneks 16 "Mundesite per Bashkevendosje".

I.2.2.1 Të përgjithshme

TiK në këtë Aneks përshkruan bashkëvendosjen e pajisjeve, përdorimin e përbashkët të infrastrukturës së tij, me Operatorët Përfitues të Autorizuar nga ARKEP për përfitimin nga ana e Operatorit Përfitues të shërbimeve të ofruara nga TiK.

TiK, do të zbatojë procedurat dhe kushtet për ofrimin e shërbimeve të bashkëvendosjes në përputhje me përcaktimet e Rregullores për Sigurimin e Qasjes dhe Rregullores për Interkoneksion të ARKEP.

TiK do të ofrojë shërbimin e bashkëvendosjes dhe Operatori Përfitues do të paguajë sipas tarifave në Aneksin përkatës të marreveshjes së interkoneksionit, kudo ku ka hapësira të mundshme për bashkëvendosje mbështetur mbi kërkesa të arsyeshme të Operatorit Përfitues.

TiK kundrejt përbashkëtimit të kostove nga Operatori Përfitues do të sigurojë një nivel të arsyeshëm të burimeve teknologjike të infrastrukturës së tij në pikat ku bashkëvendosja ofrohet për qëllime interkoneksioni. Nëse operatori përfitues dëshiron të bashkëvendoset në ndonjërin prej këtyre pikave në të cilën nuk ekziston infrastruktura e nevojshme mbështetëse, Operatori Përfitues duhet të paguajë shpenzimet e përgatitjes së kësaj infrastrukture siç specifikohet në Aneks 4 "Tarifat e shërbimeve".

TiK do të sigurojë një nivel të arsyeshëm të shërbimit dhe në çdo rast Operatori Përfitues duhet të jetë i autorizuar për të njëjtën cilësi të shërbimeve të krahasueshme me atë që TiK siguron për shërbimet dhe facilitetet e tij në përgjithësi.

Operatori Përfitues i bashkëvendosur në TiK në çdo rast do të vendosë vetëm pajisjet që shërbejnë për përfitimin e shërbimeve të ofruara nga TiK e nuk do të kërkojë të lidhë çdo lloj paisje tjetër në bashkëvendosje ndaj sistemit të çdo operatori të palës së tretë.

Operatori Përfitues në bashkëvendosje angazhohet të vendosë vetëm pajisjet e nevojshme për të siguruar shërbimet e ofruara nga ana e TiK dhe nuk do të përdorë paisjet e ndonjë qëllim tjetër që nuk është veçanërisht i lejuar dhe të përfundimit të shërbimeve të tjera që nuk janë të ofruara nga TiK e të përshkruara në Aneks 3 dhe 4 "Përshkrimi i Shërbimeve" dhe "Tarifat e Shërbimeve".

I.2.2.2 Karakteristikat dhe Parametrat Teknik të Pajisjeve të Operatorit Përfitues

TiK i ofron Operatorit Përfitues shërbimin e bashkëvendosjes në mënyrë që të realizohet interkoneksioni ndërmjet dy rrjeteve dhe TiK kërkon që paisjet e operatorit përfitues të jenë konform standardeve të ETSI që janë në zbatim nga TiK.

I.2.2.2.1 Paisjet e Operatorit Përfitues duhet që:

- a) Të jenë "Rack Mount".
- b) Përmasat e rack-ut të Operatorit Përfitues të jenë sipas standardit që përdor TiK.
- c) Përmasat e antenave të miratohen paraprakisht nga TiK.
- d) Të furnizohen me energji sipas standardeve që ka TiK për paisjet e tij.
- e) Të jenë të certifikuara sipas standardeve ndërkombëtare e të miratuara zyrtarisht nga ARKEP.
- f) Të mos dëmtojnë shëndetin dhe të mos rrezikojnë jetën e njeriut.
- g) Të mos shkaktojnë dëmtim të ambientit dhe të mjediseve TiK.
- h) Të instalohen konform kushteve teknike dhe të marrin konfirmim nga TiK para se ato të futen në operim.
- i) Të mos shkaktojnë interferencë në paisjet e TiK dhe në paisjet e operatorëve të tjerë.

Operatori Përfitues duhet të paraqesë paraprakisht TiK të dhëna teknike të paisjeve përbashkëndosje me qëllim që TiK të mund të dimensionojë sistemet e tij të furnizimit me energji, ajër të kondicionuar, sistem tokëzimi, konstruksione për shtrirjen e kablllove të brendshme, konstruksione të kullave antenëmbajtëse etj.

TiK do të ofrojë Operatorit Përfitues informacion më të detajuar pas lidhjes së një marrëveshje konfidencialiteti dhe pas paraqitjes së kërkesës konkrete të Operatorit Përfitues për pajisjet në bashkëndosje.

Operatori Përfitues në bashkëndosje angazhohet e merr përsipër që do të sigurojë nga ana e tij operimin dhe mirëmbajtjen e pajisjeve të tij në bashkëndosje sipas normave e standardeve të përshkruara në aneksin përkatës Aneksi 12 "Marrëveshja e Nivelit të Shërbimit (SLA)".

I.2.2.3 Të drejtat e personelit të Operatorit Përfitues në bashkëndosje

Personeli i autorizuar i Operatorit Përfitues ka të drejtë të hyjë në ambientet e TiK ku janë bashkëndosur paisjet e Operatorit Përfitues.

Nga ana e Operatorit Përfitues prezantohet paraprakisht lista e emrave të stafit të tij të autorizuar që mund të hyjë në ambientet e TiK për të operuar në pajisjet e Operatorit Përfitues në bashkëndosje. Stafit teknik i paraqitur nga Operatori Përfitues dhe që të mund të hyjë në ambientet e TiK në bashkëndosje duhet që:

- a) Të jetë i pajisur me dokument identifikimi për të cilin paraprakisht është rënë dakord më parë.
- b) Të ketë të dhëna të nivelit të kualifikimit teknik të secilit person dhe pozicionin e tij në struktura të Operatorit Përfitues.
- c) Të mbajë përgjegjësi të plotë për veprimet e kryera në pajisjet e Operatorit Përfitues në bashkëndosje.
- d) Të jetë i pajisur me një urdhër pune të nënshkruar nga administratori i Operatorit Përfitues

Lista e personave që do të hyjnë në ambientet e TiK të pajisjeve të Operatorit Përfitues në bashkëndosje në çdo rast e në çdo kohë do të jetë e miratuar nga TiK.

Çdo ndryshim në listën e personave të autorizuar të stafit teknik të Operatorit Përfitues do të miratohet nga TiK vetëm pas kërkesës me shkrim të Operatorit Përfitues të paktën një muaj nga koha e kërkuar për tu kryer ndryshimi.

Personat që do të hyjnë në ambientet e TiK në çdo rast dhe gjatë gjithë kohës së qëndrimit do të shoqërohen nga personat përgjegjës të autorizuar nga TiK.

Pas përfundimit të vizitës të stafit teknik të Operatorit Përfitues në ambientet e TiK të pajisjeve në bashkëndosje të mbahet procesverbal ku evidentohet qëllimi i vizitës, punimet teknike që u kryen gjatë vizitës dhe kohëzgjatja.

I.2.2.4 Shërbimet e Bashkëvendosjes sipas ambienteve.

TiK ofron për Operatorin Përfitues shërbimet e bashkëvendosjes si më poshtë:

I.2.2.4.1 Bashkëvendosje në ambiente teknike

Shërbimi i bashkëvendosjes të pajisjeve të Operatorit Përfitues në ambientet teknike të TiK, në qendrat e TiK, në sektorët teknik të Zonave e Rajoneve TiK, stacionet përsëritëse të transmetimit e sektorët e Rrjetit kabllor Lokal, pronë e TiK.

Shërbimi i bashkëvendosjes të pajisjeve të Operatorit Përfitues në ambientet e mësipërme TiK e ofron me anë të dhënies me qera të sipërfaqeve (hapësirave) të mundshme e të nevojshme për Operatorin Përfitues që do të shërbejnë për bashkëvendosjen e pajisjeve të Operatorit Përfitues në ambientet e TiK. TiK ofron shërbimin e bashkëvendosjes, të dhënies me qera në ambiente:

Te brendshme për vendosjen e pajisjeve të Operatorit Përfitues për sigurimin e qarkut të interkoneksionit;

- a) të pajisura me kushte teknologjike (ajër i kondicionuar, tokëzim etj) dhe,
- b) të papajisura me kushtet teknologjike të mësipërm.

Të jashtme për vendosjen e pajisjeve të Operatorit Përfitues për sigurimin e qarkut të interkoneksionit;

- a) për vendosjen e antenave në kullat antenëmbajtëse të TiK të pajisjeve në bashkëvendosje për sigurimin e qarkut të interkoneksionit

TiK do të ofrojë informacion të detajuar pas nënshkrimit me Operatorin Përfitues të një marrëveshje konfidencialiteti dhe pas paraqitjes nga ana e Operatorit Përfitues të kërkesës konkrete.

I.2.2.4.2 Furnizim me Energji të pajisjeve në bashkëvendosje.

TiK ofron shërbimin e furnizimit me energji (DC/48V dhe AC/220V) për pajisjet e Operatorit Përfitues në bashkëvendosje në ambientet e tij.

TiK ofron marrëveshjen e nivelit të shërbimeve (SLA) për pajisjet në bashkëvendosje për shërbimet dhe fasilitetet për të cilat TiK është i detyruar ti ofrojë Operatorit Përfitues dhe që janë të përfshira në Aneksin 12 "Marrëveshja e Nivelit të Shërbimit (SLA)".

ANEKS 4 TARIFAT E SHËRBIMEVE

I. Tarifat për shërbimet e ofruara nga TiK

I.1. Shërbimet e trafikut

I.1.1 Shërbim Terminimi ne Rrjetin e TiK

I.1.1.1 Terminim në rrjetin TiK për referenc shërbimin e përshkruar në Aneks 3 "Përshkrimi i Shërbimeve" seksioni I.1.1.1. pika 'a' dhe 'b' tarifat për këto shërbime janë:

Sherbimi Trafikut Terminim sipas pikes I.1.1.1.a	Tarifa
Shërbimi i trafikut drejt TiK (Kombëtar)	0.0066 €

Sherbimi Trafikut Terminim sipas pikes I.1.1.1.b	Tarifa
Shërbimi i tranzitimit të trafikut ndërkombëtar drejt TiK (Kombëtar)	Tarifa përcaktohet në mes operatorëve në mirëbesim

I.1.1.2 Terminim në Rrjetin TiK për Shërbimet, me referencë shërbimin e përshkruar në Aneks 3 "Përshkrimi i Shërbimeve" seksioni I.1.1.2.

Tarifa e terminimit në Shërbimet e Informacionit dhe të Emergjencës janë tarifa terminimi si më poshtë:

Shërbimi trafikut	Tarifa
Terminim në Shërbimet e Emergjencës të TiK	
Terminim Shërbime TiK (kombëtar)	Tarifa si për shërbimet në pikën I.1.1.1.a

Shërbimet e Ofruara janë:

- Shërbimi i emergjencës	112
- Shërbimi i policisë	192
- Shërbimii zjarrfikësve	193
- Shërbimi ambulances	194

I.1.1.3 Terminim në rrjetin e TiK për Free Phone(Telefoni pa pagesë) me referencë shërbimin e përshkruar në Aneks 3 "Përshkrimi i Shërbimeve" seksioni I.1.1.3.

TiK ofron shërbimin e terminimit nga konsumatorët e Rrjetit të Përfituesit për në shërbimin telefon pa pagesë të rrjetit të TiK.

Tarifa e terminimit në telefoni pa pagesë me faturim revers (per thirrjet e pranuar) të TiK do të jenë në nivel kombëtar.

TiK ofron këtë shërbim mbasi ka konfirmim nga Subjekti që disponon Kodin e Free Phone dhe të Operatorit Përfitues.

Tarifat për këtë shërbim janë:

Sherbimi	Tarifa
Terminim në shërbimin 0800	0.02 euro/min për thirrjet e origjinuara nga telefonia fikse
	0.03 euro/min për thirrjet e origjinuara nga telefonia mobile

I.1.2 Shërbimi i Transitimit nga TiK

I.1.2.1 Transitim i thirrjeve Kombëtare dhe Ndërkombëtare drejt destinacioneve Kombëtare.

TiK ofron shërbimin e tranzitimit të thirrjeve kombëtare dhe ndërkombëtare të trafikut nga Operatori Përfitues, për Operatorët e Tjerë Përfitues kombëtare, me referencë shërbimin e përshkruar në Aneks 3 "Përshkrimi i Shërbimeve" seksioni I.1.2.1 pika 'a' dhe 'b'.

Tarifat e shërbimeve të tranzitimit të thirrjeve kombëtare nëpërmjet rrjetit të TiK janë:

Sherbimi trafikut	Tarifa për minutë
Transitim Kombëtar sipas pikës I.1.2.1a dhe I.1.2.1.b	+0.002 € mbi tarifën e terminimit drejt operatorit ku terminohet thirrja

Sherbimi trafikut	Tarifa për minutë
Transitim Ndërkombëtar	+30% mbi tarifën e terminimit drejt operatorit Ndërkombëtar ku terminohet thirrja

I.1.3 Tarifat e shërbimit të Origjinimit të thirrjeve nga Rrjeti i TiK-ut

I.1.3.1 Shërbimi Zgjedhja e operatorit për secilën thirrje

Emërtimi	Njësia	Çmimi (pa TVSH) Euro
Tarifa e instalimit	një herë	5,000 €
Tarifa për thirrje telefonike	për minutë	0.0073 €

I.1.3.2 Shërbimi Parazgjedhja e Operatorit

Emërtimi	Njësia	Çmimi (pa TVSH) Euro
Tarifa e instalimit	një herë	5,000 €
Tarifa e instalimit për çdo linjë telefonike (njëherë)	një herë	10.00€
Tarifa mujore për çdo konsumator	mujore	3.60€
Tarifa për thirrje telefonike	për minutë	0.0073€

Nëse Operatori Përfitues do të shtrojë kërkesë për realizimin e të dy shërbimeve të mësipërme atëherë tarifën e instalimit (5,000 €) si operator për ofrimin e shërbimeve të origjinimit të thirrjeve përmes TiK-ut do të paguajë vetëm njëherë.

I.2 Shërbime të tjera

I.2.1 Shërbimet e Linjës për realizimin e linkut të interkoneksionit

I.2.1.1 Aktivizimi i Interkoneksionit

Emërtimi	Njësia	Çmimi (pa TVSH) Euro
Aktivizimi i Interkoneksionit	një herë	5,000 €

I.2.1.2 Shërbime të ndryshme për Interkoneksionin

Emërtimi	Njësia	Çmimi (pa TVSH) Euro
Ndërprerje/Rilidhje në pikën e interkoneksionit	Një herë	100.00 €
Ç'aktivizim/aktivizim numeracioni i plotë ose të pjesshëm	Një herë	50.00 €
Ndryshim i pikës së interkoneksionit për E1	Një herë	350.00 €

I.2.1.3 Sigurimi i kapaciteteve për realizimin e Interkoneksionit për rastin e ndërmjetem, në ambientet e Operatorit Përfitues apo me bashkëvendosje në hapsirat e TiK-ut

Për shërbimet e qarqeve për të realizuar interkoneksionet e përshkruara në pikat I.2.1.3.1,a I.2.1.3.1.b do të vlejn tarifën në fuqi për linjat e huazuara për kapacitetin përkatës. Ku do të aplikohet tarifa nga kategoria e tarifave për instalim të linjës vetëm njëherë dhe tarifa mujore në fuqi për linjat e huazuara për kapacitetin përkatës.

Te rasti i shërbimit I.2.1.3.2 do të aplikohet tarifa për realizimin e linkut të Interkoneksionit (I.2.1.1, I.2.1.2 dhe I.2.1.3) dhe tarifa mujore për bashkëvendosje e përcaktuar në pikën I.2.2

I.2.2 Shërbimi Bashkëvendosjes

Tarifa për bashkëvendosje në hapësirat e TiK-ut është:

Emërtimi	Njësia	Çmimi (pa TVSH) Euro për muaj
Bashkëvendosje e pajisjeve ne hapësirat e TiK-ut	Unit	90.00 €

- 1U= 44.45mm =1.75inch

I.4 Pagesat për kapacitetin e linkut të Interkoneksionit e ndërmjetëm apo në ambientet e Operatorit Përfitues.

Pagesat për shërbimet e lidhjes së interkoneksionit të ndërmjetëm ose deri tek Operatori Përfitues në nivel 2Mbps apo mjet fizik transmetimi(FO,linja bakri)do të jenë sipas llogaritjeve të mëposhtme(formulat):

I.4.1 Për lidhjet në nivel 2Mbps (E1):

$$PE = TE \times \{TrO / (TrO + TrT)\}, \text{ ku:}$$

P = pagesa për cdo 2Mbps (E1)

T = tarifa për cdo 2Mbps (E1) (qarqet digital 2Mbps sipas tarifave në fuqi të TiK)

E = "Mujore" për cdo 2Mbps (E1)

ose

"Instalimi" për cdo 2Mbps (E1) të ri që do të lidhet (që paguhet vetëm një herë)

TrO = trafiku mujor i dërguar nga operatori përfitues

TrT = trafiku mujor i dërguar nga TiK

Në rastin e llogaritjes së pagesës për "Instalimin", vlerat e trafikut për tu shkëmbyer nga palët do të merren nga parashikimi që do të bëjë Operatori Përfitues për trafikun që do të zhvillohet në 2Mbps(E1) e ri që kërkohet të instalohet.

I.4.2 Për lidhjet me mjete fizike (FO, linja bakri)

$$PM = TM \times \{TrO / (TrO + TrT)\}, \text{ ku:}$$

P = pagesa për mjetin fizik të transmetimit (cift fibër FO ose linja bakri)

T = tarifa për mjetin fizik të transmetimit (cift fibër FO ose linja bakri sipas tarifave në fuqi të TiK)

M = "Mujore" për cdo mjet transmetimi

ose

"Instalimi" për cdo mjet transmetimi që do të instalohet (që paguhet vetëm një herë)

TrO = trafiku mujor i dërguar nga Operatori Përfitues

TrT = trafiku mujor i dërguar nga TiK

Në rastin e llogaritjes së pagesës për "Instalimin", vlerat e trafikut për tu shkëmbyer nga palët do të merren nga parashikimi që do të bëjë Operatori Përfitues për trafikun që do të zhvillohet në mjetin e ri të transmetimit që kërkohet të instalohet.

Tarifat ne fuqi për qarqet digjitale 2Mbps,kopje fibër optike,linjë bakri të TiK publikohen rregullisht nga TiK ose i vihen në dispozicion zyrtarisht Operatorit Përfitues. Çdo ndryshim i tyre konform ligjit,vendimeve dhe akteve përkatëse të rregullimit do të reflektohen rregullisht në përlogaritjen e pagesave.

Aneks 5 Kërkesa Standarde

Posta dhe Telekomunikacioni i Kosovës

Kërkesa Standarde për shërbime të interkoneksionit

Emertimi i Kompanisë:	<input type="text"/>		
Nr. i Biznesit:	<input type="text"/>	Nr. Fiskal:	<input type="text"/>
Drejtori i Kompanisë:	<input type="text"/>		
Adresa:	<input type="text"/>		
Tel:	<input type="text"/>	<input type="text"/>	<input type="text"/>
Fax:	<input type="text"/>	<input type="text"/>	<input type="text"/>
Kontakti Administrativ:	<input type="text"/>	Mob:	<input type="text"/>
		E-mail:	<input type="text"/>
Kontakti Teknik:	<input type="text"/>	Mob:	<input type="text"/>
		E-mail:	<input type="text"/>
Emri bankes se Kompanisë:	<input type="text"/>		
Xhirrollogaria e Kompanisë:	<input type="text"/>		

Lista e dokumenteve të bashkangjitura në kërkesen e Interkoneksionit

- Certifikata mbi regjistrimin e biznesit
- Certifikata e TVSH-se
- Certifikata e Numrit Fiskal
- Licenca për shërbimet përkatëse nga ARKEP
- Vendimin e ARKEP për alokimin e numeracionit
- Licenca/Autorizimi për shërbimet përkatëse nga ARKEP
- Dokumentin mbi obligimet fiskale nga Administrata Tatimore e Kosovës (ATK)
- Dokumentin e nënshkruar mbi ruajtjen e konfidencialitetit (ref. PTK)
- Dokumentin mbi përshkrimin dhe specifikimin e shërbimeve të kërkuara për interkoneksion me PTK-në (TiK)
- Dokumentin mbi kapacitetin fillestar të kërkuar dhe parashikimet për 12-mujore të trafikut që do të zbatohen me interkoneksion.
- Dokumentin mbi specifikimin e lokacionit të propozuar të pikave të qasjes të Telekomit të Kosovës në të cilat kërkohet nderlidhja për interkoneksion.
- Lista e pajisjeve të përdorura për Interkoneksion dhe specifikimi i tyre.
- Dëshmi të pajisjeve të komunikimit mbi pajtueshmërinë e pajisjeve me standardet e duhura teknike të përcaktuara me ligj, ligjet e përgjithshme të Telekomunikacionit dhe standardet e ETSI, ITU-T, si dhe normat dhe standardet që zbatohen në Bashkimin Evropian, për pajisjet dhe mjetet në rrjetin e Operatorit të cilat janë të nevojshme për t'u lidhur në rrjetin e Telekomit të Kosovës.

ANEKS 6 ÇËSHËTJE TEKNIKE

1. Të përgjithshme

Ky Aneks përmban:

- parimet dhe karakteristikat/kriteret teknike të Interkoneksionit të rrjeteve TiK dhe të Operatorit Përfitues,
- informacion për ndërfaqen teknike, protokolet dhe sigurimin e përputhshmërisë së shërbimeve

Në zbatim të kësaj Oferte Referencë, Operatori Përfitues dhe TiK do të sigurojnë përputhshmërinë e plotë të paisjeve të tyre dhe protokolleve përkatës që të garantohet ofrimi i shërbimeve konform standardeve dhe normave të cilësisë, pjesë e këtij dokumenti.

2. Planifikimi i Rrjetit

- a) Palët duhet të njoftojnë njera tjetrën për planet e tyre në lidhje me çështjet e mëposhtme:
- b) Vendosja ose përcaktimi apo ndryshimi i Pikës së Interkoneksionit në lidhje me zonën e Interkoneksionit dhe centralin e interkoneksionit.
- c) Kapacitetin e qarkut të interkoneksionit, konfigurimi apo ndryshimin e tij.
- d) Standardet e ndërfaqeve teknike.
- e) Sinkronizimin e sistemeve të telekomunikacioneve.
- f) Konfigurimi i sistemit të sinjalizimit dhe rrugëzimit të sinjalizimit të trafikut (signalling traffic routing) apo ndryshimet në konfigurimet e tyre të mundshme.
- g) Përcaktimet apo ndryshimet e rrugëzimit të trafikut routing), të cilat janë me rëndësi për shërbimet e ofruara.
- h) Ndryshime të tjera të rrjetit, të cilat janë me rëndësi për shërbimet interkoneksionit (trafikut).

3. Pika e interkoneksionit të Operatorit Përfitues me rrjetin TiK:

3.1. Për të realizuar interkoneksionin, Operatori Përfitues interkonekton rrjetin e tij në rrjetin e TiK në pikën fizike të interkoneksionit:

DDF e TiK, vendndodhja në pikën me të afert të prezencës ku kërkohet interkoneksioni fizik në rrjetin e TiK. Nyja komutuese për interkoneksion është Centrali EWSD Dardania në Prishtinë _____

Vendodhja gjeografike e pikës së interkoneksionit:

4. Kapaciteti i qarkut të Interkoneksionit, konfigurimi apo ndryshimi i tij.

4.1. Kapaciteti i qarkut të interkoneksionit ndërmjet centralit të interkoneksionit të TiK dhe centralit të Operatorit Përfitues do të jetë në total i mjaftueshëm për përballimin e trafikut që gjenerohet nga operatori përfitues nepermjet qarqeve E1.

4.2. Konfigurimi dhe drejtimi i qarqeve të interkoneksionit do të bëhet me marrëveshje midis palëve:

-Dy drejtimësh (Both Way)- BW

4.3. Secila nga palët mund të iniciojë kërkesë për zgjerim të kapacitetit ekzistues në rastin kur përdorimi i zakonshëm (i vazhdueshëm) i kapacitetit të interkoneksionit gjatë orëve të peak-ut kalon 75%,ose sipas përcaktimeve në Aneks7 "Parashikimi dhe Porosia për Kapacitetet e Interkoneksionit". Kërkesa konsiderohet e tillë kur është e shoqëruar me provat përkatëse(të dhëna analitike nga centralet respektive) që provojnë okupimin e qarkut të interkoneksionit mes palëve.

5. Nderfaqe Fizike

Ndërfaqja Fizike për rrjetin TiK është sipas rekomandimit të ITU T G703 për 2.048 kb/s me impedancë 75 Ohm Asimetrik ose 120 Ohm Simetrik.

Shuarja midis pikave fundore të dy DDF duke përfshirë dhe kabllot e interkoneksionit nuk do të jetë më e madhe se 6dB per 1024 KHz. Çdo ndryshim që do të rezultojë nga kjo do të jetë objekt i diskutimeve të veçanta midis Palëve.

5.1. Ndërfaqet teknike duhet të kenë karakteristikat fizike dhe elektrike të ndërfaqeve numerike(digital) që operojnë në 2048 Kbit/s ndërmjet Rrjetit TiK dhe Rrjetit të Operatorit Përfitues.

Të gjitha referencat janë në përputhje me rekomandimet G700-G795 të ITU, përveç se kur deklarohet ndryshe.

5.2. Impedanca e terminimeve:

Në pikën e Interkoneksionit impedanca në DDF e TiK është 75 Ohm/Assymetric ose 120 Ohm simetrik. Impedanca për qarqet apo lidhjet që mund të zgjerohen/ndryshohen në të ardhmen, do të vendoset rast pas rasti.

5.3. Humbjet e kthimit minimale do të jenë të barazvlefshme ose më të larta se limitet e mëposhtme.

18dB për frekuencat 102-2048 KHz.

12dB për frekuencat 51-102 KHz.

Karakteristikat e ndërfaqes zbatohet rekomandimi I ITU – T G.703, (Physical/electrical characteristics of hierarchical digital interfaces)

5.4. Shuarja

Shuarja midis pikave fundore të dy DDF, duke përfshirë dhe kabllot e lidhjes nuk do të jetë më e madhe se: 6dB për 1024 KHz.

Cdo ndryshim që do të rezultojë nga kjo do të jetë objekt i diskutimeve të veçanta midis palëve.

5.5. Struktura e multipleksimit

Struktura e multipleksimit do të jetë sipas rekomandimeve G.732,G.704,G.705 dhe Q.511 në lidhje me centralet numerike.

5.6. Wander dhe Jitter

Do të zbatohen paragrafet 2 dhe 3 të rekomandimit G.823.

5.7. Intervali kohor jo zero

Është i zbatueshëm Rekomandimi G.704,paragrafet 2.3.1 dhe 2.3.2.Përdorimi i pajisjeve që kanë të bëjnë me shifrën e 8-tetë binare në mënyrën e përshkruar do të jetë objekt i marreveshjes së operimit.

5.8. Kushtet e gabimeve dhe efekteve pasuese

Zbatohet Rekomandimi G.703

5.9. Devijime nga Rekomandimet

Në qoftë se gjatë fazës së zbatimit ose në të ardhmen vihet re një devijim nga Rekomandimet e mësipërme nga TiK ose nga Operatori Përfitues, të dyja palët do të bashkëveprojnë sa më shumë që të jetë e mundur për të zgjidhur problemin që ka të bëjë me përmbushjen e rekomandimeve përkatëse.

6. Sinkronizimi

Operatorit Përfitues pranon kushtet ekzistuese të rrjetit TiK, lidhur me sinkronizimin dhe ndërfaqet fizike dhe elektrike si dhe kushtet e reja që do të ndryshojnë në përputhje me zhvillimet teknologjike të certifikuara në të ardhmen duke respektuar njoftimet sipas kësaj Oferte Referencë.

7. Sistemi i Sinjalizimit

7.1. Të Përgjithshme

TiK Ofron sistemin e sinjalizimit N7(SSN7) në përputhje me rekomandimet në fuqi të ITU-së si protokol që do të shërbejë për interkonektimin e rrjetit të tij me rrjetin e Operatorit Përfitues. Sistemi i sinjalizimit N7 që TiK ka të implementuar në rrjetin e tij është i optimizuar sipas standardeve ndërkombëtare e rekomandimeve të ITU-së dhe është i përshtatshëm për rrjetet kombëtare e i përputhshëm me rrjetet ndërkombëtarë të telekomunikacioneve. Sistemi i

Sinjalizimit i TiK siguron performancë e fleksibilitet të lartë edhe për shërbimet ISDN dhe është i orientuar për zhvillimet e të ardhmes që kanë kërkesa të reja përvoja të përkjet sistemit të sinjalizimit duke patur siguri të lartë në transferimin e mesazheve e stabilitet të lartë të linkut të sinjalizimit.

Sistemi i Sinjalizimit i TiK përdoret me cilësi të lartë në llojet e mjeteve të transmetimit fizike (linja dypërcjellëse metalike, fibër optike) si dhe në sistemet e transmetimit me mikrovalë e siguron kontroll automatik të linkeve dhe pikave të sinjalizimit.

7.2. Linku i Sinjalizimit

Sinjalizimi mundëson kalimin e informacionit të kërkuar përmes rrjetit me qëllim vendosjen e rregullt, kontrollit e shpërndarjes së lidhjes mes konsumatorëve.

Palët do të shfrytëzojnë sistemin e sinjalizimit N.7 në përputhje me standardet dhe udhëzimet relevante të ITU-T dhe ETSI.

Çdo central në pikat hyrëse të TiK ka mundësi të punojë me sistemin e sinjalizimit Nr.7 dhe si e tillë identifikon dhe adreson me një kod të vetëm kombëtar pikat sinjalizuese.

Përmbledhja e kodeve të pikave sinjalizuese janë dhënë në pikën 7.3 të këtij Aneksi.

Palët për çdo qark interkoneksioni mund të shfrytëzojnë një link të vetëm sinjalizimi (DL) për SS7 ose për çdo qark interkoneksioni të kenë link sinjalizimi (DL) për SS7.

Linku i sinjalizimit do të jete në Ts 16 të E1 të pare të qarkut të interkoneksionit.

Kapaciteti i linkut të sinjalizimit është 64kbit/sec e përdoret edhe për transferimin e sinjalizimit.

7.3. Kodet Kombëtare të Pikave të Sinjalizimit (National Signalling Point Codes -NSPC)

Kodi Kombëtar i Pikës së Sinjalizimit (National Signalling Point Codes-NSPC) i rrjetit TiK (nyjes komutuese-centrale Interkoneksionit) është:

NSPC D 4866

Kodi Kombëtar i Pikës së Sinjalizimit (National Signalling Point Codes-NSPC) i centralit të Operatorit Përfitues është:

NSPC D _____

7.4. Pikat e Transferimit të Sinjalizimit (STP)

Pikat e transferimit të sinjalizimit për TiK për dy pikat (centralet) kombëtare të interkoneksionit janë:

1. Centrali TiK Prishtine (Dardani)

Pikat e transferimit të sinjalizimit për Operatorin Përfitues për centralet përkatëse kombëtare të interkoneksionit janë:

1. Centrali Operatori Përfitues _____

7.5. Standardet e Sinjalizimit

Sinjalizimi midis TiK dhe Operatorit Përfitues do të realizohet nëpërmjet sistemit të sinjalizimit N7 të CCITT në përputhje me rekomandimet përkatëse në fuqi të ITU. (Q.730, Q.731, Q.732, Q.733, Q.734, Q.735, Q.736, Q.737, Q.761, Q.762, Q.763, Q.764, dhe Q.850)

8. Rrugëzimi i trafikut

TiK do të rrugëzojë thirrjet e derguara nga përdoruesit e rrjetit të tij për Operatorin Përfitues drejt pikës së Interkoneksionit me Operatorin Përfitues dhe thirrjet e ardhura nga rrjeti i Operatorit Përfitues në pikën e Interkoneksionit i rrugëzon për në pikën fundore të rrjetit të tij.

TiK do të rrugëzojë trafikun që tranziton nga/për Rrjeti i Operatorit Përfitues, nga/për pika e interkoneksionit me Operatorin Përfitues për/nga në pikën e interkoneksionit me Operatorin Tjetër Përfitues.

TiK do të ofrojë për të gjithë Operatorët Përfitues të njejtat standarde dhe cilësi të rrugëtimit dhe numërformimit të thirjeve për trafikun e shkëmbyer në qarkun e interkoneksionit, që përdor edhe për përdoruesit e rrjetit të tij.

Numërformimi për trafikun e shkëmbyer në këto pika interkoneksioni për terminim në rrjetet respektive dhe tranzitim në rrjetet kombëtare do të jetë 0+NDC+SN.Për thirrjet me destinacion ndërkombëtare numërformimi do të jetë 00+CC+NSN.

Operatori Përfitues i dorëzon thirrjet ndërkombëtare për terminim drejt gjithë përdoruesve të rrjetit TiK në pikat ndërkombëtare të interkoneksionit të TiK.

Deri në krijimin e mundësive të gjitha aplikimet e mësipërme, pa cënuar parimet e rrugëzimit, numërformimit dhe të gjitha shërbimet e interkoneksionit sic është përshkruar edhe në Aneks 2 "Interkoneksioni me Rrjetin TiK",do të bëhen nëpërmjet centraleve tranzite.

8.1. Sa herë është e nevojshme, TiK i njofton Operatorit Përfitues planet e tij për rrugëzimin e trafikut. Në konsultim mes tyre,palët vendosin nëse do të vazhdojnë të përdoren vetëm rrugët ekzistuese, apo duhet të vendosen rrugëzime të reja.

8.2. Parimet e përgjithshme të rrugëzimit:

8.2.1. Trafiku drejt Operatorit Përfitues:

a) Për trafikun nga TiK drejt Operatorit Përfitues, TiK rrugëzon trafikun drejt Pikës së interkoneksionit me Operatorin Përfitues, për të cilën palët kanë rënë dakord, nëpërmjet rrjetit të tij, pavarësisht se ku ndodhet kjo Pikë në lidhje me përdoruesin fundor të TiK, origjinuesi i trafikut (thirrjes).

b) Për trafikun nga rrjetet e Operatorëve të Tretë (fiks/mobile) të Rrjeteve të Komunikimeve Publike të interkonektuar me TiK drejt Operatorit Përfitues, TiK rrugëzon trafikun nga pika e interkoneksionit me ORRKP e Tretë (fiks/mobile), drejt pikës së interkoneksionit me Operatorin Përfitues.

c) Për trafikun nga OSHKP-THK e qasura në rrjetin TiK drejt Operatorit Përfitues, TiK rrugëzon trafikun nga pika e Qasjes të OSHKP-THK, drejt pikës së interkoneksionit me Operatorin Përfitues.

8.2.2. Trafiku nga Operatori Përfitues:

a) Për trafikun nga Operatori Përfitues drejt rrjetit të TiK, TiK e rrugëzon trafikun nga Pika e interkoneksionit me këtë Operator Përfitues deri në përdoruesin fundor të TiK sipas kategorisë së pikës së interkoneksionit varësisht se ku ndodhet përdoruesi fundor në lidhje me pikën e interkoneksionit.

b) Për trafikun nga Operatori Përfitues drejt Operatorëve të tjerë të interkonektuar me TiK, TiK e rrugëzon trafikun nga pika e interkoneksionit me Operatorin Përfitues drejt Pikës së Interkoneksionit të TiK me rrjetin e Operatorit tjetër

9. Numeracioni/Numërformimi

9.1 TiK do të kryejë procedurat e nevojshme për implementimin e numeracionit të Operatorit Përfitues në të gjithë Centralet e Rrjetit të Tij të dhëna në Aneks 19" Numeracioni i Operatorve tjerë Kombëtar" duke bërë aktivizimin e numeracionit që Operatori Përfitues konfirmimom zyrtarisht për operim.

9.2. Operatori Përfitues do të kryejë procedurat e nevojshme për implementimin e numeracionit të TiK-ut, të Operatorit tjetër kombëtar të interkonektuar me rrjetin TiK.

9.3. Numërformimi dhe formati i numrave të Thirrjeve drejt rrjetit të Operatorit Përfitues:

9.3.1. Numërformimi dhe formati i numrave për thirrjet e Origjinuara nga Rrjeti i TiK drejt rrjetit të Operatorit Përfitues kur seritë numerike kanë të njëjtin kod numeracioni është:

Lloji i thirrjes

Thirrje brenda të njëjtës zonë numeracioni
SN

Numërformimi dhe formati

SN
*Numri i të thirrurit në rrjetin e Operatorit Përfitues (subscriber number)

*TiK, origjinues i thirrjes, duhet të shtojë kodin 0+NDC për ta dorëzuar thirrjen në rrjetin e operatorit terminues të thirrjes.

9.3.2. Numërformimi dhe formati i numrave për thirrjet e origjinuara nga Rrjeti TiK drejt rrjetit të Operatorit Përfitues kur seritë numerike nuk kanë të njëjtin kod numeracioni.

Lloji i thirrjes	Numërformimi dhe formati
Thirrje në zona të ndryshme numeracioni	Prefiks Kombëtar + NDC + SN
Prefiksi Kombëtar	0
NDC	Kodi i Drejtimit Kombëtar (National Destination Code)
SN	Numri i të thirrurit (Called Subscriber Number- përdorues ose pajtimtar i Operatorit Përfitues)

9.4. Numërformimi dhe formati i numrave të Thirrjeve nga Rrjeti i Operatorit Përfitues drejt pikës së Interkoneksionit me TiK:

9.4.1. Numërformimi dhe formati i numrave të thirrjeve nga Rrjeti i Operatorit Përfitues, për të termimuar në Rrjetin e TiK kur seritë numerike i përkasin të njëjtës zonë numeracioni:

Lloji i thirrjes	Numërformimi dhe formati
Thirrje brenda të njëjtës zonë numeracioni	SN
SN	*Numri i të thirrurit (subscriber number)

*Operatori Përfitues,origjinues i thirrjes, duhet të shtojë kodin 0+NDC për ta dorëzuar thirrjen në rrjetin e TiK.

9.4.2. Numërformimi dhe formati i numrave të thirrjeve nga Rrjeti i Operatorit Përfitues, për të termimuar në Rrjetin e TiK kur seritë numerike nuk i përkasin të njëjtës zonë numeracioni:

Lloji i thirrjes	Numërformimi dhe formati
Thirrje në zona të ndryshme numeracioni	Prefiks Kombëtar + NDC + SN
Prefiksi Kombëtar	0
NDC	Kodi i Drejtimit Kombëtar (National Destination Code) ose Kodi i Drejtimit të Rrjetit (Network Destination Code)
SN	Numri i të Thirrurit (Called Subscriber Number-përdorues ose pajtimtar i TiK)

9.4.3. Numërformimi dhe formati i numrave të thirrjeve nga rrjeti Operatorit Përfitues drejt pikës së interkoneksionit me TiK për në Operatorët e tjerë të interkonektuar me rrjetin TiK kur seritë numerike i përkasin të njëjtës zonë numeracioni:

Lloji i thirrjes	Numërformimi dhe formati
Thirrje brenda të njëjtës zonë numeracioni	SN
SN	*Numri i të thirrurit në rrjetin e ORRKP të tretë (subscriber number)

*Operatori Përfitues,origjinues i thirrjes duhet të shtojë kodin 0+NDC për ta dorëzuar thirrjen në rrjetin e Operatorit terminues të thirrjes

9.4.4. Numerformimi dhe formati i numrave të thirrjeve nga rrjeti Operatorit Përfitues drejt pikës së interkoneksionit me TiK për në Operatorët e tjerë të interkonektuar me TiK kur seritë numerike nuk i përkasin të njëjtës zonë numeracioni:

Lloji i thirrjes	Numërformimi dhe formati
Thirrje në zona të ndryshme numeracioni	Prefiks Kombëtar + NDC + SN

Prefiksi Kombëtar	0
NDC	Kodi i Drejtimit Kombëtar (National Destination Code)
SN	Numri i të thirrurit(Called Subscriber Number-përdorues ose pajtimtar i ORRKP të tretë)

10. Dërgimi i prezantimit të numrit thirrës (CLI)

Palët përcjellin në pikën e Interkoneksionit Informacionin e Plotë të Identifikimit të Numrit të Thirrësit.

Në momentin kur njëra Palë përcjell thirrjet në rrjetin e Palës tjetër, është e detyruar të transmetojë Identitetin e Numrit Thirrës, pa e ndryshuar ose fshehur atë, duke përdorur protokolin e sinjalizimit CCS Nr.7.

10.1. Për thirrjet e gjeneruara nga rrjeti i TiK, konsumatorët e Rrjetit të Tij të lidhur me Centralet Digitale, dhe të përcjellë tek Operatori Përfitues, TiK do të transmetojë gjithmonë CLI e cila do të jetë në formën (+xxx)+NDC xxxxxxx. Për thirrjet që mund të tranzitohen në rrjetin TiK, CLI do ti prezantohet rrjetit të operatorit përfitues kur kjo i është përcjellë TiK nga operatori që i ka dorëzuar thirrjen.

10.2. Për thirrjet e gjeneruara nga rrjeti i Operatorit Përfitues dhe të përcjellë tek TiK, Operatori Përfitues do të transmetojë gjithmonë CLI e cila do të jetë në formën +xxx+NDC+SN, ku NDC është Kodi i Drejtimit Kombëtar (National Destination Code) ose Kodi i Drejtimit të Rrjetit (Network Destination Code) dhe SN është numri i përdoruesit thirrës. Për thirrjet që mund të tranzitohen nga rrjeti i Operatorit Përfitues dhe të percjella për terminim në rrjetin TiK, Operatori Përfitues duhet të garantojë prezantimin korrekt të CLI nga operatori që i ka dorëzuar thirrjen.

CLI duhet që gjithmonë të paraqesë numrin korrekt të pikës fundore të rrjetit publik në të cilin është origjinuar thirrja. Ky numër është një numër i cili është alokuar nga Autoriteti kompetent. Secila Palë garanton rrugëzimin transparent të Informacionit të Identitetit të Numrit Thirrës, pa e ndryshuar ose fshehur, përmes rrjetit të saj dhe dërgimin e Identitetit të Numrit Thirrës në rrjetin e Palës tjetër.

Çdo ndryshim/modifikim apo fshehje të Identitetit të Numrit thirrës përbën një shkelje të kushteve të marrëveshjes në fjalë si dhe një shkelje ligjore.

10.3. Në rastet kur një operator në bazë të provave që disponon faktin se Operatori Përfitues modifikon apo fsheh CLI e thirrjeve të përcjella nga Operatori Përfitues, operatori ka të drejtë të paralajmërojë me shkrim operatorin në shkelje duke njoftuar njëkohësisht dhe ARKEP-in, për pezullimin e ofrimit të shërbimeve të interkoneksionit, nëse në mënyrë të menjëhershme dhe në çdo rast jo më vonë se brenda një afati prej 24 orësh nga marrja e njoftimit, nuk ndërpritet shkelja e konstatuar. Në njoftimin e dërguar përfshihen provat që faktojnë shkeljen e pretenduar, seritë numerike të cilat janë keqpërdorur, si dhe masa e pezullimit që do të merret nga operatori ankimues nëse shkelja nuk ndërpritet brenda afatit të caktuar. Brenda këtij afati, Operatori në shkelje duhet të ndërpresë menjëherë shkeljen e njoftuar ose nëse pretendon se nuk ka kryer asnjë shkelje të paraqes kundërshtimet dhe provat e tij pranë operatorit njoftues dhe ARKEP, duke i njoftuar paraprakisht në rrugë elektronike dhe brenda 5 (pesë) ditëve kalendarike të paraqes provat që disponon.

10.4. Operatori i njoftuar për shkeljen ka detyrimin që të pergjigjet menjëherë kundrejt njoftimit të marrë.

a. Në rast se operatori i njoftuar për shkeljen nuk e ndërpret atë brenda afatit të caktuar në njoftim ose nëse pretendon se nuk e ka kryer shkeljen, nuk njofton paraprakisht në rrugë elektronike dhe brenda afatit 5(pesë)ditor nuk paraqet provat që vertetojnë

pretendimin e tij, atëherë operatori që ka bërë njoftimin për shkelje pezullon ofrimin e shërbimeve të interkoneksionit sipas njoftimit të bërë;

b. Nëse operatori i njoftuar për shkeljen nuk ndërpret shkeljen e faktuar brenda 24 orëve nga marrja e njoftimit ose nuk dërgon mesazhin paraprak se nuk është në shkelje dhe për këtë do të dërgojë provat e tij brenda 5 (pesë)ditëve, atëherë operatori i dëmtuar pezullon në fund të këtij afati ofrimin e shërbimeve të interkoneksionit;

c. Në rast se operatori i njoftuar për shkeljen dërgon mesazhin paraprak se nuk është në shkelje dhe për këtë do të paraqësi brenda afatit provat e tij dhe në përfundim të këtij afati nuk paraqet asnjë provë, atëherë operatori i dëmtuar ndërpret pas 5 (pesë) ditëve nga njoftimi i bërë, ofrimin e shërbimeve të interkoneksionit;

10.5. Pala që merr Identitetin e Numrit Thirrës do ta përdorë vetëm për qëllimet e mëposhtme:

Rrugëzim / Faturim të thirrjeve dhe matjeve statistikore.

Prezantim i Identitetit të thirrësit – Prezantim i Identitetit të Numrit Thirrës (CLIP),

për aq kohë sa nuk është aktivizuar nga përdoruesi thirrës Fshehja e Identitetit të Numrit Thirrës (CLIR). Në rastet e aktivizimit të CLIR nga abonenti thirrës, operatori i këtij abonenti duhet të përcjellë CLI operatorit të interkonektuar me të.

Palët dhe të gjithë operatorët duhet të respektojnë, për aq sa është teknikisht e mundshme, rekomandimet përkatëse të ITU dhe Udhezimin (02)051 të ETP (European Telecom Platform) për CLI.

TiK Ofron shërbimin e dërgimit të CLI duke përdorur protokolet e pranuar në Sistemin e Sinjalizimit N7 të përfshirë në Sinjalizimin ISUP. Informacioni i plotë i CLI – së për Rrjetin TiK është max 17 Digit.

Operatori Përfitues detyrohet të garantojë prezantimin e CLI si dhe mos ndryshimin (tjetërsimin) e saj.

11. Testimi i Interkoneksionit

Interkoneksioni do të testohet për një periudhë dhjetë (10) ditore me procedura të përcaktuara të testimit të cilat konsistojnë në përputhshmërinë e Sistemit të Sinjalizimit, Rrugëzimit e trafikut, konfirmimin e CLI-së dhe të saktësisë së matjeve të treguesve të trafikut sipas shërbimeve të ofruara etj.

TiK dhe Operatori Përfitues për periudhën e testimit do të sigurojnë edhe numra test.

Saktësia e testeve do të konfirmohet nga TiK dhe nga Operatori Përfitues. Testimi i saktësisë së treguesve të trafikut do të bazohet në CDR-et e evidentuara gjatë periudhës

së testimit e do të përcaktohet numri i komunikimeve të realizuara, kohëzgjatja e tyre si dhe tregues të cilesisë.

TiK nëse është e nevojshme do të ofrojë informacion më të hollësishëm teknik pas

nënshkrimit me Operatorin Përfitues të një marrëveshje konfidencialiteti dhe pas paraqitjes nga Operatori Përfitues të kërkesës konkrete.

12. Ndryshimet në Rrjete

Secila palë mund të bëjë ndryshime në rrjetin e tij pa shkaktuar efekte direkte apo indirekte në lidhje me pikën e interkoneksionit dhe në vecanti për shërbimet e ofruara në marrëveshjen e interkoneksionit sipas kësaj Ofertë Reference. Në rastin e ndryshimeve të tjera të rrjetit që janë me rëndësi për shërbimet e interkoneksionit të tilla që kanë të bëjnë me ndryshime të pikës së interkoneksionit, apo ndryshime të parametrave të rrugëzimit e që ndikojnë në marrëdhëniet ekzistuese të interkoneksionit tja bëjë me dije Operatorit Përfitues e do t'i japë Operatorit Përfitues njoftime të mjaftueshme. Në këto raste do të veprohet sipas

parashikimeve në nenin 14, pika 3 dhe Aneks 7 "Bashkëpunimi i Palëve".

13. Blllokskema e Interkoneksionit

Në Blllokskemën e Interkoneksionit paraqiten mënyra e realizimit të interkoneksionit e shoqëruar edhe me elementet e bashkëvendosjes dhe fasilitetet e përdorur. Blllokskema jepet ne Aneks 14 "Blllokskema e Interkoneksionit" të Marrëveshjes së Interkoneksionit.

ANEKS 7 BASHKËPUNIMI I PALËVE

1. Të përgjithshme

Për të siguruar funksionimin e rregullt të Interkoneksionit për ofrimin e shërbimeve të interkoneksionit, TiK dhe Operatori Përfitues do të bashkëpunojnë për shfrytëzimin dhe mirëmbajtjen e rrjeteve të tyre sipas kushteve të kësaj Oferte Referencë në përgjithësi, dhe në mënyrë specifike sipas këtij Aneksi.

2. Përgjegjësitë e palëve

2.1. Njoftimi

Në rastin e problemeve të rëndësishme të cilat ndikojnë, ose vlerësohen se ndikojnë në shërbimet e interkoneksionit, Palët duhet të njoftojnë njera-tjetrën konform procedurave të përshkruara në Aneksin 12 "Marreveshja e Nivelit të Shërbimit (SLA)".

2.2. Kontrolli

Palët do të kontrollojnë në mënyrë të vazhdueshme të gjithë elementet në rrjetin e tyre që kanë të bëjnë me interkoneksionin, përgjatë 24 orëve çdo ditë të vitit.

2.3. Dhënien e raporteve

TiK dhe Operatori Përfitues do të mundësojnë njëri tjetrit dhënien e raporteve për problemet.

2.4. Qarku i Interkoneksionit për ofrimin e shërbimeve.

Secila palë për pjesën e vet të qarkut/linkut të interkoneksionit do të jetë plotësisht përgjegjëse për të gjithë punën që duhet bërë në qark/link, ndërprerjen për mirëmbajtjen dhe testimin rutinë, si dhe për rivendosjen e qarkut/linkut pas çdo veprimi që ka çuar në ndërprerjen apo në ndonjë efekt tjetër në lidhje.

3. Punimet e planifikuara që ndikojnë në trafik

3.1. Përshkrim

Të tilla punime janë psh:

- a) Punimet në një linjë, pajisje ose instalim që përdoret për një qark/link Interkoneksioni.
- b) Punimet në central ose paisjet komutuese në të cilat është lidhur një qark Interkoneksioni dhe puna në paisjet e Palëve që kanë ndikim të drejtpërdrejtë në qark.

3.2. Njoftimi

Pala që parashikon të kryejë punimet e planifikuara duhet të njoftojë palën tjetër të paktën 10 (dhjetë) ditë më përpara. Njoftimi duhet të përmbajë patjetër elementet e mëposhtme:

- a) përfaqësuesi i palës, numrat e telefonit dhe të fax-it dhe adresën e-mail
- b) përshkrimin e punimit që do të bëhet
- c) kohën në të cilën do të fillojë puna, dhe kohëzgjatja e planifikuar
- d) veprimet e detajuara që do të bëhen
- e) çrregullimet e mundëshme
- f) afati i përfundimit
- g) çdo informacion tjetër të nevojshëm në interes të palës tjetër, nëse puna e planifikuar mund të mos kryhet në përputhje me informacionin e dhënë.

4. Personat e kontaktit

Për implementimin dhe për realizimin e shërbimeve të ofruar a sipas Marrëveshjes së Interkoneksionit dhe për të gjithë mbarëvajtjen e saj, secila Palë cakton person kontakti zyrtar si më poshtë:

	TIK	OPERATORI PËRFITUES
Për Deklarim,	_____	_____

Rakordim e Trafikut	Tel: _____ Mob: _____ E-mail: _____	Tel: _____ Mob: _____ E-mail: _____
Për Faturim, Pagesa dhe Garanci	Tel: _____ Fax: _____ E-mail: _____ Në vëmendje të: _____	Tel: _____ Fax: _____ E-mail: _____
Për Probleme Teknike	Sektori teknik _____ Tel: _____ Qendra e Menaxhimit TiK Tel: _____ Mob: _____	Mob: _____ E-mail: _____

Në rast ndryshimi të personave të kontaktit secila Palë ka detyrimin ti njoftojë me shkrim menjëherë Palës tjetër emrat dhe adresat e kontaktit të personave të rinj të kontaktit.

Personat e kontaktit në bashkëpunim do të mbikqyrin zbatimin në vijueshmëri të kesaj marrëveshjeje.

Palët do të koordinojnë punët dhe do ti raportojnë njeri tjetrit për cdo problem që nuk ka gjetur zgjidhje. Me marrjen e këtij raporti Palët duhet të konsultohen me njera-tjetrën me qëllim që të arrijnë një zgjidhje të pranueshme për të dy Palët.

Për ceshtjet teknike dhe të funksionimit që kanë lidhje me zbatimin e kësaj Marrëveshjeje, Palët do të krijojnë grupe të përbashkëta pune.

5. Standardet e Sigurisë

Palët do të marrin të gjithë masat e nevojshme në mënyrë që të sigurojnë që zbatimi i Marrëveshjes së Interkoneksionit nuk do të rrezikojë shëndetin, sigurinë dhe jetën e të gjithë personave, duke përfshirë të punësuarit dhe përdoruesit e njeri-tjetrit. Secila Palë është përgjegjëse për një funksionim të sigurtë pa rrezik për shëndetin dhe jetën e njërëzve të pajisjeve brenda Sistemit të saj, në anën e saj të pikës së interkoneksionit.

6. Mbrojtja e rrjeteve/sistemeve dhe shërbimeve

Secila Palë nuk do të kryejë dhe nuk do të lejojë që të kryhen veprime në Rrjetin/Sistemin e saj, të cilat do ti shkaktojnë dëme palës tjetër.

Në funksion të mbrojtjes së rrjeteve/sistemeve dhe të vendosjes së standardeve sa më cilësore teknike për paisjet e Operatorit Përfitues që do të bashkëvendosen në ambientet e tij, TiK do të kërkojë dhe do të pranojë instalimin e paisjeve që sigurojnë kushtet e mëposhtme:

- Të jenë "Rack Mounted"
- Përmasat e rack-ut të Operatorit Përfitues të jenë sipas standardit që përdor TiK.
- Të furnizohen me energji sipas standardeve që ka TiK për paisjet e tij.
- Të jenë të certifikuara sipas standardeve ndërkombetare e të miratuara nga ARKEP.
- Të mos dëmtojnë shëndetin dhe të mos rrezikojnë jetën e njeriut.
- Të mos shkaktojnë dëmtim të ambientit dhe të mjediseve TiK
- Të instalohen konform kushteve teknike dhe të marrin konfirmim nga TiK para se ato të futen në operim.
- Të mos shkaktojnë interferencë në paisjet e TiK dhe në paisjet e operatorëve të tjerë përfitues.

Operatori Përfitues duhet ti paraqesë paraprakisht TiK të dhëna teknike të paisjeve për

bashkëvendosje me qëllim që TiK të mund të dimensionojë sistemet e tij të furnizimit me energji, ajër të kondicionuar, sistem tokëzimi, konstruksione për shtrirjen e kablllove të brendshme, konstruksione të kullave antenëmbajtëse etj.

Palët do të evidentojnë pajisjet e bashkëvendosura në ambientet e TiK, përmasat dhe fuqitë e tyre.

Asnjë pajisje tjetër e Operatori Përfitues nuk do të instalohet pa miratimin e TiK.

Operatori Përfitues do të tarifohet për shërbimin e bashkëvendosjes sipas Aneks 4 "Tarifat e Shërbimeve"

7. E drejta e hyrjes së personelit

Për përmbushjen e detyrimeve të Marrëveshjes së Interkoneksionit secila Palë ka të drejtë që nëpërmjet një njoftimi të bërë Palës tjetër (dhjetë) 10 ditë përpara hyrjes së planifikuar për rastet normale (jo-emergjente) ose në mënyrë të menjehershme në raste emergjente, të hyjë dhe të qëndrojë në ambientet e Palës tjetër për të realizuar punimet e nevojshme.

Rregulla mbi hyrjen e personelit të Operatorit Përfitues në ambientet TiK ku janë bashkëvendosur pajisjet, janë të referuara në Aneks 3 pika I.2.2.3 "Përshkrimi i Shërbimeve".

E drejta e hyrjes në ambientet e Palës tjetër, ushtrohet nga secila Palë (për personelin teknik të miratuar nga palët) gjatë gjithë kohëzgjatjes së marrëveshjes si dhe për aq kohë sa është e nevojshme për Palët për tu shkëputur dhe për të terhequr pajisjet e tyre.

8. Testime

Palët në bashkëpunim mund të iniciojnë në çdo kohë teste të caktuara për të garantuar funksionimin e interkoneksionit, sistemeve apo pajisjeve dhe të çdo elementi tjetër që ka të bëjë me interkoneksionin.

ANEKS 8 PARASHIKIMI DHE POROSIA PËR KAPACITETET E INTERKONEKSIONIT

1. Palët ofrojnë parashikimet e trafikut për qëllime të planifikimit të rrjetit për të siguruar kapacitetet e duhura të komutimit dhe transmetimit për të mbajtur një përqindje mesatare të përdorimit të interkoneksionit mes 60%-75% në orët e peak-ut në një ditë të zakonshme (përveç rasteve të situatave emergjente dhe festave).

2. Secila nga Palët mund të iniciojë një kërkesë për zgjerim të kapacitetit ekzistues apo vendosjen e një pike të re interkoneksioni mes rrjeteve. Kushti paraprak për instalimin e Qarqeve të interkoneksionit është ekzistenca e kërkesës së duhur për trafik, si vijon me poshtë:

- a. Kapaciteti minimal i zgjerimit është 2Mbps;
- b. Përdorimi i zakonshëm i kapacitetit të interkoneksionit gjatë orëve të peak-ut parashikohet të kalojë 75%.

3. Operatori Përfitues duhet të japë parashikime të detajuar sipas pikave të interkoneksionit për kapacitetet e qarqeve dhe linjave të interkoneksionit në 2Mbps, sasinë e trafikut të pritshëm drejt TiK, sipas llojit të thirrjeve (lokale, rajonale, kombëtare), trafiku drejt rrjeteve të tjerë fiks, trafikun e pritshëm nga TiK dhe rrjetet e tjerë kombëtare dhe ndërkombëtare, trafiku drejt numrave jo-gjeografike Përpjekjet për Thirrje gjatë Orëve të Peak-ut, Trafikun e Orëve të Peak-ut (në Erlangs) kërkesat për kapacitet të sinjalizimit, numrin e portave të interkoneksionit. Operatori Përfitues duhet të japë parashikime edhe për origjinën e trafikut të përcjellë drejt TiK: konsumatorë të rrjetit të tij, rrjete të tjerë kombëtare dhe thirrje ndërkombëtare.

Parashikimet duhet të kryhen për periudha 3 mujore për dy vitet në vijim. Të gjitha parashikimet e trafikut dhe kapaciteteve të nevojshme do të rishikohen të paktën cdo 6 muaj gjatë takimeve të caktuara mes përfaqesuesve teknike të të dyja Palëve, ku do të bihet dakord rreth vendimeve për zbatimin e parashikimeve.

1. Pala kërkuese ka detyrimin që bazuar në parashikimin për kapacitete të nevojshme shtesë dhe të rënë dakord midis palevë, të bëjë një kërkesë porosi për kapacitetet shtesë palës ofruese 3 muaj përpara afatit të implementimit, në rastin e shtimit të portave E1 në centralet e TiK (për raste e tjera palët vendosin në negociata për afatet e realizimit dhe kryerjes së porosisë). Porosia duhet të jetë e detajuar sipas pikave të interkoneksionit dhe koha minimale për përdorimin e kapaciteteve shtesë do të jetë 12 muaj.

5. Palët do të vendosin në negociata detyrimet respektive për kompensim të njera tjetrës për rastet kur:

- 5.1.** kapacitetet shtesë të porositura nuk implementohen nga pala ofruese brenda afatit 3 mujor;
- 5.2.** kapacitetet shtesë implementohen nga pala ofruese por pala kërkuese nuk i dëshiron më,
- 5.3.** gjatë afatit 3 mujor porosia anulohet nga pala kërkuese.

Një kopje e detyrimeve dhe afateve të rena dakort i dërgohen ARKEP. TiK do të sigurojë informacion ose do ta publikojë në faqen e siguar të internetit mbi kapacitetet e shfrytëzuar dhe të lira të portave të interkoneksionit në të gjitha pikat e interkoneksionit në centralet e TiK. Në rast se pala ofruese nuk bie dakort pjesërisht për parashikimet e palës kërkuese, pala ofruese realizon kërkesat për pjesët e rena dakord, ndërsa pala kërkuese rishikon pjesët jo të rena dakord. Në rast se palët nuk bien dakord me parashikimet,

mosmarrëveshja raportohet në ARKEP, brenda 15 ditëve.

ANEKS 9 MATJA, DEKLARIMI DHE DAKORDIMI I TRAFIKUT/PROCEDURAT

1. Shërbimi trafikut

1.1. Koha e matur për tarifim

Koha e matur për tarifim, përvec rasteve kur ka specifikim tjetër, do të jetë "koha e bisedës", në përputhje me Rekomandimin e ITU-T D.150.

Asnjë prej palëve nuk do aplikojë tarifim për përcjelljen e thirrjes nëse thirrja nuk është lidhur, kur ka:

- ton "zile" pa përgjigje;
- ton "zënë";
- ton "numër i padisponueshëm"
- "Njoftim i regjistruar informacion rrjeti"

Për të shmangur çdo dyshim, sistemet voice mail të klientit apo rrjetit nuk konsiderohen "Njoftim i regjistruar informacion rrjeti".

Koha totale e tarifuar për çdo muaj do të llogaritet në një mënyrë të tillë që numri i përgjithshëm në sekonda pjesëtohet me gjashtëdhjetë (60) dhe rezultati i kësaj llogaritjeje rrumbullakoset me lartë ose me poshtë. Në rast se rezultati është tridhjetë (30) ose më shumë, rrumbullakoset më lartë dhe koeficientit i shtohet një minutë, ndërsa nëse është më pak se tridhjetë (30) koeficientit nuk i shtohet asgjë.

1.2. Thirrjet e tarifuara

Numri i thirrjeve për tarifim llogaritet si shumë e thirrjeve të sukseshme të përcaktuara si të tilla si në paragrafin më sipër dhe përkufizimeve në Aneks 1, si dhe për interval kohor të matjeve nga ora 00.00 e ditës së parë të muajit deri në orën 23.59.59 të ditës së fundit të muajit. Periudha e matjeve është një mujore dhe fillon nga ora 00.00 e ditës së parë të muajit deri në orën 23.59.59 të ditës së fundit të muajit.

1.3. Matje e Trafikut

Matjet e trafikut do të bëhen për numër minutash të thirrjes dhe numër thirrje të sukseshme, si dhe me CDR (Call Detail Record) në Centralin e Interkoneksionit si dhe për trafikun e origjinuar dhe destinuar për/nga rrjeti i Operatorëve të tjerë për/nga TiK dhe tranzit për/nga Operatorë të tjerë kombëtar TiK.

1.3.1. Të dhënat e detajuara të thirrjeve për matjet e trafikut

Informacioni kryesor i mëposhtëm i faturimit, që do të regjistrohet për çdo Thirrje, do të bazohet mbi të dhënat e detajuara të thirrjes:

- a) Identifikuesi i pikës së Interkoneksionit
- b) Shifrat e formuara për thirrjen (numri i thirrur)
- c) CLI-ja
- d) data dhe ora kur sinjali i përgjigjës është marrë nga pala që siguron Informacionin e Faturimit.
- e) Kohëzgjatja e tarifimit (qoftë ajo e matur apo e vlerësuar)
- f) Lloji i shërbimit sipas specifikimeve përfshirë në nivelin e detajimit.
- g) Çfarëdo lloj informacioni tjetër që mund të jetë rënë dakord.

Pala faturuese, do të bashkangjisë faturës informacion suportues të përshtatshëm në formatin e përcaktuar më poshtë, Raporti i përdorimit të Interkoneksionit, (në rast se konsiderohet i nevojshëm nga pala tjetër) për të dhënë mundësinë palës tjetër të kontrollojë faturën.

1.3.2. Raporti mbi Përdorimin e Interkoneksionit

TiK dhe Operatori Përfitues do të përpunojnë versionet e tyre përkatëse të Informacionit të Faturimit sipas specifikimeve në pikën 1.3.1 në mënyrë që të përgatitet matrica e paraqitur më

poshtë në Tabelën 1, i cili do të referohet si Raporti mbi Përdorimin e Interkoneksionit.

Tabela 1

Origjinimi	Destinacioni	Periudha	Numri total i thirrjeve	Kohëzgjatja e thirrjeve(në minuta)	Tarifa (€)	Shuma (Euro)	Total Pagesa (Euro)
(O)	(D)	(PM)	(N)	(M)	(T)	(Sh)	(P)
Totali							

Ku:

O = përcaktohet nga është gjeneruar thirrja nga operatori përfitues apo ndonjë operator tjetër për të cilin Operatori Përfitues bënë tranzitim të thirrjes. Sipas shërbimeve: origjinim, terminim, tranzitim) të detajuar edhe në Aneks 3 dhe 4 "Përshkrimi i shërbimeve" dhe "Tarifat e Shërbimeve".

D = Destinacioni i thirrjes TiK apo ndonjë operator tjetër për rastin kur TiK ofron operatorit përfitues tranzitim të thirrjes drejt tij.

PM= periudha që mbulohet me faturim, zakonisht në baza mujore.

N= numri total i thirrjeve të tarifueshme

M= Kohëzgjatja totale e tarifueshme e thirrjeve

T= Tarifa për minutë

Sh= Pagesa totale për shërbimet e tarifuar pa TVSH ku përfshihen $P=M \times T$, përveq në rastin kur kemi të bëjmë me shërbime që llogariten për numër të thirrjeve, atëherë pagesa për atë kategori të thirrjeve do të jetë $P=N \times T$

P= Pagesa totale me TVSH

Nëqoftëse palët do të bien dakord që të aplikojnë breza kohor për tarifat e interkoneksionit, për shmangien e ndonjë dyshimi, Raporti mbi Përdorimin e Interkoneksionit do të përgatitet për të gjithë brezat kohorë të tarifimit të aplikueshme.

Për qëllime tarifimi, thirrjet do të konsiderohen brenda periudhës së tarifimit në të cilën nisen.

Për qëllime faturimi dhe llogaritjesh, thirrjet do të konsiderohen brenda periudhës së faturimit në të cilën përfundojnë.

TiK dhe Operatori Përfitues janë të detyruar t'i dërgojnë njeri-tjetrit me shkrim ose me e-mail të dhënat për trafikun total të dërguar në rrjetin e palës tjetër, për periudhën e faturimit, të detajuar sipas origjinës dhe nga konsumatorët e rrjetit të vet, të tranzituar nga operatorë të tjerë kombëtarë. Ky informacion do të quhet Raporti i Trafikut të Origjinuar, Tranzituar.

TiK dhe Operatori Përfitues duhet të shkëmbejnë Raportet mbi Përdorimin e Interkoneksionit, Raporti i Trafikut të Origjinuar/Tranzituar jo më vonë se data 4(katër) e muajit që pason Periudhën e Faturimit.

Në rast se rrjeti apo sistemi i faturimit i njëres prej palëve pëson difekt dhe nuk mund të sigurojë të gjithë informacionin faturues të nevojshëm për të lëshuar faturën, me kërkesë të palës faturuese dhe pala tjetër duke bërë të gjitha përpjekjet e arsyeshme do të sigurojë informacionin e mungur faturues.

TiK dhe Operatori Përfitues do të krahasojnë matjet e trafikut. Shuma e diskutueshme e

matjeve të trafikut mes palëve duhet të jetë brenda një tolerance të rënë dakord midis palëve të përcaktuar në Marrëveshjen e Interkoneksionit. TiK dhe Operatori Përfitues do të krahasojnë raportimet e tyre të matjeve në rast se ka ndonjë diferencë. Në rast se diferencat e trafikut të Palëve janë mbi tolerancat e përcaktuara, TiK dhe Operatori Përfitues do të trajtojnë vlerën e diskutueshme (mbi tolerancë) nëpërmjet një procedure të përcaktuar në Marrëveshjen e Interkoneksionit.

1.4. Deklarimi i Trafikut

Palët do të bëjnë deklarin e matjeve të trafikut duke shkëmbyer Raportet e Përdorimit të Interkoneksionit dhe/ose Raportet e Trafikut të Origjinuar/Transituar(edhe terminuar) sipas mundësive të palëve, por jo më vonë se data 4 (katër) e muajit që pason Periudhën e Faturimit.

Datë deklarimi do të konsiderohet data e marrjes së konfirmimit të shërbimit postar kur dërgohet me postë,ose deklarimi me E-mail ose fax,ose dorazi me kofirmimin e palës marrëse pranë ambienteve të TiK në adresë të personave të kontaktit. Cdo vonesë e mundshme nga momenti i dërgimit të deklarin deri në mbërritjen e tij tek pala tjetër, është nën përgjegjësinë e palës dërguese dhe nuk përbën shkak për tejkalimin e afateve të përcaktuara në paragrafet e mësipërm.

Secila Palë ka detyrimin të dërgojë zyrtarisht palës tjetër të dhënat mujore (numër minutash dhe numër thirrjesh të sukseshme) të matjeve të trafikut në Centralin e Interkoneksionit. Të dhënat e deklaruara nga Operatori përfitues do të konsiderohen të vlefshme për krahasim dhe dakordim vetëm nëse shprehin të gjitha zërat e trafikut për secilin shërbim të përshkruar në Aneks 3 "Përshkrim i Shërbimeve". Në të kundërtën, bazë për faturim do të merren të dhënat e TiK.

1.5. Dakordimi i matjeve të Trafikut

TiK dhe Operatori Përfitues në procesverbalin e dakordimit,do të bëjnë krahasimin e matjeve të trafikut të deklaruara konform afatit të përcaktuar në pikën 1.4 dhe të faturuara sipas afatit të përcaktuar në nenin 17 "Faturimi, Pagesat dhe Garancia".

Procesverbali i dakordimit duhet të përmbajë të dhënat e matjeve sipas Raporteve të Përdorimit të Interkoneksionit dhe/ose Raporteve të Trafikut të Origjinuar/Tranzituar (edhe terminuar).

Dakordimi i Trafikut dhe nënshkrimi i procesverbaleve do të bëhet në ambjentet TiK, sa më parë të jete e mundur,por jo më vonë se data 15 të muajit që pason periudhën e faturimit.

Palët në marrëveshjen e interkoneksionit përcaktojnë rregullin e përgjithshëm për kufirin e diferencave të lejuara të matjeve të trafikut.

Kufiri i diferencave në matjet e trafikut të pranuar mes palëve do të jetë jo më shumë se:

- 1% për trafikun e matur

TiK dhe Operatori Përfitues do të krahasojnë raportimet e tyre të matjeve për të parë në rast se ka ndonjë diferencë. Diferenca do të kalkulohet si vijon:

- A – Matjet/Vlera në Euro TiK
- B – Matjet/Vlera në Euro Operatori Përfitues
- Diferenca: $Vlera\ absolute\ |(A-B)| \times 100 / |(A+B)|/2$

Në procesverbalin e dakordimit palët bien dakord për të dhënat e matjeve të trafikut dhe nënshkruajnë procesverbalin e dakordimit për të konfirmuar detyrimet reciproke për vlerat e faturuara. Në rast se përfaqësuesi i autorizuar i Operatorit Përfitues nuk paraqitet për të nënshkruar procesverbalin e dakordimit brenda afatit, atëherë procesi i dakordimit konsiderohet i realizuar dhe Operatori Përfitues nuk ka më të drejtë të kundërshtojë faturën

e lëshuar nga TiK dhe fatura konsiderohet automatikisht e pranuar. Mosparaqitja për nënshkrim të procesverbalit nuk cenon vlefshmërinë e faturës së lëshuar.

Të dhënat e deklaruara nga TiK apo krahasimi i tyre me deklaratimet e Operatorit Përfitues do të shërbejnë si bazë për informacionin për faturim dhe eventualisht saktësimin e tij në periudhën pasardhëse të faturimit. Palët do të faturojnë apo eventualisht do të bëjnë korrigjimet e nevojshme të faturave, bazuar në matjet e TiK dhe krahasimin e tyre me matjet e Operatorit Përfitues, me kusht që këto të fundit të jenë deklaruar në afat nga Operatori Përfitues.

Në rast se diferencat e trafikut të Palëve, të llogaritura, janë mbi kufirin e përcaktuar më lart TiK dhe Operatori Përfitues do të nënshkruajnë procesverbalin e dakordimit për njohjen e diferencave dhe do të trajtojnë vlerën e diskutueshme (mbi tolerancë) nëpërmjet një procedure të parashikuar në vijim.

1.6. Mosmarrëveshjet për matjet e trafikut

Në rastet kur shuma e diskutueshme e matjeve të trafikut mes palëve është mbi kufijtë e tolerancave të përcaktuara në Marrëveshjen e Interkoneksionit, secila nga Palët ka të drejtë të fillojë procedurën e zgjidhjes së mosmarrëveshjes, sic detajohet në paragrafët e mëposhtëm. Aktivizimi i procedurës së zgjidhjes së mosmarrëveshjes nuk cenon procesin e faturimit dhe të pagesës. Efektet eventuale do të trajtohen në faturimin e muajit pasardhës. Palët do të krijojnë një Komision të përbashkët dhe për zgjidhjen e mosmarrëveshjes për diferencat e trafikut të deklaruar. Secila Palë do të caktojë anëtarët e saj në komision dhe do t'ia njoftojë me shkrim apo me e-mail Palës tjetër.

Palët do të caktojnë mbledhjen e komisionit jo më vonë se 5 (pesë) ditë kalendarike nga data e konstatimit të diferencave dhe njohjes së kësaj difference nga palët në procesverbalin e dakordimit.

Palët do të sigurojnë komisionit të dhëna të detajuara ditore të trafikut si dhe për thirrjet nëse është e nevojshme (mbi bazë CDR-ësh) për të bërë të mundur identifikimin e mospërputhjeve.

Palët do të ofrojnë komisionit këto të dhëna brenda 10 (dhjetë) ditë pune që nga data e mbledhjes së komisionit.

Në rast se një Palë nuk i jep këto të dhëna komisionit sipas afateve të përcaktuara më sipër, atëherë të dhënat e paraqitura nga Pala tjetër do të pranohen në mënyrë automatike dhe mbi bazën e tyre do të kryhet korrigjimi i faturës në periudhën pasardhëse të faturimit.

Pas zgjidhjes së mosmarrëveshjes, së kryerjes së Pagesës që i korrespondon asaj periudhe faturimi, korrigjimet përkatëse eventuale në lidhje me mosmarrëveshjen do të bëhen vetëm mbi bazën e vendimit të komisionit. Vendimi i Komisionit do të shërbejë si bazë për rillogaritjen e detyrimeve reciproke.

Në rast se komisioni nuk arrin të marrë një vendim unanim, mosmarrëveshja në lidhje me diferencat do të kalohet për zgjidhje në ARKEP.

ANEKS 10 FATURIMI, PAGESAT DHE GARANCIA

1. Faturimi i Trafikut

Secila Palë ka detyrimin të faturojë Palën tjetër për shërbimin e trafikut të ofruar pas shkëmbimit të të dhënave të trafikut, por jo më vonë se data 5 (pesë) e muajit që pason periudhën e faturimit për trafikun e interkoneksionit, sipas matjeve të TiK dhe krahasimit të tyre me matjet e Operatorit Përfitues, me kusht që këto matje të jenë deklaruar në afat nga Operatori Përfitues.

Nëse Operatori Përfitues nuk respekton afatet e përcaktuara mbi deklaratimet e trafikut, atëherë faturimi do të kryhet mbi bazën e të dhënave të trafikut të TiK, të cilat dergohen zyrtarisht (apo me e-mail) brenda këtyre afateve, dhe këto të dhëna do të shërbejnë si bazë llogaritjeje.

Në rast se diferencat e trafikut të deklaruar nga Palët janë mbi limitet e përcaktuara në marrëveshje, Pala e interesuar njofton Palën tjetër për diferencat të cilat reklamohen nga ana e saj në procesverbalin e dakordimit ku konstatohen diferencat. Konstatimi i diferencave dhe trajtimi i tyre, nuk përben arsye për mospagimin e faturës nga ana e Operatorit Përfitues. Në rast të rezultimit të ndryshimeve pas kryerjes së procedurave të parashikuara në Aneks 9 "Matjet, Deklarimi dhe Dakordimi/Procedurat", TiK dhe Operatori Përfitues do të bëjnë korrigjimet përkatëse në faturën e periudhës pasardhëse të faturimit.

Nëse njëra Palë ka dështuar të dërgojë të dhënat e trafikut brenda afateve dhe procedurave të përcaktuara në Aneks 9 "Matjet, Deklarimi dhe Dakordimi/Procedurat", kjo Palë nuk ka të drejtë të refuzojë faturën e lëshuar nga Pala tjetër dhe fatura do të konsiderohet automatikisht e pranuar me marjen e konfirmimit të shërbimit postar ose konfirmimin me shkrim të marrësit, por me marrjen e kësaj fature, pala e interesuar ka të drejtë që në rastin kur diferencat e matjeve të deklaruara nga Pala faturuese janë mbi limitet e përcaktuara, të iniciojë procedurën për mosmarrëveshjet e trafikut të dhënë në pikën 1.6 Aneks 9 "Matjet, Deklarimi dhe Dakordimi/Procedurat".

Për këto diferenca do të bëhet rillogaritja e detyrimeve dhe faturimi mbështetur në procedurat e përshkruara në pikën 1.6 "Mosmarrëveshjet për matjet e trafikut" në Aneks 9 "Matja, Deklarimi, Dakordimi/Procedurat".

2. Faturimi për shërbimet e Interkoneksionit të ndryshme nga shërbimi i trafikut

Shërbimet e Interkoneksionit që kanë pagesa periodike fikse mujore, do të faturohen me paspagim për çdo muaj rregullisht me faturën e shërbimeve të trafikut, duke e evidentuar veçantë. Shërbimet e Interkoneksionit që kanë pagesa që bëhen vetëm një herë, do të faturohen në çdo rast me paspagim, jo më vonë se 30 (tridhjetë) ditë nga data e realizimit të shërbimit.

3. Faturimi për shërbimet e tranzitimit

TiK do të sigurojë Operatorit Përfitues qasje për përdorimin e shërbimeve të tranzitimit të trafikut të shkëmbyer me operatorët e tretë, kundrejt tarifave të tranzitimit.

Faturimi i shërbimeve të tranzitimit të trafikut drejt operatorëve, do të bëhet veçantë nga pjesa tjetër e trafikut.

3. Kryerja e Pagesave

TiK dhe Operatori Përfitues kanë detyrimin të paguajnë të gjitha detyrimet përkatëse, brenda pesëmbëdhjetë (15) ditëve kalendrike nga data e faturës.

Të gjitha taksat dhe detyrimet ligjore duhet të paguhen nga pala përgjegjëse sipas ligjeve dhe rregullave që janë në fuqi në Republikën e Kosovës.

Secila palë do të dërgojë konfirmim të menjehershëm palës tjetër për pagesën e kryer duke specifikuar në mandatin e pagesës përkatëse faturën ose faturat (në rastin kur ka vonesa) që ai mandat pagese përfshin.

Në rast të mosmarrjes së konfirmimit për pagesën deri në përfundimin e muajit që pason periudhën e faturimit, pala e interesuar rezervon të drejtën për të bërë vetë llogaritjet e penaliteteve të shkaktuara nga vonesa të mundshme në pagesa.

Shumat e faturuara nga të dyja palët mund të balancohen me njëra tjetrën sipas periudhave përkatëse të faturimit dhe shuma neto e mbetur pas balancimit do të paguhet.

Të gjitha pagesat respektive që lindin sipas marrëveshjes së interkoneksionit do të bëhen në adresat financiare të mëposhtme të Palëve:

Adresa financiare e TiK:	Adresa financiare e Operatorit Përfitues
Procredit Bank Rruga: Rr.Nëna Terezë Nr.16 10000 Prishtinë NIPT: Llogaria Bankare e TiK-ut: 1110-195681-0001-88	Adresa: NIPT: Llogaria Bankare:

5. Garancia financiare

Me nënshkrimin e Marrëveshjes së Interkoneksionit Operatori Përfitues/TiK i siguron një garanci bankare TiK/Operatorit përfitues sipas formatit të garancisë dhënë në Aneks 10 "Formulari i Garancisë" e cila do të jetë e leshuar nga një Bankë e nivelit të dytë e cila ushtron aktivitetin në Kosovë për shumën e përcaktuar në këtë aneks, për ofrimin e shërbimeve të interkoneksionit, në përputhje me marrëveshjen e interkoneksionit.

Kjo Garanci Financiare do të jetë e vlefshme për një periudhë 12 (dymbëdhjetë muaj), duke filluar nga dita e nënshkrimit të Marrëveshjes dhe do të rinovohet (do të dorëzohet një e re) një muaj përpara afatit 12 muaj, sipas përcaktimeve në MI. Në kohën e dorëzimit të Garancisë së re, TiK/Operatori Përfitues do të lirojë Operatorit Përfitues/TiK Garancinë pararendëse.

Operatori Përfitues/TiK do të jetë i detyruar që brenda 15 ditëve nga nënshkrimi i marrëveshjes dhe përpara se interkoneksioni të realizohet, në rastin e operatoreve të rinj, të dërgojë në TiK/Operatorit Përfitues garancinë bankare nëpërmjet instrumentit të mëposhtëm të garantimit të pagesës. Garancia bankare do të depozitohet në një bankë komerciale në Republikën e Kosovës.

Shuma e garancisë do të përlogaritet që të mbulojë detyrimin neto ndaj TiK/Operatorit Përfitues për një periudhë tre-mujore. Detyrimi neto përlogaritet si diferencë e detyrimit të operatorit përfitues ndaj TiK me detyrimin e TiK ndaj Operatorit Përfitues për trafikun e shkëmbyer. Vlera e periudhës tre muajore do të jetë e barabartë me trefishin e vlerës mesatare mujore të 12 muajve:

- për operatorët që tashmë kanë interkoneksion: (6 muajt e mëparshëm + parashikimi për 6 muajt në vijim)/4.
- Për operatorët që kanë më pak se 6 muaj interkoneksion $(N+P)/4$, ku N-numri i muajve

- që kanë interkoneksion, dhe $P = 12 - N$, muajt e parashikuar.
- për operator të rinj: (parashikimi për 12 muajt në vijim)/4.

Në rast se detyrimi neto është negativ TiK është e gatshme të vendose një garanci sipas përlllogaritjeve të mësipërme, në rast se kjo kërkohet nga operatori përfitues.

Vlera e garancisë do të rishikohet në rastin e lidhjes së marrëveshjes së re të interkoneksionit ose në rastet e ndryshimeve të ndjeshme në volumet e trafikut. Ndryshim i ndjeshëm i volumit të trafikut konsiderohet ndryshimi me 30% i detyrimeve neto të tre muajve të fundit, krahasuar me detyrimin neto mbi të cilin është bërë llogaritja e fundit e garancisë.

Në çdo rast, shumat në garanci (shuma minimale e garancisë) që do të llogaritet si me sipër dhe do të dorëzohet TiK/Operatorit Përfitues, nuk mund të jetë më pak se detyrimi neto maksimal i një muaji.

Në çdo rast, mosdorëzimi i Garancisë brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga nënshkrimi i marrëveshjes së interkoneksionit sic përkruhet më sipër do të konsiderohet arsye për shkeputjen e kësaj Marrëveshjeje, sipas dispozitave përkatëse të shkeljes dhe shkeputjes së Marrëveshjes së Interkoneksionit

Garancia, siç përkufizohet në paragrafët e mësipërm, do të kërkohet të aktivizohet (preket) menjëherë pjesërisht apo tërësisht në raste mospagesës deri në perfundimin e periudhës së llogaritjes së kamatvonesës të shumave neto që njera palë i detyrohet palës tjetër për shërbimet e interkoneksionit të ofruara në përputhje me marrëveshjen e interkoneksionit të lidhur sipas kësaj Oferte Referencë të Interkoneksionit.

Pas aktivizimit të garancisë, ajo do të rikthehet në vlerën e mëparshme ose në një vlerë të rivlerësuar nga pala që kërkoi aktivizimin e saj. Moskthimi në shumën origjinale apo të rivlerësuar apo mospagesa e diferencës midis vlerës së detyrimit sipas faturës/faturave të papaguara dhe garancisë bankare, në rast se garancia bankare nuk mbulon vlerën e detyrimit të papaguar, i jep të drejtën TiK (apo Operatorit Përfitues në rastin kur është TiK që ka vendosur garanci) të ndërpresë shërbimet e interkoneksionit të ofruara me këtë marrëveshje të bazuar në Ofertën Referencë të Interkoneksionit.

Ruajtja e të dhënave

Palët janë të detyruara të ruajnë të gjitha të dhënat mbi bazën e të cilave janë bërë faturimet, për një periudhë jo më pak se 2 (dy) vjet nga data e faturimit. Operatori dërgues i trafikut do të ruajë gjithashtu të dhënat edhe për trafikun që nuk është gjeneruar në rrjetin e tij.

ANEKS 11 FORMULARI I GARANCISË

GARANCI PAGESE

PËRFITUESI: **PTK-TIK** Rruga Dardania, pa nr 10000,Prishtine

SHUMA: _____euro (shuma në shifra dhe fjalë)

PËR LLOGARI TË APLIKANTIT: _____(emri dhe adresa)

QËLLIMI I MBULIMIT: Detyrimet Finaciare të Marrëveshjes së Interkoneksionit nr.....dt.....

Në zbatim të Marrëveshjes Nr.....dt..... me objekt **Ofrimin e Shërbimeve të Interkoneksionit**,Ne,Banka _____ jemi në dijeni që për të **garantuar përmbushjen e detyrimeve financiare**, nga ana e Aplikantit _____(emri) me korrektësi, Aplikanti është i detyruar të vëndosë një garanci financiare në një Bankë komerciale ne Kosovë në favor të PTK- Posta dhe Telekomunikacioni i kosovës.

Me kërkesë të _____(emri) Ne, _____ Banka sh.a (adresa), marrim përsipër në mënyrë të përvokueshme dhe të pakushtëzuar që si detyruesi kryesor dhe jo vetëm si palë garante, sapo PTK sh.a të bëjë kërkesen e parë me shkrim, të paguajmë brenda 3 ditëve pune, cdo shumë të faturave(detyrimeve financiare) të papaguara nga aplikanti kundrejt TIK deri në vlerën totale të garancisë _____euro (shuma në shifra dhe fjalë), pa kërkuar shpjegime dhe pa pasur asnjë lloj te drejtë kundërshtimi nga ana jonë, duke përmendur në kërkesë mospërmbushjen e kushteve të Marrëveshjes së Interkoneksionit.

Me këtë garanci sigurojmë përfituesin PTK se nuk është nevoja ti drejtoheni më parë apo ti kërkohet miratim paraprak kontraktuesit për të realizuar pagesën sipas kërkesës suaj.

Shuma totale e kësaj garancie do të reduktohet në mënyrë automatike për cdo pagesë të kryer sipas kësaj garancie.

Kërkesa juaj me shkrim, për pagesë duhet të paraqitet në _____ Banka sh.a, në adresën e mëposhtme: _____ Banka sh.a
(adresa e Bankës lëshuese të garancisë bankare)

Kërkesa për pagesë e garancise do të konsiderohet si e kryer në momentin që ne kemi kërkesën tuaj me shkrim për pagesë tek adresa jonë e sipërpërmendur.

Deklarojmë gjithashtu, se asnjë shtesë apo ndryshim i kushteve të kontratës, për të cilën ju mund të bini dakord me kontraktuesin, nuk na cliron nga detyrimet e kësaj Garancie.

Kjo garanci është e vlefshme deri në 3(tre)muaj pas përfundimit të afatit të vlefshmërisë së Marrëveshjes së Interkoneksionit, pra deri më datë (data e skadencës) dhe skadon plotësisht dhe automatikisht nëse kërkesa juaj për pagesë nuk është bërë në këtë datë ose para kësaj date.

Me mbarimin e kësaj date, kjo garanci quhet e mbyllur dhe Banka është e cliruar nga cdo lloj detyrimi ndaj jush, në lidhje me këtë garanci.

Kjo garanci lëshohet në përputhje me legjislacionin e Republikës së Kosovës.

_____ Banka sh.a (firmat e autorizuara të bankës)

ANEKS 12 MARRËVESHJA E NIVELIT TË SHËRBIMIT (SLA)

Marrëveshja e Nivelit të Shërbimit.(Service Level Agreement, SLA)

Marrëveshja për nivelin e Shërbimit (SLA) përcakton procedurat kryesore me anë të të cilave TiK angazhohet të sigurojë shërbimet e përshkruara në këtë Ofertë Referencë në bashkëpunim me Operatorin Përfitues.

Disa nga çeshtjet që trajtohen sipas ketyre procedurave janë:

1. Vënia në punë e shërbimeve,
2. Menaxhimi dhe riparimi i defekteve
3. Procedurat për punimet e planifikuara
4. Implementimi i numeracioneve të rinj të operatorëve të ndryshëm
5. Menaxhimi i trafikut,shkëmbimi i të dhënave
6. Standardet e cilësisë të rrjetit TiK.

Procedurat dhe koha e realizimit lidhur me ofrimin dhe mirëmbajtjen e shërbimeve të përfshira në këtë Ofertë Referencë janë si më poshtë:

Koha e realizimit

1. Vënia në punë e shërbimit dhe angazhimet:		
Nr	Procedura	Koha e realizimit
1	Operatori Përfitues dërgon një kërkesë meshkrim për TiK për aktivizimin e ndonjë prej shërbimeve të përshkruara në së kërkesës marrëveshje apo Oferte Reference duke përfshirë detajet për kërkesën e tij.	Data e paraqitjes _____
2	TiK pasi merr kërkesën, dërgon një konfirmim të marrjes së saj tek Operatori Përfitues që ka bërë kërkesën.	Ky konfirmim do të bëhet më së largu 3 ditë kalendarike nga data e marrjes së kërkesës me shkrim.
3	Palët do të diskutojnë për të gjitha çeshtjet teknike dhe ekonomike duke përfshirë detalet lidhur me pikën e interkoneksionit, rrugëtimin e thirrjeve dhe parashikimet për shërbimet e interkoneksionit.	Këto diskutime duhet të finalizohen brenda 15 ditëve kalendarike nga data e konfirmimit në pikën 2.
4	Në vijim, pas përfundimit të bisedimeve TiK dhe Operatori Përfitues përpilojnë dhe nënshkruajnë një marrëveshje të interkoneksionit.	Hyrja në fuqi e e marrëveshjes së interkoneksionit do të jetë data e nënshkrimit nga te dyja palët.
5.	TiK do të implementojë shërbimet e përshkruara në Marrëveshje sipas procedurave të mëposhtme: a. Në rastin e ndonjë shërbimi të trafikut ose rrugëzimit të tij që përshkruhet në marrëveshje (përveç vendosjes së qarkut të	a. Implementim brenda dhjetë (10) diteve kalendarike nga data e nënshkrimit të Marrëveshjes apo

	<p>përmendura në pikën 4.</p> <p>b. Në rastin e vënies në punë të një qarku të ri interkoneksioni në një drejtim ekzistues ku kapaciteti i kërkuar i transmetimit është në dispozicion.</p> <p>c. Në rastin e vënies në punë të një qarku të ri interkoneksioni në një drejtim ekzistues ku kapaciteti i kërkuar i transmetimit kërkohet të zgjerohet.</p> <p>d. Në rastin e vënies në punë të një qarku të ri interkoneksioni në drejtim të ri transmetimi.</p>	<p>Amendimit të marrëveshjes.</p> <p>b. Implementim brenda pesë (5) ditëve kalendarike nga data e nënshkrimit të Marrëveshjes apo Amendimit të përmendur në pikën 4.</p> <p>c. Implementim brenda dhjetë (10) ditëve kalendarike nga data e nënshkrimit të Marrëveshjes apo Amendimit të përmendur në pikën 4, nëse zgjerimi i qarkut nuk kërkon punë civile. Në rast të punëve civile TiK dhe Operatori Perfitues do të pajtohen për afatet e implementimit.</p> <p>d. TiK dhe Operatori Perfitues do të pajtohen për afatet e implementimit gjatë përpilimit të marrëveshjes apo amendamentit.</p>
--	---	---

2. Menaxhimi dhe Riparimi i defekteve

<p>1</p>	<p>Në rastin e një defekti që ndikon në shërbimin e Operatorit Përfitues, në TiK duhet të dërgohet një raport i shkruar nga Operatori Perfitues në formën e një "Formular Defekti". Raportimi i defekteve do të bëhet 24 orë në ditë gjatë 365 ditëve të vitit. TiK do të pranojë një raport defekti të shkruar vetëm nëse në raport evidentohet që defekti mund të jetë në rrjetin e TiK. TiK do të konfirmojë pranimin e raportit dhe do të angazhojë resurset përgjegjëse për të zgjidhur problemin.</p>	<p>Data e raportit të defektit.</p>
<p>2</p>	<p>Në rast se defekti shkakton defekt tek Përdoruesit fundor të Operatorit Përfitues atëherë defekti do të klasifikohet kritik.</p> <p>Në rast se defekti nuk shkakton efekte tek përdoruesi i Operatorit Përfitues atëherë defekti nuk do të klasifikohet kriti.</p>	<p>Deri në 6 orë nga pranimi i raportit të defektit të përshkruar në pikën 1.</p> <p>Brenda 24 orëve nga pranimi i raportit të defektit të përshkruar në pikën 1.</p>
	<p>TiK do të informojë vazhdimisht Operatorin</p>	<p>Në rast të defekti kritik cdo 2 orë.</p>

3	Përfitues deri në zgjidhje të problemit:	Në rast të defekti jo kritik 4 orë, brenda orarit të punës.
3. Procedurat për punimet e planifikuara		
1.	Procedurat e planifikuara do të përshkruhen në Marrëveshjen e interkoneksionit të lidhur mes palëve.	Kerkesa për modifikime në rrjet do të bëhet sipas afateve të përcaktuara në marrëveshje për këto ndryshime.
4. Implementimi i numeracionit të ri të operatorëve të ndryshëm		
1.	TiK do të informojë Operatorin Përfitues për seritë e reja numerike të operatorëve të ndryshëm kombëtar dhe ndërkombëtar për dhe/nga të cilët do të tranzitohet trafiku nga TiK.	TiK do të informojë operatorin përfitues 2 ditë pas kryerjes së testeve përkatëse.

5. Menaxhimi i Trafikut, Shkëmbimi i të Dhënave

Palët do të bashkëpunojnë nëpërmjet pikave të kontaktit të përcaktuar në marrëveshje dhe mbështetjes teknike për zgjidhjen e problemeve.

6. Standardet e Cilësisë

Dimensionimi dhe efektshmëria e rrjetit të TiK bazohet në standarde të përgjithshme, teknika dhe metodologji në mënyrë që të sigurohet cilësia e shërbimeve të rrjetit sipas Rregullores për Sigurimin e Qasjes dhe Rregullores për Interkoneksion, standardeve të ITU-T dhe ETSI. TiK vazhdimisht do të bashkëpunojë me të gjithë Sipërmarrësit e shërbimeve të telekomunikimeve për të ngritur cilësinë e shërbimit.

Me qëllimin për të siguruar një cilësi të kënaqshme të shërbimeve, qendrat e komutimit të Rrjetit të TiK dhe të operatorëve apo Ofruesve respektive, do të projektohen për të vepruar në orën më të ngarkuar me një shkallë shërbimi 0.005(0.5 % probabilitet bllokimi).

Rritja e kapaciteteve duhet të bëhet në përputhje me parashikimet e kësaj marrëveshjeje. TiK angazhohet të sigurojë parametrat e cilësisë për shërbimet përkatëse konform kushteve dhe autorizimeve që disponon.

Cilësia dhe siguria për transportimin e trafikut të interkonektuar nga TiK do të jetë në përputhje me cilësinë dhe sigurinë që TiK ofron për trafikun e tij.

Me qëllim mbajtjen e këtyre parametrave të cilësisë TiK do të ofrojë informacione lidhur me:

- a) Sasinë e trafikut në periudhën e peak-ut
- b) Numrin e thirrjeve të suksesshme në periudhë peak
- c) Numrin e tentativave në periudhën e peak-ut
- d) Numrin e thirrjeve të pasuksesshme për shkak të okupimit të trunkeve.

TiK do të synojë që okupimi i qarqeve të mos arrijë më shumë se 90% në orën e peak-ut.

ANEKS 13 DESTINACIONET KOMBËTARE DHE DETYRIMET PËRKATËSE

Në këtë Aneks jepen detyrimet që lindin nga terminimi i thirrjeve kombëtare në Rrjetet e Operatorëve të Rrjeteve të Komunikimeve Publike të interkonektuar me TiK. Bazuar në marrëveshjet ekzistuese, detyrimet aktuale jepen sipas tabelës së mëposhtme.


Detyrimet do të përditësohen në vazhdimësi me konfirmime zyrtare në varësi të marrëveshjeve me operatorët e tjerë ku terminohet trafiku.

	Detyrimi që rrjedh nga terminimi	Zona Kombëtare
I	Në rrjetet e operatorëve fix kombëtar	
1	Telekomi i Kosovës	
2	Operatori tjetër kombëtar	
..		

Seritë numerike që u perkasin Operatorëve tjerë të mësipërm jepen në Aneks 19 "Numeracioni i Operatorëve tjerë Kombëtar"

ANEKS 14 BLOKSKEMA E INTERKONEKSIONIT

Blokskema e interkoneksionit do të përmbajë formën e interkoneksionit sipas njërës prej varianteve të ETSI TR 101 949 dhe informacionin përkatës për resurset e ofruara dhe pronësinë e tyre.



Reference: Figura 3(ETSI TR 101 949)

ANEKS 15 PIKAT E INTERKONEKSIONIT

TiK ofron mundësitë për pikë interkoneksioni në pikat e paraqitura më poshtë. Pikat e interkoneksionit të paraqitura në këtë Aneks i referohen definicioneve, përshkrimeve dhe specifikimeve të dhëna në nenin 9 "Interkoneksioni me rrjetin TiK" dhe në detaje në Aneks 2 "Interkoneksioni me rrjetin TiK".

I. Pikë ndërkombëtare Interkoneksioni

1. CT EWSD Dardania

II. Pika Kombëtare Interkoneksioni

1. CT EWSD Dardania

IV. Pika lokale Interkoneksioni

"DDF e TiK,CT Lokal xxx"

"DDF e TiK,CT Lokal xxx"

"DDF e TiK,CT Lokal xxx"

"DDF e TiK,CT Lokal xxx"

"DDF e TiK,CT Lokal xxx"

III. Pikat për qasje fizike në rrjetin e TiK për interkoneksion janë të dhëna në Aneks 16 Mundësitë për bashkevendosje

Shënim: Disponueshmëria e ofritit të këtyre pikave të interkoneksionit do të varet nga mundësitë teknike të TiK në momentin e paraqitjes së kërkesës përkatëse.

ANEKS 16 MUNDËSITË PËR BASHKËVENDOSJE

Në këtë Aneks paraqiten qendrat e prezencës fizike të TiK ku mund të ofrohet bashkëvendosja ose mundësia për lidhjen fizike për realizimin e interkoneksionit deri në centralin më të afert ku ofrohen shërbimet e interkoneksionit dhe sipas mundësive teknike për të ofruar këtë shërbim.

Silovi	Samadraxhë	Bistazhin	PR Lagja e spitalit
Golesh	Mamushë	Prishtinë Dardania	Vushtrri
Bushat	Mushtisht	Prishtine Ilira	Skenderaj
Aeroport	Malishevë	Kazerma Adem Jashari Pr	Runik
Graçanicë	Bare	Hajvalia	Pejë
Zhare	Kutllovc	Zona Industriale	Klinë
Shkabaj	Mitrovicë	Lluzhan	Banja e Pejës
Azizi	Qyqavicë	Sllatina	Gurakoc
Magure	Dardanë	Butovc	Burim
Film City	Maja e gjelbërt	Lipjan	Gjakovë
Kërpimëh	Domorovc	Fushë Kosovë	Deçan
Orllan	Roganë	Bardhi i madh	Junik
Cvilen	Topanicë	Drenas	Qabrat
Bukiq	Artanë	Kastriot	Prizren
Zatriq	Capar	Bardhosh	Korishë
Dragash	Ropotovë	Besianë	PTK3 Prizren
Brod	Hogosht	PR Kodra e trimave	Ratkoc
Bresanë	Brezovicë	PR Kashagia	Therandë
Mushnikovë	Bondsteel	PR Taslixhe	Krushë e Madhe
Rahovec	Gorazhdec	PR Mat	Ferizaj
Ganimete Tërbeshi	Sojevë	Talinoc	Shtime
Kaqanik	Hani i Elezit	Gjilan	Pozharan
Viti	Klllokot		

Shënim: Disponueshmëria e ofrimit bashkëvendosjes në këto pika të prezencës varet nga gjendja e përdorimit dhe infrastrukturës së TiK në to në momentin e paraqitjes së kërkesës përkatëse.

ANEKS 17 ZONAT E INTERKONEKSIONIT DHE NUMERACIONI I TiK

TiK ofron zonë kombëtare të Interkoneksionit te cilat korrespondojnë me strukturën që TiK iu ofron pajtimtarëve të Rrjetit të Tij, të cilat së bashku me kodet e numeracionit (NDC) janë paraqitur në tabelën në vijim.

Nr	Zona Kombëtare e Interkoneksionit	NDC	Diapazoni i SN-ve	
I	Prishtinë	(0)38	211 000	213 999
			220 000	249 999
			250 000	255 999
			258 000	259 999
			260 000	269 999
			500 000	509 999
			510 000	512 999
			515 000	518 999
			520 000	559 999
			560 000	567 999
			570 000	573 999
			575 000	577 999
			580 000	582 999
			584 000	588 999
			591 000	591 999
			594 000	594 999
			600 000	604 999
			606 000	609 999
610 000	613 999			
616 000	616 999			
II	Mitrovicë	(0)28	520 000	539 999
			555 000	555 999
			570 000	573 999
			578 000	579 999
			581 000	582 999
			590 000	590 999

III	Pejë	(0)39	420 000	435 999
			441 000	442 999
			450 000	451 999
			453 000	453 999
			456 000	456 999
			466 000	466 999
			467 000	467 999
			470 000	471 999
			477 000	478 999
			490 000	499 999
IV	Gjakovë	(0)390	320 000	339 999
			361 000	362 999
			365 000	365 999
			368 000	368 999
			370 000	370 999
			372 000	372 999
			374 000	374 999
			390 000	390 999
V	Prizren	(0)29	220 000	245 999
			246 000	247 999
			269 000	269 999
			271 000	279 999
			281 000	281 999
			283 000	283 999
			285 000	285 999
			297 000	297 099
			622 000	626 999
			630 000	634 999

VI	Ferizaj	(0)290	320 000	329 999
			330 000	330 999
			341 000	341 999
			364 000	365 999
			370 000	370 999
			375 000	375 999
			380 000	381 999
			384 000	385 999
			389 000	390 999
			396 000	396 999

VII	Gjilan	(0)280	320 000	330 999
			370 000	375 999
			380 000	382 999
			385 000	386 999
			390 000	390 999

ANEKS 18 NUMERACIONI I OPERATORIT PËRFITUES

Numeracioni si dhe detyrimi për zonat perkatëse të tij do të përditsohet në vazhdimësi me konfirmime zyrtare

ANEKS 19 NUMERACIONI I OPERATORËVE TJERË KOMBËTAR

Operatorët tjerë fiks të interkonektuar me TiK numeracioni si dhe detyrimi per zonat përkatëse të tij do të përditësohet në vazhdimësi me konfirmime zyrtare në varësi të ndryshimeve dhe marrëveshjeve me operatorët përkatës.